

Ka studju për filozofi por me profesion është gazetar e me zâ, poet. Katër herë i arrestuem nga regjimi serbian, gjatë Lëvizjes së Rezistencës antifashiste dhe luftës së Kosovës (1990-1999). Është autor i librave: “Frymë varresh në dallgore”, bota e re, 1988, poezi; “Udhëtim nëpër ëndërr të keqe” (Zëri, 1994); “Lajmësi memec” (Zëri, 1996), “Udhëtim nëpër zgjendërr të keqe”, (Zëri, 2000), “Hija e Krishtit” (Sheshi, 2004), “Katedrale prej letre” (Koliqi, 2012), “N’zanafillë” (OM, 2013) dhe “Gdhendje drite”, (Multimedia, 2021); “The Lil’s poem”, Littera, 2023.)

HALIL MATOSHI

Rrufepritsa t’ni shoqnie janë shkrimtarët

Bisedoi Andreas Dushi

DEBATI PËR PËRKTHIMIN E POEZISË: ARTI I PËRKTHIMIT TË POEZISË

nga Thea Voutiritsas (fq. 23)

Në poezi, ritmi, stili, zgjedhja e fjalës u frymojnë jetë ndjenjave dhe ideve të shkrimtarit. Atëherë, pra, a mund të përkthehen poezitë? Çfarë ndodh kur një poezi i nënshtrohet një grupi të ri tingujsh, një alfabeti të ri, apo një ndryshimi të lehtë në zgjedhjen e fjalës? Çfarë, nëse diçka, humbet në përkthim?

SHËNIME MBI LIBRAT

Vëllimi poetik i Viktor Vokrrit,
“Kujtesa e së djeshmes e nesërmja”

GJETJE POETIKE QË ABSTRAGOHEN NATYRSHËM

Nga Arben Prendi (fq. 8)

Romani “Shpërngulja e të vdekurve”
i shkrimtarit Kim Mehmeti

PIKA PIKËLLIMI NË ILIRIDËN E HUMBUR

Nga Kosta Nake (fq. 7)

Xhahid Bushati, “Fred: koha e poetit”


FREDI, FATI DHE ARTI I TIJ LETRAR

Nga Xhevat Sylja (fq. 12)

Vështrim strukturalist i romanit të shkrimtarit Bashkim
Hoxha ku subjekti i tij shpërbën thershëm “mite” që
s’mund të lindin.

ROMANI “DIMRI I LIBRAVE” I BASHKIM HOXHËS

Nga Ilir Paja (fq. 10)



ARBËRISHTJA, GJUHË NË RREZIK?

Prof. Diana Kastrati

(fq. 4)

Flitet për mbijetesë të arbërishtes në KUVENDIN II TË STUDIMEVE ARBËRESHE, organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, zhvilluar në datat 4 dhe 5 shtator 2023 në Tiranë. Zgjedhja e kësaj tematike nuk ishte rastësore; kjo çështje kaq nevralgjike e identitetit arbëresh siç është gjuha dhe vitaliteti i saj, ka përbërë fokusin e punës së institucionit të QSPA-së në këto tri vite funksionim të saj.

IN MEMORIAM

MARKO VESHIOVQ, NJË HERO NË KOHË JOHEROIKE

Nga Mirash Martinoviq



BIBLIOTEKË

Roland Gjoza (fq. 18)

Moda

Olga Sjedakova (fq. 19)

Këngë të vjetra

Përktheu nga origjinali Agron Tufa

Damian G. Bertolino (fq. 22)

I pabesueshmi Springer

Jonida Hitoveizi (fq. 13)

Mungesë

Anton Papleka (fq. 14)

Lisat e Apolonisë

Uran Butka (fq. 15)

Arna

Preng Maca (fq. 16)

Shpëtimi i zogjve

Qazim Shehu (fq. 17)

Shpirt i panjohur

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

KOLEKSIONI I FAMSHËM I ARTIT I FAMILJES DURAZZO

Nga Luan Rama

A.D.: Qysh kur për herë të parë kam lexuar Laookontin e Lessing, më ka tërhequr kureshtja për ta kuptuar se si shtegton një subjekt artistik prej një vepre te tjetra. Si nëntitull i esesë është Kufijtë e të pikturuarit dhe poezisë. Ju jeni vetë edhe piktor, edhe poet. Në përjetimin e këtyre dy dimensioneve artistike, si i identifikoni këto kufij? Si ndodh brendashkrimi i një subjekt në një formë të artit dhe jo në tjetrën? Nëpër çfarë procesesh kalon?

H.M.: Francis George Steiner ishte ni kritik letrar franko-amerikan, eseist dhe filozof, i cili poezinë (dhe gjuhën) i vë nalt në thelbin e qenies.

Ashiqare, gjuha është streha e qenies, atëherë e begenisi (dhe mësyj me e shkru) poezinë e mendimit, si akt gjuhe. Jam shkrimtar i gjuhës shqipe.

Steiner pohon, çdo filozofi është ni akt gjuhe. Ritmi, fjalori, sintaksa, gjithçka që na shpie drejt poezisë, e gjajmë edhe në tekstin filozofik, sado abstrakt me qenë ai. «Çdo mendim fillon nga ni poezi », shkruente Alain simas Steiner, në lidhje me Valéry-në.

Unë, kur më mungojnë fjalët, e thom tregimin tëm ose menimin me ngjyra, e kur s'munem me e bā t'nimëte, me pak fjalë shkruaj prozë, tue migrue në ni art tjetër, atë të pikturës ose tregimit.

Steiner thotë se jeton sipas meseles së rabinit Baal Shem Tov-it, të shekullit XVIII : «E vërteta është gjithmonë në mërgim.»

Po në kesi migrimi nga ni art tek tjetri, unë kërkoj mendimin dhe përmes artit e gjaj thelbin e gjānavet. Brimën e ni bubrreci. Klithmën e ni flut're.

Gjāmën e ni nāne.

Trishtimin e ni të truemi. Habinë e ni mendimtari. Pikëllimin e mallkimin e ni jetimi.

A.D.: Thuhet shpesh se shkrimtari punon natën, ose nata është streha e shkrimtarit e gjëra të tilla. Ndërsa piktori ka nevojë për ditën, sidomos për dritën e ditës. Këto dy thënie, dy ide, i shihni si konvencione të tejkalueshme, kurrësi absolute apo ndodh vërtetë kështu, që ju pikturon ditën dhe shkruani natën?

H.M.: Varësisht rrethanave unë shkruaj e pikturoj edhe natën edhe ditën, por ditën vetëm kur digjoj heshtje përreth, pra në vetmi. Kur jam me njerëz nuk shkruaj, flas me ta dhe dëgjoj tregimet e tyne, kush e di, munen me rryfe pahiri naj kod letrar, munen me u bajtë në tregimet e mia si personazhe, jeta e të cilëve nuk është trill por magji, e Marquez thojke se nuk ka ma të magjishëm se realiteti. Porse, pak janë ata që dijnë me rryfe.

Me e thënë ni t'kânme kâjshëm.

A.D.: Besoni se poezia juaj mund të jetë e atillë që mjafton ta lexosh dhe po mbylle sytë, tabloja me të njëjtën përmbajtje të shfaqet para, e lirë për t'u shijuar?

H.M.: Për ekspozitën tëme personale të pikturave "Kujtesa e ujit" m'u kujtu ni titull i shkrimtarit për fmijë, Rexhep Hoxha, "Lugjet e verdha" dhe pikturova



ni gurrë e ni lug, ku janë gdhend figura hyjnishtë e gjysmë hyjnishtë, toteme, ftyra gjyshash e shtojzovallësh si në legjenda. Nashta edhe nuk ka ni gurrë megjith lug me toteme të gdhenduna, po mue ashtu m'u shfaq, se uji duhet me majt mën ftyrat që ulen me pi...

Por, jo çdo poezi është pikturë se, piktura nuk e duron shumë mënimin e narracionin sa memecninë, të pathënshmen (Witgeinstein);

E, s'ā poezi beli, nëse nuk e bān me folë ni nēmenc (memec)!? Kur më mungon gjuha, si ni memec hedh ngjyrë në panël. Natyrisht nxitun nga ni traumë. Çue peshë nga ni āndërr! Ni dashtuni.

A.D.: Me ka bërë shumë përshtypje një poezi juaja e cila fillon me *Syrgjynosun āndërr*. Jemi mësuar përherë t'i shohim dhe përkthejmë ēndrrat si hapësira të

pamata lirie, ndërsa këtu e kemi unin lirik, poetin, frymë, shpirtin, le ta quajmë ashtu sikurse duam, të syrgjynosur brenda kësaj hapësire (zakonisht) lirie. Andrra e këtushme është ajo e para, që shihet në gjumë apo edhe shpresa, ajo çka urojmë dhe duam të ndodh? Në të dyja gjendet i syrgjynosur njeriu? Nëse po, atëherë ia s'mund të jetë i zhgënjyer prej saj, pasi askush s'pret ndonjë gjë të mirë nga vendi ku syrgjynoset. Apo jo?

H.M.: Artisti m'doket është specia e vetme që e kalon me let'sim kit kufi mes dy botësh paralele brenda t'njātit entitet: të pandërgjegjshmes (āndrrës) dhe koshiençës (zhganrres);

Unë kam pa āndërr krejt anët tragjike të jetës tëme dhe kur më ka ndodhē ni e ngjame në jetë, i kam thānē vetes: Qetu kam qenē, qekjo m'ka ndodhē, tashma e pame!





Vakitë ma t'dhimshme i kam përjetu nga dy herë - jo sikur historia që na shfaqet dy herë, spari si tragjedi e përsdyt si farsë - por dy herat trishtim.

Sëkēndejmi, kur trishtimin e përjeton dy herë, qe rasti i artë me e përjetësu në letërsi, me e gatue nga ai brum ni vepër arti "që ruen dhe ruhet" (Deleuze & Guattari.)

Gjermanishtja e ka 'Der Traum' për āndrren por shqipja e ka fjalën unike zhgjandërr, që nuk dmth. realiteti i jetuem, por përsdytja e traumës!

Nuk di nëse ka ndoni shkrimtar si qifti jēm, që e ka paralajmru për vetveten e përmes vetes edhe për njerzit tjerë në ni Atdhe, tmerrin, mizoritë, burgun e torturën, kampet e përqëndrimit, sepse i kam përjetu në āndërr të gjitha ato pamje e vende, madje edhe dhimtë (dhe i kam shkru), shpesh si kode e ndojherë me duhmën e reales, masanej m'ka torturu vesvesja pse ia ndillsha vetes gjith ato fatkeqësi!? Letërsia është piknisht kjo traumë e njeriut, si qenie tragjike në botë, e vetmja qenie e vetëdijshme për dekën e vet, është āndrra (ose parandjenja) sëkēndejmi letërsia na bān aq ndijor sepse është pikëllimi ynë në botë. Āndrrat janë jetët tona t'pasosuna, të kodueme e intensive (zgjatim i jetës) sëkēndejmi letërsia e thotë të mundshmen para dhe mas,



kurse librat e shumëzohen njerëzimin.

Na rrnojme nëndrra t'pakufishmen, e çohemi n'mjes t'piklluet ose gzuem, varësisht traumes sonë.

Vallë ku jemi kanë, çka bëmë e çka përjetuem prëmë, derisa flejshim!?

Ndojherë poezitë tona i ka thënë dikush që nuk din me shkru ose ni dorë e fshehin vis major!?

Po kush more e shkruen tekstin e autorit?

Që nga Iliada e Homerit e Hamlet-i i Shakespeare, e deri në ditët tona, kritika e bân të njëjtën pyetje: Kush e shkruen tekstin e autorit?

Athu intenca e kthimit/Itakat tona janë vorret tona, sepse ideja e kthimit të kujton dekën, mes njerëzve të njohtun, sepse, siç thotë Karl R. Popper-i “në qendrën më të thellë të qenies tonë, ne jemi krijesa shoqnore.”

Simas këtij autori nuk munet me pasë imagjinim ma t'gabuet se menimi se dikush munet me fillu diçka nga e para, i lirë nga e kaluëmja ose pa qenë borxhli ndaj askujt!.

Kush dhe përse “ma diktoi” tregimin “Lojë” që shpërfaqte dialogje letrare, ekscentrike e të anktshme dhe po aq reale, për kampet e përqendrimit, më 1996, tek libri “Lajmësi memec” dhe si u gjeta në ni kamp të njimendët më 1999?

A thue forca të padokshme totemike i flasin atij (autorit) dhe i kërkojnë të mos zmbreset nga rruga e tij, e kërkimit estetik, (dhe e zbulës!?) e cila tashmë kërkon tjera vlera e kode: Totemet e të shkuarës si fatum-i nietzschean dhe rikthim i përhershëm i të njëjtës!?

Në këtë kërkim pa fund, Tomas Mani shkruen se ne nuk mendojmë e veprojmë si subjekte autonome sepse tjerë mendojnë e veprojnë brenda nesh.

Është historia e tănë, që rri pas nesh e na i bân ‘refresh’ informatat e kodifikueme nga e shkuemja jonë, duke na dhënë ni forcë ose energji të re për ripërtrimje.

Rrugës së njëjtë i biem dy herë!

Niherë në letërsi dhe ni herë në realitetin brutal historik.

Kam shkru dy libra për me hedh dritë mbi misterin e atyne forcave shtytëse misterioze qe e bëjnë letërsinë ma të vërtet se e vërteta, “Udhëtim nëpër ëndërr të keqe” (1994) dhe “Udhëtim nëpër zgjandërr të keqe” (2000.)

Të vërtetat letrare janë ndryshe nga të vertetat historike, shkencore, filozofike. Ernesto Sabato thotë se aty ku shkenca dhe filozofia mbarojnë, aty fillon letërsia. Të vertetat letrare janë metafizike, të painterpretueshme me metodologjinë e njohjes shkencore. Por letërsia ekziston, është e pranishme dhe mbijeton se vetë njeriu është qenie metafizike, është i njohshëm, i prekshëm, i përceptueshëm, por ndërkaq është shumë më tepër i paarritshëm, i papërceptueshem, mistik në vetvete. Kur një krijim letrar i duket lexuesit më i vërtetë se vetë e vërteta, është shenjë se kemi të bëjmë me letërsi, që i kapërcen kufijtë e të zakonshmes. Njëjt mendonte Ernest Hemingway, për të, të gjithë librat e mirë kanë një gjë të përbashkët: Ngjarjet e tyne janë më të vërteta, sesa nëse do të kishin ndodhë realisht!



Halil Matoshi (1961)

Ka studju për filozofi por me profesion është gazetar e me zâ, poet.

Katër herë i arrestuem nga regjimi serbian, gjatë Lëvizjës së Rezistencës antifashiste dhe luftës së Kosovës (1990-1999);

Është autor i librave:

“Frymë varresh në dallgore”, bota e re, 1988, poezi; “Udhëtim nëpër ëndërr të keqe” (Zëri, 1994); “Lajmësi memec” (Zëri, 1996), “Udhëtim nëpër zgjandërr të keqe”, (Zëri, 2000), “Hija e Krishtit” (Sheshi, 2004), “Katedrale prej letre” (Koliqi, 2012), “N’zanafillë” (OM, 2013) dhe “Gdhendje drite”, (Multimedia, 2021); “The Lil’s poem”, Littera, 2023.)

Poezi të tij janë përkthye në gjermanisht, spanjisht, sllovenisht, serbisht e kroatisht, turqisht, rumanisht, greqisht, anglisht.

Kjo është liria krijuese, e kufizuese në thelbin e saj, në mister.

Kjo është e magjishmja e poezisë! E letërsisë përgjithësisht.

Na veç i regjistrojmë ato zâna njerëzish a traditash e besimesh, gverresh e pengjesh... apo zâna të një gjeli që të zgjon në mjes kur ke ni punë, të ni xixëlloje, qenit a maceve, apo thjesht zâ natyre, ushtimë ere, gurgullimë përroi, rima shiu.

Kjo është letërsia, çelësi i përjetësisë apo kodi. Na shkruemjë me u bâ t’përjetshëm.

Nietzsche-ane.

“Kemi artin mos me dekë nga e vërteta.”

A.D.: Deri tani folëm për jetën tuaj mes piktorit dhe poetit, por në çdo kërkim timin lidhur me emrin tuaj, prezantimi i parë që bëhet është poet dhe publicist. I mirëkuptoj gazetarët që shkruajnë prozë (ose prozatorët që janë edhe gazetarë), më duket diçka shumë e natyrshme. Ama pozia dhe publicistika më duken larg njëra prej tjetrës, s’e di, ndoshta e kam gabim. Sa komunikojnë këto dy hapësira të të shkruarit dhe mbi të gjitha, e keni zbuluar mënyrën si komunikojnë?

H.M.: Publicist dhe poet? Mirë kish me qenë me qenë veç poet, porse si publicist e ke ni rast të artë, me digjue të tjerët dhe me u gjetë në vorbull magjike. Nashta bâhesh poet?

Po Faik Konitza s’u ba poet, se ish shumë racional e kritik. Poezia do dashamirësi, jo kritikë.

A.D.: Si mendoni, a duhet të jetë shkrimtari i angazhuar?

H.M.: Po, shkrimtari ka veç ni angazhim, përmes të keqes, dhimtës, pikëllimit, vetmisë me i paralajmru njerëzit për fatkeqësitë, për luftën, urinë, mizoritë. Shkrimtari duhet

me u bâ mburojë e lirisë si parzmorë udhtarësh që pret tehet a plumat. Rrufepritsa t’ni shoqnie janë shkrimtarët, si Visar Zhiti. E kur shkrimtari bân letërsi të madhe, i bâhet mburojë njerëzimit. Si Camus a Kafka, si Marquez a Coetze; si Borges, Camaj. Szymborska e Transtromer.

Presidenti amerikan Ronald Regan pat thënë se na jemi gjithmonë larg luftës veç ni gjeneratë! Shkrimtari e ka për detyrë me paralajmru.

Ky është angazhimi i tina.

A.D.: Natyra e pikturave tuaja më sjell ndër mendje disa pyetje hipotetike, pyetje që sikur burojnë nga laramania e ndërکمbyeshmëria e ngjyrave në ato tablo:

a.Pas 100 vjetësh, do të donit të kujtoheshin si poet apo si piktor, nëse me patjetër duhet të zgjedhni njërën?

b.Nëse një galeri e madhe arti do ju kërkonte vetëm një pikturë për t’u ekspozuar përherë aty, cila do të ishte?

c.Po nëse e njëjta kërkesë do ju vinte nga hartuesi i një antologjie e cila do të studiohej në çdo katedër letërsie, kë poezi do të dërgonit të përfshihej në të?

H.M.: T’kundruemit e ni vepre arti ‘që ruen e ruhet’ i përket aftësive e afiniteteve individuale perceptuese të estetikës, pa dallim në është poezi, pikturë â muzikë, por ù zgjedh poezinë, se qysh thotë Heidegger “poetikisht banon njeriu”.

Po cok, ka poezi edhe në pikturë edhe në muzikë si në artet tjera, pra edhe në dyluftim!

Dhe piktura jëme e pyetjes suej, padyshim është “Kujtesa e ujit” - Gropa ‘99, që e kam nxjerr në ballinën e librit ma t’ri me poezi të Lilit (Lil më thojnë ata me të cilët jam rritë), kurse poezia për antologji, nashta kish me qenë “Nâna i bani rângt e sh’pisë e ra me fjetë” - që përcillet nga “Poezia e Lilit”.

A.D.: Dhe në mbyllje, një pyetje që do të doja t’ja bëja të gjithë shkrimtarëve e poetëve të Kosovës: Lufta tregohet më mirë në epikë apo në lirikë?

H.M.: Lufta (trishtimi) tregohet më së miri në pikturë si “Pushkatimi” i Francisco Gojas (E treta e majit, 1808) apo “Guernica” e Picasso-s, (Frymëzimi i papritur dhe i minutës së fundit për veprën i erdhi mas bombardimit të Guernicës (26 prill 1937).

“Të burgosunit” e Vincent Van Gogh e vitit 1890;

Porse, a munet me u përmbledh trishtimi që sjell lufta ma fort e në mënyrë neveritshëm brilante se tek “Klithma” e Edvard Munch.

“The Scream” e Munch, 1893. U bâ imazhi përfundimtar për epokën tonë politike Piktura e tina është ni kryevepër për të tana kohnat e trazueme.

Jonathan Jones e përthekon kështu: “Fytyra është si ni çorapë jeshile me mish të prishun, e shtrime fort mbi kafkë. Tiparet e saj janë djegun nga dhimbja. Gjithçka që mbetet në maskën e zgjatun janë dy sy të gjanë, të rrmullaktë me pika për bebëzat, ni palë hundë të zeza dhe ni gojë e hapun në një ulërimë ovale. Të gjithë kemi qenë atje.”

Proza (epika) përshkruen ose parathot dilemat morale të njeriut në luftë, kurse poezia habinë që sjell ajo.

Po edhe situatat e magjishme, kur anmiku të hleshohet, ose kodrat kur nisin e vallëzojnë gjatë bombardimeve (si dy t’dashtunuem ne ni ballkon në Prishtinë, në ni poezi tek libri jëm “Hija e Krishtit”).

Po edhe ni i çmendun që tallet me skuadrën e pushkatimit, tek Arben Idriizi, ni i nëmitun (memec) që flet para se me e pushkatu (ni poezi jëmja tek “The Lil’s poem” (Poezia e Lilit);

Unë shkruaj me e bâ t’zëshme të nëmitunën dhe me e shti me folë ni nëm (memec);

E thjesht pra.

Familja “Durazzo” e një emigranti shqiptar që la Durrësin në vitin 1389 dhe u nis drejt aventurës, e cila nxorri 9 dozhë (presidentë) të Republikës gjenoveze, 30 ambasadorë e konsuj, shumë e shumë senatorë, ndër të cilët dhe dy kardinalë të famshëm, njerëz të artit e të letërsisë e jezuitë të njohur në botën e dorëshkrimeve, etj, u bë ndër më të njohura në metropolet europiane në shekujt XVII-XIX. Një pinjoll i kësaj familje ishte dhe Giacomo Durazzo, një nga mecenët e artit, ish ambasador dhe drejtor i Teatrove Imperialë të Vjenës, para të cilit do të jepte koncert në Venecie dhe djaloshi i ri i quajtur Mozart. Gjithë këta njerëz të mëdhenj ishin dhe amatorë të famshëm të artit, veçanërisht pikturës, skulpturës e librave të rrallë, të cilat zbukurorin pallatet e tyre jo vetëm në Gjenovë por edhe gjetkë në Italinë e veriut. Më 1719, siç shkruhet në “Atti di Societa Storia e Patria”, Durazzo-t kishin si konsulent të tyre për blerjen e veprave të artit një piktor të njohur, Paolo Gerolamo Piola dhe se nga një vizitë në Bologna e Firenze, ata ishin kthyer me disa vepra të Guido Reni-t dhe të Veronese-s. Disa vite më vonë, më 1724 ata blenë në Madrid një vepër të Rubens, që kishte qenë pronë e mbretit Filippi IV dhe një “Madalena” të Tiziano-s. Vazhdimisht investonin në pasurimin e koleksionit të tyre të veprave të artit duke u dalluar ndër gjithë fisnikët e tjerë gjenovezë. Në Revistën e Muzeumeve të Italisë (Revue des Musées d'Italie, Catalogue raisonné des peintures et des sculptures...) historiani i artit André Lavice, i bën një përshkrim të hollësishëm veprave të artit që ishin në Galerinë Durazzo në atë kohë. Ja çfarë shkruan ai, duke rradhitur autorët e ndryshëm sipas emrit alfabetik dhe veprave të tyre që ishin në Galerinë Durazzo:

- Amerighi (Michelangelo) i mbiquajtur Caravaggio – “Psyché” një figurë e shtrirë pranë Dashurisë dhe që fle në gjirin e saj. Në të djathtë, në hije, duket një Faune që vështroon duke qeshur. Balli dhe sytë e Psyché-së janë gjithashtu në hije, ndërsa pjesa tjetër është e ndriçuar mirë;

- Badigalopo (Giuseppe) - Gjashtë figura historike;

- Barbieri (Giovanni Francesco) i mbiquajtur Guerchin - Monedha e Cesar-it, një tablo e mrekullueshme, por mjerisht disi e dëmtuar. Po ta krahasosh me atë të Van Dyck, figura e Krishtit është më pak e bukur, por personazhet e dyta janë të pikturuara mjaft mirë. – Peshtë shpëtimtari që i shfaqet nënës së tij pas ringjalljes dhe që përkulet te Maria, në gjunjë. Pas tij duket një apostull që mban Kryqin e Pasionit. Majtas, në qiell, endet një engjëll.

- Bonacorsi (Piero), i mbiquajtur Pierino del Vaga – “Virgjëresha që ushqen Jezunë”.

- Boni - Akili, të cilin Thétis ia beson Centaurit. Fëmija që përqafon nënën gjithë afsh. “Nimfa dhe centaure”.

- Caliarì (Paolo), i mbiquajtur Veronese – “Martesa e Katerinës”, një tablo e vogël dhe disi e dëmtuar.

KOLEKSIONI I FAMSHËM I ARTIT I FAMILJES DURAZZO

Nga Luan Rama

- Caulasi (Guido), i mbiquajtur Cagnacci – “Akili midis grave të Lycomedes”. Ka një veshje femrash dhe tund shpatën në ajër. Uliksi i veshur si tregëtar me një arkë të hapur para tij plot gjerdanë, si dhe i rrethuar nga shumë kureshtarë.

- Cantarini (Simone), nga Pesaro – “Udhëtimi në Egjipt”, Maria ka një kapele kashte në kokë dhe anash barinj, ku njëri prej tyre prin delet.

- Carracci – “Ecce Homo”, Jezua me kurorën me gjemba dhe një pallto të kuqe;

- Castello (Valere) – “Engjëjt që kanë shkuar te Abrahami”. Patriarku u sjell miqve një pjatë në tavolinë. Sara duket në sfond;

- Castiglione (Benedetto), i mbiquajtur Greghetto – “Agar dhe Ismaili”. Nëna që ka ngritur vellon që mbulon të birin, tek klith dhe kthehet me ankth nga engjëlli që po vjen djathtas;

- Dyck (Antoine van) – “Portret burri i veshur me të zeza”. - I riu Tobie që mban peshkun, i ndjekur nga qeni i tij. Në ajër duket engjëlli. - Portret i një fëmije i veshur me mëndafsh të bardhë dhe që mbështetet te një karrige. Në tokë duken fruta. - Dy djem dhe një vajzë në mes. Fëmijë të këndshëm. - Portret i një bjonde të bukur, e ulur. Një dorë e saj është mbi kokë ndërsa tjetra mbështetet mbi një nga fëmijët, i cili është në këmbë pranë saj.

- Ferrari (Gaudenzio) – “Madona me fëmijën”.

- Franceschini (Paolo) – “Thétis që hedh fëmijën e vet në Styx”, duke e kapur nga thembra. Nimfa përreth.

- Langetti, gjenovez – “Shën Pjetri në burg”, i ulur me trupin dhe profilin e ndriçuar mirë. Një grua pranë tij është në këmbë dhe duket se i numuron ditët që i kanë mbetur për të jetuar. Prapa, gardiani duket në hije. – “Vetvrasja e Ameleck”. Ai është i shtrirë përtokë me një kurorë në kokë. Një ushtar mban në dorë një thikë që sapo e ka tërhequr nga plaga e tij e madhe, të cilën po e shikon një plak. – “Urimi i Jakobit”.

- Lotti (Charles) – “Jakobi me rrobat e përgjakura të Jozefit”.

- Merighi (Francesco) – “Vdekja e Akilit”. Ai është me mjekër. Një njeri që mban një hark dhe një grua, vështrojnë trupin e shtrirë në tokë.

- Monti, bolonjez – “Akili që tërheq trupin e Hektorit”.

- Moroni – “Portret plaku”, i cili është me mjekër të bardhë dhe me pallto të zezë.

- Pellegrini (Antonio), venecian – “Betimi i Gertrudës”, nëna e Hamletit, një grua ende e re dhe në plan të parë.

- Piola (Domenico) – “Fëmijë”.

- Procaccini (Julio Cesare) – “Gruaja adultere”. Fajtorja është e tmerruar para Krishtit dhe ithtarëve të tij.

- Reni (Guido) – “Mëshirë romane”. Vajza e lumtur që po mban të gjallë të



atin. – “Shën Eustache”, i cili është në gjunjë mes kalit dhe qenit të tij. Rreze drite në qiell dhe majtas një engjëll. – “Shën Jeronimi që shkruan”. Një nga mënyrat e para të pikturimit të Caravaggios. - Vestale, një grua, koka e së cilës, gjysma është e mbuluar me një vello deri te sytë. – “Kleopatra”, një kokë e bukur dhe me një trup në një reliev të mrekullueshëm. – “Porcia”. – “Fëmijë i shtrirë anash”;

- Ribera (Josef) – “Shën Jaku” me shkopin e gjatë, me një mjekër të zezë dhe një dritë të mrekullueshme. – “Një filozof”, një plak i thatë me supin dhe gjysmën e trupit të xhveshur. - Demokriti. Ai qesh duke treguar me gisht një vend në glob. – “Herakliti”, i cili bën të njëjtin xhest me gisht dhe që qan. – “Shën Jeronimi”.

- Rigaud (Hyacinthe) – “Portret i Ipolito Durazzo”, si një kalorës simpatik dhe veshje mbrojtëse, si dhe me një kapele të gjerë si ajo e Louis XIV.

- Riobusti (Jacopo), i mbiquajtur Tintoretto – “Portret i bukur i Agostino Durazzo”.

- Rubens (Pierre Paul) – “Portreti i tij me rroba të zeza dhe një kapele të gjerë”. – “Portret i Filipe IV”, në këmbë.

- Strozzi (Bernardo), i mbiquajtur Cappuccino – “Peshkopi”, një figurë në këmbë, me mustaqe të zeza dhe pa kapele, më shumë një figurë ushtaraku sesa besimtar i devotshëm.

- Vannucchi (Andrea), i mbiquajtur Del Sarto – “Madona”, një tablo e vogël dhe e rrumbullaktë, ku nëna dhe fëmija janë pikturuar shumë bukur.

- Vecchia (Piero) – “Krishti dhe dy xhelatët”.

- Vecellio Tiziano, i mbiquajtur Tiziano – “Madalena”, me flokë të gjata mbi gjinjë e saj të xhveshur. – “Cèrës me Bachus”, një nimfë si dhe Dashuria.

- Shkolla veneziane – “Davidi duke marrë bekimin e Zotit nga dora e Samuelit”. Davidi është shumë i ri.

- Zampieri (Domenico) – “Vdekja e Adonis”. – “Shën Sabastiani”, i lidhur pas një peme.

- Zanchi (Antonio) – “Sakrifica e Jeffe”, i cili është i xhveshur dhe duarlidhur. Mbreti e ka kapur për flokësh.

- Zanetti (Domenico) – “Akili që merr nga duart e Thétis armët për tu hakmarrë ndaj vdekjes së Patroklit”.


Në vitet 1700, koleksioni privat i



Palazzo Reale, Genova

Durazzo-ve përfshinte mbi 400 vepra arti të autorëve më në zë të epokës. Në këtë koleksion bënin pjesë dhe një numur i madh skulpturash, veçanërisht të skulptorëve të famshëm në atë kohë si Domenico dhe Filippo Parodi. Skulpturat e tyre, krahas skulpturës romane të Vitellius, qëndronin plot hire në mjediset e vilave të Durazzo-ve dhe së pari në “Galerinë e Pasqyrave” (ku në dekorat e saj Nicole Kidman do të realizonte rolin e Grace Kelly në ditët tona), siç ishin veprat në mermer “Metamorfozi”, “Stagioni apo Mito di narciso”. “Gesu bambino dormento” është padyshim një kryevepër e Parodit. Në fakt Durazzo-t e pëlqenin shumë dhe skulpturën e në veçanti kur ishte fjala për portretet e tyre në mermer, siç ishin portretet e Gio Luca Durazzo, Marcellino apo Stefano dhe Eugenio Durazzo. Kush më mirë se mermeri do t’i bënte ata të përjetshëm?...

Një përshkrim akoma më interesant kemi në një botim të vjetër rreth madhështisë së Palazzo Reale Durazzo, ku jetoi kjo familje prej dy shekujsh dhe ku ishte një nga koleksionet e mëdha të Europës dhe pronë e një familjeje të vetme: Durazzo. Ja pse vizita e këtij pallati të cilin kam patur fatin ta vizitoj dy herë bashkë me konsullin e Shqipërisë në Monako, Giuseppe Durazzo, ishte atëherë nga itineraret e çdo udhëtarit europian që kalonte nga Gjenova: Rubens, Van Dyck, Rembrandt, Tiziano, Veroneze, etj, etj, gjenitë e artit figurativ ishin aty. Duke përshkruar Pallatin Durazzo, autori shkruan: “Ky pallat është më i madhi dhe më i denji për të qëndruar një sovran, pasi i ka të gjitha komoditetet që duhen, apartamentet e mëdha, një bibliotekë të pasur, një teatër, një oborri të gjerë dhe një perspektivë të bukur në “Via Balbi”. E ndërtuar nga dy arkitektë Piero Francesco Cantone dhe André Falcone, me shkallët e mrekullueshme prej mermeri të ndërtuara nga kalorësi Carlo Fontana, ai të tërheq me pamjen e tij. Para se të hysh në sallon janë dy portrete në bust nga Filippo Parodi, ndërsa brenda ndeshesh me dy tablo të mëdha njëra e Bertolottos, ku duket audienca e ambasadorit Agostino Durazzo tek Sulltani si dhe një tablo tjetër e Domenico Piola ku duket darka e shtruar nga sulltani për ambasadorin nga Gjenova. Ka dhe një vizatim të bukur të Agostinos mbi kalë. Pasaj shquhen dy portrete të dozhëve Vincenzo Durazzo dhe Cesare Durazzo të piktorit Sarzana. Po kështu dhe një portret tjetër i Vincenzo Durazzo nga Molinaretto. Një tjetër dozh Durazzo është pikturuar nga Domenico Parodi. Portreti i kardinalit Marcello Durazzo është realizuar në Romë nga Morando. Galeria e vogël përballë hyrjes ka tablo të shumë autorëve me figurat e Gjon Batistit, Prometeut, Herkullit të lidhur nga Cerbere, Tituis ku skifteri i ha mëlçitë, Venusi e Dashuria, “Helena”, “Enea që mban atin e tij mbi shpatulla”, etj. Në sallonin e quajtur “Giordano”, spikat tabloja “Peren që mban kokën e Meduzës”, po kështu



Magdalena penitente, Tiziano, 1531

tabloja Seneka dhe nxënësit e tij. Ka një portret të Van Dyck. Po kështu tabloja Shën Virgjëresha dhe fëmija Jezu nga Van Dyck. Në sallonin Paolo, shquhet tabloja re Paolo Veronezes, “Dreka në shtëpinë e Simon fariseut”; ka shumë buste greke, romake, si dhe një bust të Parodit. Në sallonin e quajtur “Salloni i Kohës”, ka një kube të mrekullueshme të pikturuar nga Parodi. Është një tablo

e Holbein, një portret i Tintoretos, një tjetër portret i Tintoretos, etj. Në “Dhomën e quajtur të Aurorës” është një tablo e Caravaggios: “Shën Pjetri që mohon Jezunë”. Ka një figurë me veshje spanjolle të Van Dyck; po kështu një tjetër e Van Dyck “Kalorësi nga Kajro”; është tabloja “Catherina Durazzo” e Van Dyck, një portret burri e Tintoretto-s (gjysmë e djegur), një “Shën Pjetri” i

Guido Reni; një tablo “Burrat që luajnë dam” e Caravaggios, një portret i Paola Durazzo nga Molinaretto. Në sallonin e quajtur Salloni i Tapiserive, ka shumë portrete të familjes Durazzo: Francesco Durazzo me fëmijët, e Parodit, Eugene Durazzo nga Molinaretto; Jerome Durazzo po nga Molinaretto;. Në “Salloni i Fundit”, është një tablo e Rubens “Junion që lidh sytë e Argos”; tabloja “Familja e Shenjtë” e Van Dyck, “Lindja e Zotit” nga Tiziano; “Portreti me turban” i Rembrandt... Në Shapelën e pallatit është një tablo e mrekullueshme ku “Krishti mban kryqin”, e Tizianos, ndërsa në bodrum një kopje e “Madalenës” së Veronezes...”

Padyshim gjithë këto tablo, vetëm brenda këtij pallati, pa folur për pallatet e tjera, kanë qenë një marramendje e jashtëzakonshme për vizitorin me sqimë dhe erudit të artit botëror, e që tregojnë dashurinë e madhe të kësaj familjeje për artin. Shumë artistë punuan në pallatin e tyre, siç ishte Van Dyck, i cili pikturoi dhe një tablo të dozhit Marcello Durazzo në këmbë, apo tablo të tjera.

Para disa vitesh një ekspozitë ishte hapur në Paris në Musée de Luxembourg për 500 vjetorin e Tintoretto-s. Dhe të mendosh se tablotë e Tintoretto-s gjendeshin me shumicë në sallonet e Durazzove, e kupton menjëherë madhështinë e atij koleksioni. Le të mos flasim pastaj për “Madalenen” e Tizianos, për tablonë e famshme të Veronezes “Darka në shtëpinë e farisejve”, një nga më të shtrenjta, apo tablotë e tjera të Rubens, Van Dyck, Guido Reni... gjithçka ishte madhështi në atë koleksion që e ishin çdo ditë para syve te atyre dozhëve Durazzo, senatorëve të kësaj familjeje të cilët lanë aq shumë gjurmë në historinë gjenoveze dhe europiane.



Shën Pjetri që mohon Jezunë, Caravaggio, 1610

Filitet për mbijetesë të arbërishtes në KUVENDIN II TË STUDIMEVE ARBËRESHE, organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, zhvilluar në datat 4 dhe 5 shtator 2023 në Tiranë. Zgjedhja e kësaj tematike nuk ishte rastësore; kjo çështje kaq nevralgjike e identitetit arbëresh siç është gjuha dhe vitaliteti i saj, ka përbërë fokusin e punës së institucionit të QSPA-së në këto tri vite funksionim të saj. Ndaj edhe tematika e përzgjedhur për këtë Kuvend vinte natyrshëm pas Kuvendit të I të Studimeve Arbëreshe në shtator të 2021, pas konferencave dhe veprimtarive të ndryshme më specifike mbi këtë argument, përfshirë edhe vizitat zyrtare në komunat arbëreshe nga studiuesit dhe nga titullari i Qendrës. Për këtë arsye, u pa e udhës që kësaj here të bëheshin bashkë aktorët kryesorë që luajnë një rol jetik për rivitalizimin e arbërishtes, konkretisht: studiues të komunitetit ndërkombëtar që janë marrë dhe vijnë të merren me gjuhët e rrezikuara, me arbërishten në veçanti; aktorët politikë, do me thënë kryetarë komunash arbëreshe, këshilltarë të këshillave bashkiakë të këtyre komunave dhe, grupi i tretë i përbërë nga studiues arbëreshë, mësues të arbërishtes, drejtues revistash dhe sportesh gjuhësore, aktivistë të kauzës arbëreshe të cilët e kanë shndërruar këtë kauzë në dimensionin thelbësor të jetës së tyre.

Nga studimet e bëra në dhjetëvjeçarët e fundit, studiuesit kanë konstatuar një përshpejtim të jashtëzakonshëm të humbjes së gjuhëve të pakicave gjuhësore historike, e cila parashikohet që brenda 2100 të shkojë në shuarjen e zhdukjen deri në 50 e l'80% të idiomave të folura në botë. Ndaj kësaj situatë botërore ku, fatkeqësisht, përfshihet edhe arbërishtja, një numër gjithnjë e më i madh institucionesh kërkimore shkencore gjuhësore, po reagojnë me krijimin e rrjetëve ndërkombëtare si dhe të veprimtarive të përbashkëta. Edhe UNESCO ka dëshmuar vëmendjen e saj të veçantë; në Atlasin e gjuhëve në proces zhdukjeje ku arbërishtja përcaktohet si “gjuhë përfundimisht në rrezik”.

Edhe Këshilli i Evropës ka dëshmuar të njëjtën ndjeshmëri ndaj shqetësimeve të ngritura nga komuniteti shkencor ndërkombëtar duke miratuar në 1998 *Kartën Evropiane të gjuhëve minoritare e rajonale*, së bashku me *Marrëveshjen Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare*. (*Carta Europea delle Lingue Minoritarie e Regionali*¹, bashkë me *L'Accordo Quadro per la Protezione delle Minoranze Nazionali*².)

Italia ka sanksionuar statusin e ruajtjes së pakicave gjuhësore të saj, përfshirë edhe arbërishten, që në 1999, me Ligjin 482. Por, nga ajo kohë, zbatimi i këtij ligji ka hasur vështirësi, falë shumë faktorëve. Duhet theksuar fakti që Ligji në fjalë po aq sa politikën rajonale italiane ku ndodhen ngulimet arbëreshe, është një çështje që juridikisht i përket shtetit italian e, kështu, ajo që shtetit shqiptar i mbetet të bëjë është mbështetja politike e studimore e mëtejshme. Në këtë këndvështrim e në këtë frymë u ndërtua përmbajtja e kësaj ngjarjeje të rëndësishme shkencore. Ngritja e politikave gjuhësore të propozuara nga studiuesit në Itali nga njëra anë, por edhe diskutimi i këtij problemi edhe në komunitetin shkencor në Shqipëri, ka pasur pak rezonancë. Ndaj ky Kuvend synoi që, edhe në

KUVENDIN II i STUDIMEVE ARBËRESHE, organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, zhvilluar në datat 4 dhe 5 shtator 2023 në Tiranë.

ARBËRISHTJA GJUHË NË RREZIK?

Prof. Diana KASTRATI

Drejtoresh e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët



vijim të gjithë punës në këtë hulli që Qendra Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka bërë deri më tani, të zhvillonte diskutimin nga njëra anë me një bazë të gjerë studimore, por nga ana tjetër edhe në nivel strategjik duke bërë bashkë aktorët kryesorë politikë, teknikë e studimorë, nga bota po aq sa nga vetë arbëreshët. Impakti që parashikonim apo që Shpresonim të kishim në përfundim të këtij Kuvendi, është që aktorët e interesuar - komunitetet arbëreshe, institucionet italiane, kërkuesit shkencorë lokalë e të huaj, institucionet politike e akademike - të mund të vlerësojnë të dhënat dhe rezultatet duke i përfshirë në një koordinim tashmë ndërshtetëror. Natyrshëm që përfundimet që dolën nga ky Kuvend dyditor, do t'u serviren institucioneve tona politikbërëse për të shërbyer, eventualisht, si një platformë për strategjitë e politikën e shtetit shqiptar ndaj diasporës së saj të vjetër historike.

Objekti i këtij Kuvendi ishin çështjet që lidheshin me:

- Ekspozimin e shqetësimeve të lingvistëve në nivel evropian e ndërkombëtar në lidhje me kërcënimin real të gjuhëve të pakicave historike e të diasporave, duke sjellë përvojat analoge të tyre në menaxhimin e situatave të ngjashme me atë të arbërishtes;
- Problemet e paraqitura ndër dhjetëvjeçarë nga vetë komunitetet arbëreshe në lidhje me rrezikshmërinë që arbërishtja nëse nuk mësohet në shkollë, mund të shkojë drejt zhdukjes;
- Diskutimin për koordinimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në

këtë kauzë, si ata politikë, po aq edhe ata të mësimdhënies duke marrë kështu një panoramë të qartë të kompetencave të secilit syresh, si dhe të rolit të shtetit shqiptar në këtë çështje;

- Nevojën nga ana e institucioneve të kërkimit në Shqipëri dhe trevat shqipfolëse për të koordinuar dhe ndërtuar një bashkëpunim real me institucionet evropiane dhe ndërkombëtare në favor të mbrojtjes së kësaj gjuhe.

Cilët ishin studiuesit ndërkombëtarë e arbëreshë që thanë fjalën e tyre kompetente në këto dy ditë dhe cilat ishin argumentet që trajtuan? Harta gjeografike, e thënë kështu, ishte e gjerë dhe e larmishme duke filluar nga studiuesi **Salem Mezhoud** (Federation of Endangered Languages) Londër, me “Sfidat për gjuhët e rrezikuara në ditët e sotme”, me **Eda Derhemini**, University of Illinois, USA, me “*Gjuha e zemrës*” ka nevojë për një zemër që rreh – rasti i arbërishtes në shekullin e 21-të”, me **Christopher Moseley**, SSEES – University College London, me “Korniza për vlerësimin e niveleve të rrezikshmërisë - çështje dhe sfida”, me **Cor Van Der Meer** (Mercator European Research Centre, Fryske Academy, Netherlands), me “*Aktivitetet e Qendrës Kërkimore Evropiane Mercator dhe rasti i frizishtes*”, **Vera Ferreira** (The Endangered Languages Archive (ELAR), me “*Nga dokumentimi gjuhësor tek rivitalizimi: raste në kontekstin evropian*”, **Claudia Soria** (CNR, Institute for Computational Linguistics), Itali, me “*Një e ardhme dixhitale për arbërishten*”, **Carmela Perta**, Università degli studi G.D'Annunzio Chieti

Pescara, me “*Shtrirja e arbëreshëve në Molise nga një këndvështrim diakronik*”, **Christian Voss** (Humboldt-Universität zu Berlin), me “*Kur strategjitë e rigjallërimit nga poshtë-lart takohen me ato nga lart-poshtë*”, **Damiano Guagliardi**, President i Federazione delle Associazioni Arbëresh (FAA) Kalabri, me “*Zbatimi i ligjit 482, ndikimi i tij: mbështetja e dëshirueshme institucionale*”, **David Bradley**, La Trobe University, Australia, me “*Politika gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor për zhvillim kombëtar: shembuj aziatike*”, **Demetrio Crucitti** (già Direttore RAI) Calabria, me “*Prania e arbëreshëve në mediat publike dhe private, krijimi dhe transmetimi i programeve televizive kushtuar arbëreshëve dhe krijimi produktiv i zinxhirit të furnizimit*”, **Federico Gobbo**, University of Amsterdam, me “*Çështje të hapura të kontestimit gjuhësor në Itali - Gjuhët rajonale dhe minoritare në Itali si gjuhë të kontestuara*”, **Edmond Cane**, QSPA, Tiranë, me “*Përcaktimi i niveleve të përdorimit të arbërishtes, transmetimi i saj ndër breza, priorizimi i faktorëve, si parakushte për politikën gjuhësore*”, **Francesco Perri**, Vaccarizzo, Cosenza, me “*Tendencat demografike në komunat arbëreshe në Itali*”, **Fernanda Pugliese**, Coordinatore Sportelli Linguistici, Arbereshe e Croato, Direttore Editoriale Rivista Kamastra e Videonotiziario, me “*Gjuha arbëreshe në bashkësitë arbëreshe të Molise-s. Gjendja aktuale*”, **Ambrogio Bellizzi**, Mësues arbëresh, Firma, Cosenza, me “*Mësimdhënia në arbërisht – kurset ekstrakurrikulare*”, **Noè Andreano**, Kryetar bashkie Casalvecchio (Qefti), Itali, me ndërhyrjen e tij on line mbi politikën e ndjekura nga komuna e tij në lidhje me kurset ekstrakurrikulare të arbërishtes, **Ilaria Licursi**, Këshilltare e Këshillit Bashkiak të komunës arbëreshe San Martino di Finita në provincën e Kozencës, **Carmine Stamile**, mësuesi 90 vjeçar nga komuna Shën Japku, Cerzetto (Cosenza), me një sintezë shumë të vyer prej dëshmitari e protagonistit të rrugëtimit të të mësuarit të arbërishtes e të të shkruarit të librave për të nxënë arbërishten, e plot të tjerë.

Duke e parë Kuvendin nga largësia e disa ditëve, duke u nisur edhe nga mail e letrat përgëzuese të dërguara stafit të Qendrës dhe titullarit në veçanti mbi ecurinë dhe mënyrën efikase (të shkëlqyer, madje, cilësore), por edhe duke respektuar thënien e mençur “Lëre gjykimin të ftohet”, mund të shprehemi se Kuvendi ishte jo thjesht një tubim i çmuar për synimin për të cilin u organizua, por mbi të gjitha për kumtet, debatet konstruktive që solli e për përfundimet që nxori. Më i rëndësishmi është ai i të qenurit në një mendje të të gjithë aktorëve pjesëmarrës “me duar në brumë” prej një jete, se arbërishtja është në fazën e mbijetesës, të një gjuhe tashmë të rrezikuar; se ndërhyrjet nga të gjitha anët duhet të jenë urgjente e me përfshirjen e paanshme të të gjitha forcave kryesore të kësaj çështjeje, pra politikanë, studiues, komunitet shkencor ndërkombëtar, aktivistë dhe, me mbështetjen e shtytës e shtetit shqiptar. Ajo që mbase më shumë na entuziasmoi dhe na bëri shpresëplotë si Qendër, ishte inkurajimi dhe ftesa e hapur e komuniteteve arbëreshe që mos ta ngadalësojmë hapin për asnjë arsye, për asnjë pengesë që na është shfaqur e që vijon të na rrijë mbi kokë, që mbështetja e tyre ndaj punës së qendrës është e paanë, se komuniteti shkencor evropian e jo na ka hapur dyert për bashkëpunim me propozime konkrete.

¹ <https://www.coe.int/en/web/european-charter-regional-or-minority-languages>

² <https://www.coe.int/en/web/minorities/home>

Mbi varrin e Shekspir midis të tjerash janë edhe këto dy vargje:

“Bekuar qoftë njeriu që këta gurë i kursen,

Mallkuar qoftë ai që kockat m'i rrëmben.”

Me thelb të njëjtë, por në kontekst të ndryshëm historik, edhe romani “Shpërngulja e të vdekurve” merret me kockat, jo për të marrë një copëz nga lavdia e dikujt, por për të ruajtur identitetin kombëtar. Përdorimi i toponimeve, viteve dhe inkuadrimi i të vërtetave historike më futi në një grackë nga ku dola fare rastësisht kur vura re se vendlindja e rrëfimitarit ishte Suka kurse e shkrimtarit Gërçeci. Kjo gjë përmbysi edhe raportin mes reales dhe trillit dhe i bëri magjithë dhe legjendat lehtësisht të përtyqshme. Duke pasqyruar zhvendosjen e një fshati nga Shkreta e Rekës së Epërme në Sukë shkrimtari jo vetëm ka sjellë fatin e pikëllimit të një pjese të kombit shqiptar dhe trojeve të tij, por e ka kthyer atë në një thirrje të fuqishme për të rikuperuar gabimet e së shkuarës. Shqiptarët nuk janë endacakë, ata shquhen për lidhjet e forta me rrënjët nga fillon e ushqehet vitaliteti i tyre, ata kanë ruajtur të gjallë një nga gjuhët më të vjetra të Europës, ata janë autoktonët që i mbijetuan përpjekjeve për asimilim ose dëbim. Duke u ndalur edhe pak në këtë kuadër të përgjithshëm historik dhe atdhetar të veprës nuk mund të mos bashkohemi me dhembjen e autorit për Iliridën e humbur prej Mollës së Kuqe te Dibra e Madhe dhe për kryeqytetin e mohuar shqiptar të Shkupit, i cili vetëm pak më shumë se një shekull ishte vendi ku gëlonte shqipja dhe zotëronin shqiptarët. Ndalesa e parë hipotetike: Po sikur të ishte bërë? Do të ishim fatlumë se mund të ishim bashkuar të gjithë shqiptarët në një shtet të vetëm. Por mund të ishim edhe fatkeqë se, duke u pushtuar nga serbët apo bullgarët, mund të ishte fshirë përfundimisht gjuha dhe kombësia shqiptare.

Rrëfimtari sjell historinë e një familjeje në tre breza që ka dhënë ndihmesën e vet për qëndresën ndaj synimeve asimiluese dhe për mbajtjen gjallë të flakës atdhetare. Nuk më duket shumë bindës gjyshi që kthehet nga Damasku dhe ndjehet bosh që nuk arriti në kohë për të qenë pjesë e dërgatës shqiptare të Shkupit, por më tingëllon natyrshëm qasja atdhetare e babait kur guxon të ngrihet mbi çallmën e hoxhës në vitin 1960, në Duqanxhikun e Shkupit, ku ishin mbledhur hoxhallarët e njohur të Shkupit e Kumanovës për të diskutuar për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Hoxhë Dema, duke qenë më shumë atdhetar se klerik, ka guximin të deklarohet kundër shpërnguljes: “Ne merremi me murimin e urës që bashkon bregun e lindjes me atë të vdekjes, por ç’vlen ajo urë nëse brigjet ku do vdesim, nuk do kenë shenjë e bregut ku kemi lindur.” (f.88.) “Ajo urë duhet gozhduar me mbrojtjen e qumështit të nënës dhe të dheut ku ke lindur... Unë jam i gatshëm të mëkatoj, nëse kjo është e vetmja rrugë për të shpëtuar popullin tim.” (f.89) Fill pas kësaj vjen ndërhyrja mbështetëse e hafëz Idrizit: “Feja pa komb dhe kombi pa besimtarë, është si lumi pa ujë.” (po aty). Edhe pse përmendet thjesht si fakt, qëndrimi i Demës një muaj në Kosovë gjatë kohës së luftës që zhvillohej atje, i shërben pasurimit të jetëshkrimit të tij atdhetar.

Atdheu fillon nga familja, ushqehet dhe mbështetet prej saj, rritet në përmasa të reja kur del nga familja e bashkohet me fshatin, del nga fshati e bashkohet me vendlindjen e madhe. Ja pse amaneti i gjyshes për rrëfimtarin është edhe mesazhi i madh që u përcillet me po aq patos edhe gjeneratave të reja sot, pasi lëvizjet demografike kanë marrë përmasa të tilla që, siç shkruan autori: “...shtohet numri i kullave të mbetura shkretë.” (149)

Historia shqiptare personifikohet me figurën e gjyshes së rrëfimtari dhe ka arritur

Romani “Shpërngulja e të vdekurve” i
Kim Mehmetit, Saras 2015

PIKA PIKËLLIMI NË ILIRIDËN E HUMBUR

Nga Kosta Nake

të krijojë modelet shqiptare aq të ngjashëm me Hoze Arkadion, Ursulën dhe fshatin Makondo të Markezit. Duket paradoksale, por është e vërtetë, se gruaja shqiptare ka luajtur një rol përcaktues në fatet e kombit tonë, edhe pse mjedisi shoqëror ishte tepër patriarkal. Sikur të mos mjaftonte gjyshja, autori ka shkruar edhe më tej me një tjetër figurë të spikatur si Fatushja që zbrit në Jug deri në Çamëri për të zbuluar thesarin e mbetur atje pas dëbimit të çamëve për të riparuar shtëpinë ku u mbledh Kongresi i Manastirit dhe kullën e Faik Konicës. Reciprokisht nënës së rrëfimtari i vijnë nga Parga dy breshka që do ndërprisnin magjinë e vdekjeve, plotësuar me breshkat e sjella nga Sanxhaku, pas të cilit përvijohet harta e trojeve ilirike.

Ka një simbol mbi të cilin endet rrjeta e origjinës së lashtë të një fshati: varret e sjella nga Reka e Epërme, qoftë edhe me një

pjesë të kockave. Ka dhe një kufi kohor të përafërt kur fillon e lëviz gjithçka: atëherë kur katragjyshja Lefkë të premten pastronte xhaminë, të shtunën kishën, pra atëherë kur pati filluar konvertimi vullnetar ose i sponsorizuar.

Magjia, bestytania dhe legjenda vërtiten rreth breshkave dhe zhguajve të tyre. Meqë Ilirida nuk kishte dalje në det, bestytnitë trazuar me shkencë i atribuohen breshkave të tokës: gjaku i breshkës, i përzier me çaj prej gjethe ftoi, shuan mallin dhe qetëson shpirtin; zhgualli i breshkës mbron kullën nga magjithë dhe xhindet; për një javë, shtatë herë në ditë, po thithe ajër nga zhgualli i breshkës me rreth jeshil, shërohet nga astma.

Mjedisi magjik i Sukës vjen si refren me numrin shtatë si pasqyrë e besimit islam. “A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej (në kate).” (Nuh, 15) Mbreti tha: “Kam



parë në ëndërr shtatë lopë të majme dhe shtatë lopë të dobëta... dhe shtatë kallinj të gjelbër e (shtatë) të tjerë të tharë...” (Jusuf, 43) “Ai (xhehenemi) i ka shtatë dyer...” (el Hixhr, 43-44) “Kush i ha shtatë hurme, nuk e godet atë ditë e keqja e as sihri...”

Në inventarin e skenave ku realja shkon në kufijtë e legjendës, vlen të veçohet skena e dasmës së Demës ku kali i nuses kërkon të futet te oborri i kullës së Fatushes, fillimi i këndim-dënesjes së Fatushes dhe hedhja nga çardaku e shamisë së bardhë qëndisur me lule të kuqe dhe e lagur me lotët e saj që mbetet e varur te degët e ftoit, nëna e Demës që shkon e merr dhe futet në valle. Skena tjetër është ajo e varrit të Zenit me shtatë zhguaj të gozhdur me nga një potkua, me nga një pikë të zezë që tregonte në cilën govatë ndodhej gjaku i tyre. Skena e radhës është varrimi i Fatushes në Shkretë të Rekës së Epërme nëpër një shi të rrëpishëm dhe mbledhja e breshkave të gjalla rreth varrit. Skena e fundit lidhet sërish me breshkat, mënyrën e sigurimit të numrit të nevojshëm nga Parga e Çamërisë dhe Pazari i Ri i Sanxhakut ku fiset shqiptare kishin harruar gjuhën e qumështit të nënës.

Ka edhe një veçori markeziante rrëfimi në këtë vepër me rrethanat dhe karakteret që rimerren disa herë duke hedhur dritë mbi hijet e së kaluarës. Është gjyshja me rrëfimin e saj që ngre siparin e veprës, madje i jep edhe emrin e vet kapitullit të parë. Në kapitullin e tretë ajo nuk jeton më, por rrëfimet e saj marrin përmasat e kumtit. Do të rishfaqet në kapitullit e shtatë dhe të fundit, këtë herë në ëndrrat e rrëfimtari me kërkesën domethënëse për t’u rivarrosur në Rekën e Epërme, si pjesë e “një dukurie thuaje çmendurake që përfshiu të gjithë fshatarët” (f.147), “si pre e magjisë kolektive.” (f.148) Ajo do të bëhet pjesë e kujtimeve të rrëfimtari i cili kishte fjetur me të edhe natën e fundit duke frymëmarrë grahmën e fundit të saj si simbol të një lidhjeje që nuk mund të ndërpritet kurrë.

Në se gjyshja vjen në vepër si zëdhënëse e historisë, Fatushja plotëson botën magjike të dashurisë së thellë e të pamposhtur. Vrasja e vëllait Zeni, mbështjellë me enigmë nga aparati shtetëror, e çon atë në një vendimarrje të vështirë: prishjen e fejesës me Demën shumë pak kohë para dasmës. Që pikëllimi i saj të mos mbartet në kullat e tjera ajo kërkon që Samimija, e fejuara e Zenit, të bëhet gruaja e Demës dhe ia del. : “Unë do ta jetoj dhembjen e të gjithëve, e Dema e bija jote le të mbjellin lulishte në mes të asaj dhembjeje!” (f.102)

Por dita e dasmës ishte një dramë për Fatushen që shkon te varrë i të vëllait ku gjen shtatë zhguaj breshkash dhe i godet ato me një purtekë thane nën dhomën e gjerdekut. Fillon që këtu një dashuri sysh prej çardakëve të dy kullave që janë pranë dhe do ta ndërpresë vetëm vdekja e Demës, e pasuar shpejt edhe nga vdekja e Fatushes. Këtë lidhje të jashtëzakonshme autori e sjell në trajtë e një ding-dongu dymbëdhjetëorësh: “betimet që ia kishin dhënë njëri-tjetrit, çastet që mbetën në të

(Vijon në faqen 9)



Këto ditë u botua nga shtëpia botuese “Shkodra” vëllimi poetik “Kujtesa e së djeshmes e nesërmja” me autor Viktor Vokrrin (1965-) nga Lezha. (Redaktorë të librit janë Arben Prendi dhe Hekuran Koka). Fillimet poetike të autorit janë të hershme, diku nga vitet 1988, kur boton poezitë e para në gazetën “Koha jonë” dhe bie në sy për sinqeritetin dhe originalitetin e tij poetik. Në edicionin “Ora e Muzës” 2022, organizuar nga Klubi letrar “Ndoc Gjetja” në Lezhë, autori është vlerësuar me Çmimin “At Gjergj Fishta” për poezinë.

Ky vëllim, pas vëllimeve “Lutja jote”, “S’din me ardhë kurrë e shtuna”, “Sul filo della propria esistenza”, “Similitudine”, “Buzëqeshje varur në degë” të botuara në harkun kohor 1993-2023, është vëllimi i gjashtë me poezi për autorin.

Përmes një gjuhe komunikative në shprehjen gjuhësore aq edhe të mbushur me ndjenja, përjetime e reflektime nga ana përmbajtësore, autori na shpalos botën e tij poetike, që ka dimensionet e botës në të cilën ai jeton dhe përfshihet.

Autori është një vëzhgues i hollë dhe i ndjeshëm i trajtave të së përditshmes dhe poezitë e veta i ndërton nga gjetjet poetike të qëmtuara nga këto vëzhgime. Pra, siç ndodh me poetët, ai e gjen poetiken atje ku të tjerët kalojnë të pavëmendshëm apo nuk janë në gjendje ta vënë re. Ndërkohë, poeti mbetet i përfshirë në nevojën për t’i shprehur gjetjet dhe përjetimet e tij në mënyrë poetike, përmes një fjalori poetik që afron shumë me stilin e të folurit të përditshëm, në formën e bisedës së nënkuptuar me tjetrin dhe me veten. Poeti bashkëbisedon varg pas vargu me lexuesin e nënkuptuar dhe veten, ndaj edhe shumë prej poezive ngjasojnë me biseda poetike për gjëra të rëndomta, por edhe shumë të rëndësishme të ekzistencës. Gjetja poetike e qëmtuar nga dukuritë e rëndomta abstragohet natyrshëm dhe gradualisht në shprehjen e problemeve esenciale, që i japin kuptim ekzistencës së qenies njerëzore, si: dashuria, nostalgjia, malli, dhimbja për humbjen e njerëzve të dashur, brenga për humbjen e identitetit etj.

Temat dhe motivet kryesore të poezisë në vëllimin “Kujtesa e së djeshmes e nesërmja” të Viktor Vokrrit, lidhen me marrëdhënien e poetit me veten, të tjerët dhe atdheun.

Jo rastësisht, një pjesë e mirë e poezive shprehin raportin e tij me: familjen, ku shquhen poezitë për nanën, fëmijët, gruan, nipin etj.; vendlindjen, atdheun, ku shprehet malli, dhe pamundësia për të qenë pranë tij. Familja është mikroambienti i pranishëm, atdheu makroambienti i munguar. Atdheu i munguar fizikisht, zëvendësohet nga ai shpirtëror. Këto raporte ndërthuren dhe janë vijime të njëri-tjetrit, ndërhyjnë dramatikisht tek njëri-tjetri. Bie fjala, nana që pret tek cepi i oborrit është imazhi i vendlindjes, atdheut, është shkaku për t’u kthyer në vendlindje, anasjelltas mungesa e saj e vë në dyshim serioz kthimin në vendlindje. Mungesa e saj nuk e motivon më kthimin në vendlindje, dhe kjo lidhje do të zbehet gradualisht, sepse vendlindja është prania në të e njerëzve të familjes dhe e të njohurve, pra dimension i shpirtëror, mungesa e tyre vë në dyshim raportin e njeriut me vendin fizik.

Në këtë raport shprehet edhe dhimbja e brenga për humbjen e identitetit dhe asimilimit të njeriut në vendin e huaj, veçanërisht të brezit më të ri, i cili do ta ketë atdheun në tokën ku ka lindur dhe jo më atdheun e prindit. Madje ky raport përbën edhe bërthamën konceptuale dhe shqetësimin e krejt vëllimit. Poeti gjendet ndërmjet dy atdheve: atdheut ku ka lindur dhe është rritur deri në moshë madhore, por të cilin e ka lënë si shumë bashkatdhetarë të tjerë në kërkim të një jete më të mirë; dhe vendit të huaj që i bëhet atdhe i dytë. Mirëpo

Viktor Vokrrin, “Kujtesa e së djeshmes e nesërmja” poezi, “Shkodra” 2023

GJETJE POETIKE QË ABSTRAGOHEN NATYRSHËM

Nga Arben Prendi

kjo gjendje krijon traumën shpirtërore e cila “përkthehet” në gjuhë poetike dhe mënyrë për t’u çliruar psikologjikisht prej saj. Në mjaft prej poezive është shprehur drama e të larguarit nga vendi me pengun e fëmijërisë, adoleshencës dhe rinisë së parealizuar në vendlindje, por edhe me obsesionin për ta mbajtur kokën pas nga atdheu i rrënjëve, siç konstatohet në poezitë: “Kartolina me fishekzjarre”, “Në klubin kinez”, “Mbiemri i komshiut”, “Fillon e shkurtohet njeriu”, “Stacion para së dielës”, “Vjeshta skuqi shegët”, “Nipi”, “Zogj në një fletë të bardhë”, “Shtëpi në shitje”, “Vaj në telajo, Pllana”, “Atdheu largohet”, “Qira-jabanxhiu banon në shtëpinë tonë”, “Gjithçka e ka një çmim duhet pagu”, “Kujtesë” etj.

Ky vëllim poetik shënon një arritje artistike për autorin dhe një konfirmim të këmbënguljes për të vijuar me lëvrimin e poezisë edhe në të ardhmen.

MBIEMRI I KOMSHIUT

Mbiemri i komshiut,
emri i një Atdheu të largët shkruar me
makinë shkrimi
fillon me A të madhe shtypi.

Një ditë e gjysëm kohë rrugëtimi Toka,
atje ku e shterr forcën shikimi.

Në tabelë,
dy gozhda ngjyrë ndryshkut,
gozhduar në derë,

nuk dhembim, gjak nuk rrjedhin.

Shqiptar, - mbiemri i komshiut në derë.
Ta kesh të skalitur në ballë njëlloj nuk
është,
as nuk është e lehtë.

DIÇKA E BUKUR PO NDODH

Diçka e bukur po ndodh, teoria e
Bukovskit
në rënie të lirë:

Lëre duhanin, fëmijët e tu këshillojnë.
Kur fjala nuk mbahet,
bërtasin,
shajnë paburrërinë e të atit.

Jetohet me fishekun në trup, plumbi
nxirret pak nga pak,
pa e kafshuar buzën.

Bishtat... gëzhoja beteje,
kambën në ecje kokës së gjarprit,
presioni i lartë,
rreziku i zjarrit.

Shoqëria e një gruaje të bukur,
aroma e këndshme e kafes.
Nga përjashta,
duhet të kthehem pa cigare në gojë, pa u
shtruar darka.

VJESHTA SKUQI SHEGËT

Re të zeza sterr, ngarkuar deng me rrufe,
me kokrra të bardha.

T’i nxjerrësh nga frigoriferi më të ftohta
nuk janë.

Mendja shkon te të korrat, te të mbjellat,
te tjegullat,
tek i mbrojturi pa mburojë.

Zemra m’i thotë atij atje lart: “Mos merr
hak!”.
Janë Zotat në tokë, na nëpërkambin.

Pak më herët se kudo atje lind mëngjesi,
lëre edhe pak pa u falur diellin.

Ulërin zhurma, gjithçka dridhet.
Dyshime plot,
një zemër dhe një mendje.

Stina e verës shkoi,
të vonat në kohë ia arritën.
Vjeshta skuqi shegët,

i shkundi.
Përtokë hodhi,
fruta breshëri të papjekura.

ZOGJ NË NJË FLETË TË BARDHË

Po shtrenjtohen biletat për në Shqipërinë
e shtrenjtë,
për në Atdheun që e duam me fjalë,
- periudha kur nuk preken me dorë...

Me marr rrugë për qejf në ktë vapë, në ktë
siklet,
sakrificat s’kanë t’pagume.

Aeroporti i Milanos, aeroporti i Tiranës,
fluks i madh,
thonë, ata që kanë shku e kanë ardhë,
s’ke ku ve kambën.

Hava me hedh mollën, molla s’e prek
tokën.


Tu pa e tu shpik,
tu pa e tu mendu,
me gjetë një formë tjetër ma t’shpejtë,
edhe ma t’shpejtë se me fluturu.

Zogj në formë aeroplani mbushë me
udhëtarë,
tu ma ba janë me dorë,
në një fletë të bardhë.

VIKTOR VOKRRI

Kujtesa e së djeshmes e nesërmja

Poezi



BOTIMET
SHKODRA



ATDHEU LARGOHET

Atdheu po largohet përditë e sa ka,
dallgët shkojnë,
s'kthehen.

Fronti i Perëndimit me Horizontin e
Lindjes,
dy sekonda larg,
aq sa zgjat
dhënë-marrja e frymës.

S'na ndan më veç deti në mes, bregu
përballë krejt afër.
E gërryejnë,
përmbushin detyrimet që mbetën
përgjysmë, dallgët.

E tmerrshme
kur s'ndihet më zhurma,
që krijonin mallet.

QIRA-JABANXHIU BANON NË SHTËPINË TONË

Në shtëpinë tonë, që braktisëm me kohë,
qira-jabanxhiu mban derën hapur,
mban zjarrin ndezur,
mban ngrohtë lidhjet që u ftohën me Atë
Dheun,
mban shtrënguar me katër duar,
lidhjet që u këputën.

Brezit tim,
gati të gjithëve u ka vdekë Nana,
rolin e Nanës, në shtëpinë tonë, që
braktisëm me kohë,
e luan një Zonjë tjetër.

Mëngjes për mëngjes ajo fshin oborrin,
është ajo që vadit lulet,
pjek bukën.
Në mbrëmje, me sytë nga porta,
pret të kthehen fëmijët e saj.

Në arkën e vjetër të Nanës, teshat e vdekjes
mungojnë,
nuk ruhen ma ëmbëlsira,
as shegë, as mollë.

Qira-jabanxhiu, banon me kohë, në
shtëpinë që braktisëm,
vjel vreshtën që mbollëm, pjek rakinë tonë,
për vete dhe për ne,
nëse llogaria nuk del, i fut bërsive edhe
pak sheqer.

Si ta sjellë rasti, për hall o për qejf, të
paktën një herë në vit,
edhe miku shkon për mik.

Në shtëpinë tonë, braktisur me kohë,
derën, para se ta hapësh, duhet të
trokasësh,
prej larg duhet të thërrasësh: “O i zoti
shpisë!”

Monza, Itali, shtator 2022.

MUNGONTE NJANA

Rrugës për Zejmen, disa gra plaka,
veshun me të zeza,
veshun me të bardha,
në radhë për te Posta.

Nga këtu, prej larg,
duken krejt si vajza.
Tërheqin pensionin.
Mungon njana,
Ndër to duhej të ishte dhe Nana.

GJITHÇKA E KA NJË ÇMIM, DUHET PAGU

«Të pafsha përtej Detit!»
«Të pafsha përtej Detit!»

Përtej Detit lindëm tre fëmijët,
njëri pas tjetrit.

Tani që vendi i huaj po bahet gjithnjë dhe
më i yni,
përtej Detit po na lind edhe nipi,
për cilin nga dy anët e bregut
e pati fjalën mallkimi?!

Gjithçka e ka një çmim.
Çmimi duhet pagu, por ai vendi im,
sa herë që kthehem,
ma kujton qiranë e kohës,
që në të nuk jetova.

MË SHKOI KJO PERIUDHË

Më shkoi kjo periudhë duke i kënduar nipit,
duke i kënduar dimnit,
dhe kopshtit pa ngjyra.

Aty mbretëroi veç një pemë jeshile.

Shegën e zverdhur jashtë në errësirë,
Era e Veriut e rrahu pa mëshirë,
pa ba faje, pa ba hije, për shpendin
mërgimtar
kambëzbathur. Mbi akull
duke menduar:
“Përse më je dhimbsur më shumë kur ke
pasur ftohtë?!”
Për të qeshurën e shegës, e shegës
buzëplasur!

Më shkoi kjo periudhë me zemër të
ngrohtë,
me shtëpinë plot, plot drita,
mes lulesh që mbollëm.

Lule natyrale,
duke i kënduar nipit që po vjen,
duke i kënduar dimnit të dali prej bahçes.

Më shkoi kjo periudhë
pa qenë Mbret,
duke përkëdhelur flokët,
duke fërkuar duart,
duke puthur në faqe.

(Vijon nga faqja 7)

kaluarën, ankthi i pritjes, shpresat që sjell e nesërmja, pakuptimësia e kohës së jetuar larg vetëm duke shikuar njëri-tjetrin nga çardakët e kullave, takimndarjet e shikimit të tyre, kurora e stolisur me lotderdhje, shpresat se një ditë do të jenë përjetësisht së bashku, malli përvëlues që vazhdonte t'i linte të terura buzët e saj, lutjet e saj për lumturinë e tij, ecja drejt fundit, përjetësia së cilës i besonin të dy.” (f.111)

Brenda këtyre viteve gruarimi dhe burrërimi të mundimshëm të Fatushes ka dy dy pika kulmore: kryeplaku Lati, i mbetur vejan, i qepet Fatushes, madje e kërcënon “Ti e di se mund t'ia bëj sherrin edhe ndryshe.” (f.115) Këtë e zgjidh Dema duke u veshur si vajzë dhe duke i lënë takim në Pyllin e Vakëfit ku dhe e vret me sëpatë. Të njëjtën gjë bën vetë Fatushja kur mëtues të shtatit të saj bëhen dy aktivistë komunistë, të cilët i fton të shkojnë jashtë fshatit dhe i vret me revole. Ilustrohet kështu ajo që thotë **Aleksander Smith**: “Rruga e çdo njeriu në jetë shënohet me varret e dëshirave të veta.”

Ngjyrat e rrëfimit të Kim Mehmetit pasurohet me rrafshin politik. Gjyshi merr vendimin e dhimshëm ta largojë nga kulla njërin nga djemtë, Sylën, një ndarje që rimerret disa herë duke sjellë shkaqe të ndryshme: dashuria e tij me një vajzë nga një fshat tjetër që është serbe, por që në origjinë dilte se kishte rrjedhur nga katërgjyshja Lefkë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore gjyshi bëri një lojë të zgjuar me dy porta: Demën e dërgoi në veri të bashkohej me gjermanët, kurse Sylën drejt Gjakovës të bashkohej me partizanët, të dy larg vendlindjes që ta kishin më të lehtë për të fshehur bëmat luftarake. Pastaj konkluzioni i hidhur që del edhe jashtë kufijve të një fshati e krahine: “Sukjanët thuajse gjithmonë kishin luftuar në anën e gabuar dhe ishin vrarë nëpër luftrat e të tjerëve, pa bërë asnjë luftë për vetveten.” (f.53)

Në Jugosllavinë titiste, duke qenë në anën e fitimtarëve, Syla u vendos në Beograd, u bë komunist dhe pozita e tij politike e shpëtoi Demën nga burgu kur i tejkaloi kufijtë angazhimit fetar. Duke qenë bashkëpunëtor i pushtesve gjermanë, edhe pse i ndihmoi hebrejtë në kampet e punës, ai e mbajti të fshehtë këtë copëz të jetës.

Në një rrafsh më të gjerë lufta politike zhvillohet te Varret pa Kufoma: forcat serbe duan t'i fshijnë gjurmët e së kaluarës shqiptare duke i lëruar varret. Një popull pa varre është një bashkësi pa kujtesën e domosdoshme. Siç shkruan **Harriet Beecher Stowe**: “Lotët më të hidhur që derdhen mbi varre janë për fjalët që mbetën pa thënë dhe punët që mbetën pa bërë.”

Në përmasa të mëdha dhe asgjësuese, duke luajtur me besimin, në vitin 1960 politika serbe filloi dëbimin fetar të shqiptarëve në Turqi.

Në rrafshin e ngushtë vetjak, ka dy deklarata të forta politike të rrëfimitarit që mund të jetë dhe autori: e para, më e guximshmja, që rrallë e dëgjon: “Kam qenë një komunist i devotshëm dhe aq besnik sa nuk rreshta së binduri tim atë që të ketë kujdes e të mos e përdorë fenë për të penguar revolucionin socialist.” (f.73) “Më rrëmbeu vala e vrullshme e ideologjisë komuniste.” (f.76) Deklarata e dytë: Ruaj të gjithë librat fetarë të babait, njësoj si kompletet e veprave të Titos, Enverit dhe Leninit.

Ngjyra e katërt e veprës është ajo religjioze e sendërtuar mbi Kuranin dhe mbrojtjen e tij. Ishte një kopje e shkruar me dorë dhe që ishte sjellë nga Reka e Epërme si dëshmi e rrënjëve të vendlindjes. Për ta mbrojtur nga sekustrimi dhe asgjësimi serb në vitin 1958 hoxhë Dema vjen ilegalisht në Shqipëri dhe ia beson at Nikollës në Elbasan, por edhe këtu ishte një variant i pushtetit komunist, i ftohtë ndaj fesë dhe nuk kishte më asnjë siguri. Lufta kundër fesë depërtoi edhe brenda në familje: “Dy brigje të largëta ku qëndronim unë dhe im atë: bregu im ideologjik, ku valëvitej flamuri i burimit të lumturisë njerëzore; i babait ku kishin bujtinë shpresat për shpërblimin që do të merrnin në botën e pasvdekjes.”

Edhe pse romani ka mjaft nota pikëllimi, ai përshkohet nga mesazhe që të bëjnë të ndalosh, të meditosh dhe të reflektosh: “Jemi bërë të pandjeshëm ndaj mjerimit të fqinjit... Kur më flasin për bëmat e të tjerëve në anët tona, i ndjej të largët e të huaj.” (f.54) Dhembja dhe pikëllimi janë njësitë më të sakta matëse për të përcaktuar dimensionin e saktë të aftësisë sonë për të dalë përtej mjegullës së vuajtjeve.

“Ta vlen të mbash gjallë iluzionin se kjo botë një ditë do të ketë shenjë njohëse vetëm mirësinë... duhet mbajtur gjallë besimi se në këtë botë ka një sy që i sheh të gjitha bëmat njerëzore, një vesh që i dëgjon edhe të heshturat e njerëzve,... se është diku një bibliotekë e madhe e padukshme ku ruhen të shënuara të gjitha bëmat e atyre që ishin e nuk janë më.” (f.61)

Dhe ja ku mbërrimë të përmbyllja gogoliane: “Çdo njeri është një guacë e mbyllur, me margaritarin e vockël e të ndritshëm brenda vetes, margaritar i përbërë nga mbeturinat e qindra ëndrrave e dëshirave që i ka shtrydhur dora e pamëshirshme e fatit jetësor, margaritar të ngjeshur nga realja, ajo që kemi përjetuar, por të pjekur në furrën e areales – të asaj që kemi ëndërruar.” (f.161)

Durrës, 9 -10 gusht 2023



Në rrethin e fundit të ferrit nuk është më tradhëtia, por zvjedhokracia e mediokritetit!

“Dimri i librave” është romani i shkruar së fundmi i shkrimtarit. Me një kopertinë të mirë menduar e cila është në funksion të idesë ose ideve, njeriu autor dhe shkrimtar ngjit disa shkallë ku nuk janë as shkallë kalaje, kafeneje, insitucionesh dhe, as ato pak vende historikisht të shenjta të qytetit të tij... Mbi krye i rëndon një strukturë e madhe metalike e cila nis dhe krijon dramën e parë të shkrimtarit me këtë roman. Dhe pse duket një raport ku njeriu është mish dhe gjak dhe struktura çelik, në energjinë që mbart njeriu shkrimtar struktura nuk është asgjë më shumë në çdo perceptim human veçse një pezishkë. Ku mjafton njëra dorë e ngritur dhe e shpërbën atë si një masë fijesh, që i ngjajnë atyre topave të leshit ku dikur me fjetet e tyre mund të arnoje dhe jo të qepje diçka nga e para. Këtë ngjitje do të përdorë gjatë të gjithë strukturës narrative duke zhbërë çdo anti vlerë e cila rreket të institucionalizohet.

Kështu autori njeri ngjit ato shkallë, por pa e ngritur kokën lart në atë “mur” qiellor ku pasi e kalon atë masë hekuri kupton se ka lënë pas një krijesë post mortum moderne, por që zëri nuk iu dëgjua. Duket se kopertina për këdo lexues përmbledh gjithçka të tij si shqetësim sa qytetar dhe akoma më shumë si krijues. Mendojmë se kopertina nuk është as shkaku dhe as pasoja. Ajo është një pjesë e madhe në dukje, por jo fajtorja e vetme në ato përmasa mitike. Sepse fatkeqësisht dhe kjo falë një strukture të mirë menduar romaneske të autorit, një shoqëri ka vite që merret me të duke e etiketuar si mëkat urban. Kur realisht në roman mëkati nis me një të shkuar ku hapësira dhe koha e ngjiznin jetën përmes një iluzioni ideologjik ku krenaria e një ish shteti ushtarak jepte alarme gadishmërie lufte, por në realitet të gjithë e dinin se s’do të kishte asnjë luftë.

Ndërsa për ata, të krekosur me xhaketa ushtarake që pa gradat dukeshin si ish të burgosur gjithçka ishte kthyer në një kënaqësi karriere. Sepse pa luftën jeton, por s’je kurrë hero.

Në veprën “Letërsi e krahasuar” të autorit Yves Chevrel citojmë: Më 1872 Nietzsche shkruante: “...Pa mite çdo kulturë humbet pjellorinë e shëndetshme të energjisë së vet të lindur, vetëm një horizont i përvijuar nga miti mund të sigurojë unitetin e qytetërimit të gjallë, që ai mbyll brenda”¹

Bëjmë ose shtrojmë pyetjen e cila do të na drejtojë në dy rrafshë si ai sinkronik, por më së shumti diakronik. Si duhet kuptuar citimi filozofit? Kjo pyetje ndoshta është jo shqetësimi, dhembja, ironia, sarkazma fshikulluese të cilat në roman janë struktura kuptimore ndaj së cilës autori ndeshet si në një duel. Autori me veprën në vlerë letrare dhe realiteti i një subjekti i cili prek atë më të padukshmen sepse rrin dhe na fshihet të gjithëve friguar si vjedhësi që pret të fajsohet dikush tjetër për aktin e bërë. Ky është morali i personazheve të romanit, ku konkretisht dhe bindshëm është e vërteta e madhe e guxuar që shkrimtari na e rrëfen duke përmbysur disa skema të shfaqjes së një fenomeni ku shumë të tjerë e shmangin duke dashur të shpëtojnë atë që shkruajnë, por që s’mund të jetë kurrë krijimtari e tyre...

¹ Vepra “Letërsi e krahasuar”. Shb Albin. 2002.Tiranë. Autor Yves Chevrel..F.94.

Vështrim strukturalist i romanit të shkrimtarit Bashkim Hoxha ku subjekti i tij shpërbën thershëm “mite” që s’mund të lindin.

ROMANI “DIMRI I LIBRAVE” I SHKRIMTARIT BASHKIM HOXHA

Nga Ilir Paja

Nëse në romane të tjerë lexojmë dedikime si: “Atyre që nuk janë më. Ia dedikoj të dashurve. Për ata që do të vijnë... etj”. Autori e nis me vargjet e Naimit nga poezia e tij atdhetare “Fjalët e qiririt”. Këtu të kuptojmë diçka të vërtetë e cila pranohet nga të gjitha studimet dhe studiuesit. Është poezia me prirje shkëndijimi *gjenialiteti*. Kjo i dedikohet energjisë mitike naimiane: “Natën t’jua bëj ditë”.

Dedikimi shkrimtarit me vargjet e Naimit na shpjegon një diakroni sa të largët, por që në mënyrën më të papapranueshme s’mbërrin sot sepse post mortum mediokritet buron një sinkroni imitimesh, vjedhjesh, rolesh pa vepra, të cilat ata që e krijojnë këtë realitet qoftë “patriotik” që s’mund të mbeten dhe të jenë të tillë. Sepse të bërit letërsi i ngjan ushtarit në luftë i cili vritet duke e përjetësuar sakrificën me heroizmin.

Por ne as nuk jemi vlarë, as kemi shtirë, ndaj s’mund të krijojmë as dhe mite.

Emërtimi i lokalit “Muza e vjetër” me pronar ish një ushtarak (oficer) i quajtur Adnan K i cili s’kishte jetuar asnjë luftë në gjithë karrierën e tij derisa doli në pension²; shpjegon që në nisje se atë që s’mundi t’ia dhurojë lufta, shpreson tani në paqe. Por nëse në luftë të duhet vetëm talent, në paqe të duhet e jashtëzakonshmja. Më pas autori me fjalinë pas kësaj të mësipëme të befason duke shkruar: “Megjithatë, luftën e kishte ndier në formën e vet më të rëndë, si një pritje”³. Të shohim ndryshimin e fjalës pritje pa lidhësen si dhe “zbutjen” e qëllimshme që autori kërkon përmes perceptimit të përdorimit kontekstin e saj më shumë se letrar. Lexuesi dhe ne duhet të mbajmë parasysh në analizën e çdo vepre, se në dallim nga poezia proza është

² Romani “Dimri i librave”. Autor B.Hoxha.Shb Onufrit. Tiranë 2023. F.9.

³ Po aty.



dhe strukturë e kodifikuar ku shkrimtari e ngre dramën dhe konfliktin përmes kontrastit. Çdo fjalë është një “çelës” për të hapur derën e një kuptimi ku të lexuarit nuk është thjeshtë ndjeshmëri estetike. “Të lexosh do të thotë të ribësh së brendshmi udhën e tij”⁴. Kjo na jep mundësinë të shkojmë në kuptimin e vërtetë të tekstit. Ndaj themi se “zbutja” pritjes me lidhësen si ia heq konceptin unik simbolikës së pritjes dhe e metamorfozon si të ishim duke pritur dikë, një pako, letër ose asgjë.


Pyesim përse? Duke qenë se për një shkrimtar jo thjeshtë profesionist, por të sprovuar në një prozë tashmë e vlerësuar si një shkollë e unit të tij prozaik, përkimet me vlera botërore të vijnë natyrshëm. Nuk do të nguronim që gjatë leximit të tij lexuesi të jetë i ulur në një vagon të klasit të parë, ku njëra shinë shtrin kohën dhe motivet e saj pritëse të autorit dhe në tjetrën ndoshta më të skuqur nga rrahja e kohës për vetë kontekstin historik zgjatet historia e romanit të Buzzatit “Shkretëtira e tartarëve”.⁵ Mendojmë se këtu duhet filluar atë që pritjet si motive në përmasa mitike i dhurojnë njeriut iluzionin e të qenit dikush. Dikush i vetvlerësuar duke harruar se pa veprën njerëzore cilido njeri është thjeshtë një hije që zhurmon re.

Mjafton të shohim këto dy përkime ku nëse te romani “Dimri i librave” shkrimtari me një racionalizëm ku shtresimet nëntekstore kërkojnë lexues të afirmuar që e shijon dhe e mendon leximin e veprës, e thotë si të ishte një “epitaf” i paracaktuar. Ndryshe vijon rrugëtimi në ndodhinë e Buzzatit. Por të dy romanet kanë në supë temë të madhe. Ose siç e pranon vetë autori Bashkim Hoxha; “Proza (romani) është artilleri e rëndë”. Është kjo nisje e cila e përgatit lexuesin të bashkëjetojë dhe me idenë e një madhësie filozofike e cila garon me kohën që të mbushë hapësirën dhe autori në mënyrë të natyrshme na dhuron dy motive, që u mbrojt vetë letërsia e shekullit të XX-ë. *Motivi pritjes dhe i vonesës*. Kujtojmë nisjen e romanit të Buzatit “Shkretëtira e tartarëve” ku oficeri i ri Xhovani Drogo i emëruar në fortesën Bastiani do të kalonte të gjithë jetën duke pritur luftën. Betejën e tij. Momentin e tij ndoshta jo njerëzor, por atdhetar në detyrë. Ajo që lexuesi do e ndjejë si deheroizëm në këtë roman nuk ka të bëjë me pamundësinë që nuk iu dha këtij oficeri i cili nuk shtiu dhe një herë të vetme kur ishte në karrierë. Por ka diçka më shqetësuese. Nëse Xhovani Drogo qau, ulëriti, mallkoi kur erdhi armiku, sepse një urdhër nga komanda e lartë e vlerësoi si të pamundur të luftojë nga mplakja dhe pse priti mbi tridhjetë vjet të vinte çasti i tij, personazhi ynë së paku për krenari dhe dinjitet mund të kishte “vlarë” veten. Si

⁴ Vepra “Letërsi e krahasuar”. Shb Albin. 2002.Tiranë. Autor Yves Chevrel..F.36.

⁵ D.Buzzati. “Kryeveprat”. Shb .OMBRA.GVG. Tiranë. 2015.

BASHKIM HOXHA



OnufriRoman

beteja që s’iu dhurua kurrë.

Duke u mbledhur në një lokal (në romanin e shkrimtarit B.Hoxha) ku duket se para tij dhe pas tij mungon një qytetërim si atë si ish oficer dhe të tjerët i mundon diçka me e madhe se heroizmi. Frika dhe mos guximi për të qenë të denjë me ndryshimet e mëdha shoqërore pas viteve 90-të. Ndaj në “fërkimin” e këtij vagoni mbi këto dy shina, skuqja nga rëndesa, por jo shpejtësia e surprizon lexuesin te “Dimri librave” sepse gjithçka duket sikur ecën, por dhe nëse lëviz , punonjësi stacionit thërret të vetmin stacion... “Muza e vjetër”. Nëse lexuesi te Buzzati nis dhe lodhet me pyetjet që personazhi Xh.Drogo ia bën vetes duke kërkuar njëherësh gjithçka sepse tani ka veshur uniformë oficeri, dhe veshja është joshje për të ndërë jetën ndryshe, e kundërta ndodh në romanin e autorit tonë. Ai nuk drejton asnjë pyetje. Kjo duket se buron nga një njohje e thellë psikologjike dhe sociale e shkrimtarit që e tejkalon letrarizmin e një fabule të tillë. Romani nis me një nga të vërtetat e jetës shqiptare e cila zvarritet dhe pse e njeh veten, por tragjikisht kërkon të ç’bëjë atë që shkrimtari e nis ndritshëm me Naimin tonë. Dhe kjo ç’bërje , prishje, është në dukje shëmtia e mediokritetit. I cili nuk bën zë. Madje shkon deri në lypje titujsh, fondesh, çmimesh, por mallkon gjithçka i jepet sepse dhe ata që ia japin të gjitha këto e përbuzin duke i shtrenguar një dorë të squllur nga servilizmi.

Çfarë letërsie krijojmë? Kjo do të jetë motoja që do të përshkojë si nënshtresë kontekstuale romani. Në veprën studimore “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqipe” citojmë: *“Të zgjerojmë kufijtë e brendshëm të letërsisë shqipe, të zbulojmë fenomene që aty kanë qenë dhe janë”*.⁶ Kjo kërkesë na jep mundësinë t’i shpëtojmë imitimeve të plagjiaturave ku atmosfera moderniste do të na dhurohej si gjenialitet. Kur duhet të ndodhë e kundërta. Është brendësia e talentit i cili bën të mundur çdo trillim, ngjarje, personazh, stil të na plotësojë duke zgjeruar së brendshmi atë që dhe sot më shumë është boshllëk...

Në një citim nga vepra “Hyrje në metodikën e punës shkencore letrare kemi: *“...Dhe në vitet që na presin gjithçka është gati përr një inflacion gjigantesk të të shkruarit, pushteti, administrata, univeristetet, ndërmarjet publike dhe private, një mori prodhimesh shkrimesh. Por kjo ndan shkrimtarin dhe qytetarin – redaktor i rastit”*.⁷

Cilët janë këta njerëz që mblidhen çdo ditë në një qoshkë të atij lokali ku emri tij “Muza” duhej të dhuronte personazhe me shpirtra të bukur si nudoje femrash plot hire pa fund? Këtu nis përplasja e madhe mes realitetit dhe një dëshire ku praninë qoftë dhe si reklamë të simbolikës muzë e deformon. Shkrimmtari me ambiguitetin e tij ka një pushtet absolut mbi këtë rreth, klub, shoqatë vjershëtorësh. Sepse ky është romani i së vërtetës ku vepra e autorit ka vendosur “varrosë” këtë lloj realiteti të cilin *ne e mbështesim në fillim nga keqardhja, por shohim më vonë se ky realitet përbuz talentin*. Ai përmes një stili ku ngjarjet rrëfohen si ndodhi dhe nuk ndodhin si të krijuara nga liria e personazheve shpjegon se ata gjallojnë përmes një pritjeje ku të shtënat e rutinës nuk lindin as nga duele të brendshme të



tyre. Ata janë personazhe që mbështeten te njëri-tjetri, por asnjëri prej tyre s’mban dot as veten...

Nëse nga koha e pritjes, deri në një pritje të padurueshme, një patrullë e cila kthehet pas disa ditësh dhe nga lodhja kishte humbur parrullën që duhej t’ia thonte rojeve të fortesës Bastiani në romanin “Shkretëtira e tartarëve”, dhe pas një dyshimi të rojes ai shtin në errësirë , dhe kur gjithçka zgjidhet kishte ndodhur...e jashtëzakonshmja. Plumbi e kishte kapur njërin nga patrulluesit në ballë. Pra, pritja kishte mbërritur në përsosmërinë e vet.⁸

Ndërsa te “Dimri i librave” ku autori simbolikisht në dëshirën e çdo lexuesi stinë e tillë është një “ngrohje” më shumë me letërsinë, duke zgjedhur të vërtetën ai nuk don të *mashtrojë dëshirën tonë njerëzore për t’u dashururar dhe më shumë me leximin. Sepse shkrimtari din një të vërtetë të madhe. Talenti është diçka e rrallë*. Nga vepra “Teoria e veprës letrare. POETIKA” të akademikes Floresha Dado citojmë: *“Një ndër përfaqësuesit kryesorë të “Kritikës së Re” I.A.Riçards duke u marrë me rolin e autorit dhe lexuesit në roman, pohonte se autori që ka rëndësi s’është njeriu, por Ai që shkruan, Uni i dytë në vepër”*.⁹ Ky perceptim na drejton në zgjedhjen e mënyrës së rrëfimit që ka zgjedhur autori. Ai din më shumë se të gjithë personazhet. Sepse siç citohet po nga kjo vepër ¹⁰ rrëfimtari autor jo vetëm i njeh, i sheh, “takohet” me të gjithë ata si të ishte një ndjekje hap pas hapi, por nga vetë teksti studimor kemi: *“...Autori di shumë për të kaluarën e tyre...”*¹¹ Ky detaj nga teksti studimor i cili shpjegon teorikisht këtë raport në diskursin duke mos e shmangur përballjen , ndoshta jo me një të shtënjë si tek Buzzati. Por përmes një *ndëshkimi, dënimi, harrimi* të merituar nga autori.

Romani nuk ka dialog. Është shkrimtari që rrëfen ndodhitë e një grupi njerëzish ku duket sikur fshinë me furçe xhaketen e ish ushtarakut me mendimin se atë që s’ia dhuroi të gjakosej nga ndonjë betejë ish sistemi, do ia lejonte liria jo e fjalës, por

e letërsisë. Në rrëfimin e drejtëpëdrejtë ku secili personazh bashkejeton dy kohë, secili prej tyre e ka gati të pamundur të kuptojë jo kohën, por se çfarë kohe ishte jeta dhe është tani. Gjithçka që mendojmë se këta personazhe të cilët asnjëri nuk dallon nga tjetri dhe kjo zbulohet nga sjellja e tyre pa konflikte e shpjegon qartë se ata janë të “sëmurë”. Ushqejnë iluzionin se duke shkruar vargje për të cilat duhet thënë se janë formma e vetme e “dialogut” mes tyre, ngrefosen me tema të mëdha filozofike duke shtryllur nga rëndomësia e një kotësie perverse figura, rima dhe metafora të cilat në sytë e lexuesit do të madhështoheshin sikur Prometeu është në duel për jetë a vdekje me Sizifin.

Po. Diçka e tillë dhe mund të ndodhë, por pas zënkës së njërit prej personazheve i quajtur Sokrati dikur aktor që në debat me regjisorin e huaj revoltohej sesi mund të mbivendosësh në një vepër të Çehovit tituj dhe deklarata gazetash. Është detaj që të dhuron dhembjen më të thellë si përjetim skenik. Sepse nëse letërsia shqipe do të na mrekullonte *sof* me një përshkrim të afërt si të “Kopështit të qershiave” atëherë dhe drama jonë do e kishte Çehovin e saj. Mendojmë duke iu referuar rrëfimit të ndodhive në roman se huazimet tona kulturore janë mllaçitjet nga gojë e të huajve pasi atyre vetë u kanë rënë dhëmbët, dhe me ne flasin përmes protezave.

Gjatë ndjesive të një leximi ku ti lexues nis dhe përvijon rrugëtimin rrëfimtar të autorit të nis dhe të ngrihet fryma e një revolte duke kërkuar drejtësi dhe pse letrare. Ky grup, klub, kthinë, qoshkë që surb kafe brenda një arkitekture që nuk del jashtë as një tryeze kafeneje nuk citon në asnjë ndodhi të tyre një poet, një strofë. Nuk thonë asnjë vlerësim, asnjë ndjesi, madje as nuk recitojnë që të ndjejnë duartrokite. Ata janë pa kulturë. Ata nuk janë as të lexuar. Madje ata shkojnë deri aty sa nuk shqiptojnë kurrë fjalën poezi, metaforë, talent, çmime, botime, revista, konkurse etj. Autori me shmangien e këtyre fjalëve që i përkasin analizës strukturakliste përkon në afëri me vepra të kodifikuara si te Kafka. Te romani “Procesi” fjala *proces* përdoret 168 herë, në romanin e Buzzatit fjala *fortesë përdoret 837 herë, fjala absurd përdoret*

gjithsej 17 herë dhe çfarë “rastësie”! Fjala mediokër si tek Buzzati dhe B.Hoxha përdoret vetëm 1 herë.. Mendojmë se përdorimi i kësaj fjale një herë të vetme është jo thjeshtë mjet identifikimi siç ka emrin njeriu në kartë identiteti. Është fjala që i identifikon të gjithë personazhet pothuaj njëherësh. Ashtu si tek realiteti i fortesës Bastiani ku pritja merr fatin tragjik që krijon jo thjeshtë pritja e luftës, por mënyra e pritjes. Është fjala kyçe në roman e cila është ndëshkimi më i dhur për kategori të tillë shtresash shoqërore. Por atë që e përmbajnë qenie të tilla është dhjetëfish, njëqindfish më shumë. Sepse mediokriteti është realiteti më neveritës, më mashtrues dhe më i pa dinjitet. Ai nuk të dhuron asnjë kënaqësi, por vetëm urren me një përkorje servilizmi. Ndaj shkrimtari na e lë këtë përjetim neverie të nënkuptuar si reflektim duke vënë drejtësi ndëshkimi pa kthim.

Romani ka disa vjersha. Të cilat siç thamë më sipër luajnë funksionin e “dialogut”. Ato shpjegojnë të gjithë karakterin e tyre sa çoroditës dhe humbës përballë një bote tjetër letrare e cila ndriti me Naimin, mban në dorë pishtarin e talentit, pishtar që duhet t’i vënë flakën asaj mase me libra që siç thotë dhe U.Eko: *“Turrat e druve për të djegur njerëz nuk e ndriçojnë terrin”*.¹² Është kjo masë me libra që na dhurohet jo e krijuar nga njerëz, por hijet e tyre që mbajnë gjallë mes nesh vdekjen e tyre. e cila nuk është as heroike as dhe nga dashuritë. Po citojmë dy vargje në kapitullin me titull “Adnani”¹³ Vargjet : *“Një grusht dheu e shtrylla në duar / sikur kapa për fyti atdheun m’u duk”*.¹⁴ Duke mos dashur të bëjmë analizën kontekstuale as të temës, motivit dhe *mesazhit* po mjaftohemi duke e përmbledhur se atdheu është si ai njeriu i pambrojtur me të cilin mund të bësh ç’të duash. Ndaj themi se atdhuen e ndosin dhe vdekjet mediokre...

Duhet kuptuar se në roman takohemi më së shumti me gjendjen e një dhembjeje brenda procesit krijues të autorit sepse kuptojmë, se me këtë roman shkrimtari Bashkim Hoxha përvijon ngjitjet e tij romaneske duke dhuruar me këtë vepër *befasi në tematikë dhe në strukturë narrative. E cila i jep të drejtë autorit të prekë plot guxim masivitetin e një realiteti që kërkon jo thjeshtë të institucionalizohet si bashkejetëse. Por që kërkon më shumë. Të pranohet si e drejtë vlerësuese. Dhe cili? Mediokriteti*. Por letërsia s’mund të lejojë mëkate të tilla ndaj vetes.Ndaj kemi një “përballje” të një romani me kurajo krijuese, me shpërthimin për të treguar atë të vërtetë që shumë krijimtari tjetër e “shmang” qëllimshëm sepse vetë të tilla krijimtari nuk janë art. Ndaj autori është si artistkisht, njerëzisht dhe moralisht në një duel të cilin me romanin e tij e akuzon këtë “rreth” si të padukshmëm ferri duke mos i dhënë asnjë mundësi mbrojtjeje!

Në roman citohet dhe “Bibla”. Do thonim pa asnjë ndrojtje se vetë ky tekst s’do e pranonte qoftë dhe një paragraf si lutje nga mediokriteti. Nëse mediokriteti është një formë tiranie deri mediatike, talenti para tij është si fëmijë jetim. Por ajo që mbetet profeci është se veprat e mëdha burojnë nga dhembje ku jeta rilind disa herë. Ndaj themi se shkrimtari është ai ushtari që vdes në front dhe në kthim si ringjallje mbërrin letërsia e tij.

⁶ Vepra “Fenomeni avangardës në letërsinë shqipe”. Shb Arbëria.Tiranë 2004.Dr.K.Jorgo.F29.

⁷ Vepra “Hyrje në metodikën shkencore”, Autor. Prof.Dr. Gj.Shkurtaj, Nj.Kazazi.Y.Çiraku. Shblu.Tiranë 2004.F.15.

⁸ D.Buzzati. “Kryeveprat”.Shb .OMBRA.GVG. Tiranë. 2015. F.340.

⁹ “Teoria e veprës letrare. POETIKA”. F.Dado. Shb Toena. Tiranë 2006. F.83.

¹⁰ Po aty. F.242.

¹¹ Po aty. F.242.

¹² Për letërsinë. U.Eko. Shb Dituria. Tiranë 2007. F.72.

¹³ Romani “Dimri I librave”. Shb Onufri. Tiranë 2023.F.59.

¹⁴ Po aty.

1.

Ne, lexuesit dhe dashamirësit e poezisë në Kosovë, Frederik Rreshpjen e njohëm që në vitet '70 nëpërmjet librit "Enise, enise", botuar nga "Rilindja" (1975). Për mua, e besoj edhe për shumicën e lexuesve atëherë, ky ishte takimi i parë me krijimtarinë e tij poetike, e cila zgjoi kërsherinë për njohjen edhe të vetë atij si poet, meqë ai, me këtë libër na erdhi gati me po atë bukurinë, por edhe me misticizmin që e karakterizonte edhe Lasgushin me krijimtarinë e tij. Poezia e tij të linte mbresa dhe ta zgjonte kureshtjen për të ditur më shumë edhe për krijuesin e saj.

Pata fatin që këtë poet ta takoj vetëm një herë. Ishte rasti kur bashkë me Odhise Grillon hymë në oborrin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, përkatësisht në oborrin-bufe të saj, ku në një tavolinë po rrinte vetëm Frederik Rreshpja. Odhiseu, pasi foli vetë, më njoftoj edhe mua me të. Pashë atë qëndrimin njerëzor, mirësjelljen me buzëqeshje e me shumë pak fjalë. Në kokë kishte atë republikën e tij, veshur sakon e madhe që ia mbështillte trupin hallig, kravatën që i mbrrinte shumë nën rrypin e pantalloneve. Derisa po e shikoja gjatë atij takimi të shkurtër, në mendje më sillej libri i tij që e përmenda e të cilin e kisha lexuar qysh kur kishte dalë në Prishtinë, mbresa që kisha nga leximi i tij, por edhe nga ndonjë fjalë e mirë e thënë apo edhe e shkruar nga ndonjë poet, kritik apo studiues i poezisë. Mbase më shumë më vinte në kujtesë poezia e tij për nënën, të cilën e kisha më të freskët, meqë ishte përfshirë në leximin letrar të klasës 7 të shkollës fillore, e cila të pushtone me bukurinë e shprehjes poetike.

Atë takim, ndonëse shumë të shkurtër, e përjetova si një ngjarje të veçantë që ma pasuroi jetën. Isha i lumtur që e takova poetin nga poezia e të cilit kisha shumë mbresa, pak dije për të e shumë kureshtje.

2.

Edhe pse shumë i mirëpritur dhe i vlerësuar nga dashamirësit e poezisë, për Frederik Rreshpjen u shkrua pak në kohën sa ishte gjallë. Për të u fol dhe u shkrua shumë më shumë pas shkuarjes në amshim. Për fatin dhe krijimtarinë e tij shkroi edhe Kadare, duke theksuar se "koha ka qenë jo e mëshirshme me Frederik Rreshpjen", dhe duke pyetur: "Përse ishte rrëzuar nga fati pikërisht atëherë kur dukej se fati po i buzëqeshte? Si dhe kur u vendos ky rrëzim? Dhe kryesorja: në kohën e madhe të botës si nuk ishte gjetur një kohë për të, krijuesin e kaq brilanteve e midis tyre, ndoshta më befasesit varg të poezisë pesëqindvjeçare shqipe: Tërë vdekje u rrëzua në fushën me shi.¹ Për veprën, por edhe për jetën e Frederik Rreshpjes shkruan edhe shumë autorë të tjerë. Mirëpo nga gjithë këto shkrime më impresionuan dhe më gëzuan sidomos shkrimet e dy shkrimtarëve tanë të mrekullueshëm, njerëz e intelektualë shumë të mirë dhe dashamirës të vërtetë të artit letrar:

Petrit Palushi përjetësoi në rrëfimin e tij të singertë, në një libër të tërë, takimin që i ndodhi rastësisht me Rreshpjen në Kukës ndërsa po kthehej nga Prishtina, ku edhe e ndali një natë. Në këtë libër të titulluar "Frederik Rreshpja që s'e kuptuam kurrë" (OMBRA GVG, 2016) ai shpreh gëzimin për këtë takim dhe nëpërmjet bisedës së gjatë me poetin e adhuroar shpalos shumë gjëra që kishin jetuar në të dhe jo vetëm në të si mbresë e kureshtje.

Shkrimi tjetër që më la mbresa dhe më gëzoi shumë ishte ai i Xhahid Bushatit "Fredin – koha e poetit", në të cilin ai paraqet disa këndvështrime dhe kujtime për Fredin dhe poezinë e tij, për poetin poezia e të cilit e kishte fascinuar që në fillimet e tij krijuese dhe me të cilin kishte pasur fatin të njihet që herët si bashkëqytetar.

3.

Libri i Xhahid Bushatit për Fredin është shkruar me dashuri dhe vjen si një borxh i tij,

1 Kadare, Mëngjeset në Kafe Rostand, Një prill për Fredin, f. 89-110, Onufri, Tiranë, 2014.

Xhahid Bushati, Fredi KOHA E POETIT, Fiorentina, Shkodër 2022

FREDI, FATI DHE ARTI I TIJ LETRAR

Nga Xhevat Syla


Frederik Rreshpja (1941-2005) është lirik i veçantë, i cili me krijimtarinë e tij poetike ka bërë për vete lexuesin e mirëfilltë të poezisë, por edhe ka provokuar mendimin kritik e studimor për të. Përvçse me poezinë, ai binte në sy edhe me qëndrimet dhe sjelljet e veta në një sistem në të cilin nuk ishte e lehtë jeta dhe krijimtaria. Megjithëkëtë ai ngeli përherë në qëndrimet dhe në botëkuptimet e veta për jetën dhe për artin letrar edhe atëherë kur ato i kushtonin me ndëshkime të rënda, absurde.

i cili do të jetë rritur bashkë me vitet që bënte. Në raste të këtilla autori e ka të vështirë ta përzgjedhë e ta strukturojë gjithë atë bagazh kujtimesh, mbresash e dashurie të cilat dëshiron t'ia shpalosë lexuesit. Mirëpo Xhahid Bushati, me përvojën e tij të gjatë si shkrimtar jo vetëm në krijimtarinë e suksesshme letrare për fëmijë, por edhe me disa lirika për të rritur, e veçmas si autor i shkrimeve të shumta për vlerat e qytetit të tij, për traditën letrare, por edhe për traditën dhe begatinë edhe në fusha të tjera të artit dhe të dijes, arrin t'i artikulojë në një libër të gjitha kujtimet për poetin e tij të dashur dhe të veçantë jo vetëm në hierarkinë e krijuesve shkodranë, por edhe në shkallë kombëtare dhe më gjerë. Por si të marrë fill rrëfimi i shtresuar për shumë vite i Xhahidit për Fredin?

Para thirrjes së kujtimeve, që në fillim të librit, ai jep poezinë fort të bukur të Rreshpjes kushtuar qytetit të tij, Shkodrës, të titulluar "Në këtë qytet", e cila është edhe vendlindje dhe qytet i jetës edhe i vetë Xhahidit. Pse bën këtë? Para së gjithash nga shkaku se kjo del mbështetje, pikënisje e pikënxitje me e mirë për shpalimin e bagazhit të kujtimeve të tij për poetin e dashur, për vlerat e tij poetike, të cilat në këtë poezi dalin aq bukur, të dalluara për origjinalitet dhe bukurë në gjithë poezinë

tonë moderne. Xhahid Bushati e hap librin me këtë poezi për shkak se ndien dhe përjeton fuqishëm çdo varg, çdo imazh, ku ai pasqyron historinë, shpirtin dhe gjithë qenësinë e këtij vendi, edhe pse poeti poezinë e përfundon me vargjet: "Figura jote lëviz si një portret që s'e kapin dot penelat / Dhe para meje telajua e poemës mbetet e bardhë", që nëkupton se pas gjithë asaj paraqitjeje të fuqishme ndjenjash e imazhesh, poeti do të ndiejë se ka arritur të thotë shumë pak nga ajo që ndien e dëshiron të thotë dhe kjo vjen si kulm i përjetimit, por edhe si një përfundim brilant i krijimit poetik.

Për vënien e kësaj poezie që në fillim të shkrimit të tij për Rreshpjen, Xhahid Bushatin e nxisin kujtimet edhe për qytetin, edhe për personazhin interesant të shkrimit të tij, të cilat ai i fton në ndihmë si një thesar të çmueshëm, por të fjetur për shumë vite në mendjen e tij. "Kujtimet më kthyen më shumë se gjysmë shekulli më parë", shkruan Xhahid Bushati në fillim të shpalimit të tyre dhe shton: "Ato kishin jetuar në "kohën e poetit". "Teksa më thirrnin, kuptova se ngjanin si shkrepte filmike të një viti, të një dekade, të një kohe, që dikur kishin ndriçuar plotësisht. Tani, me kalimin e viteve, ngjarjeve e historive më dukej se numri i atyre shkrepeve filmike, sikur ishte zvogëluar dhe mund t'i numroje pa vështirësi, fare lehtë.



Edhe pse të paktë në numër, në atë arkivë jetonte KOHA E POETIT", shkruan poeti e studiuesi Xhahid Bushati.

4.

Që në fillim të librit lexuesin sikur e rrëmbejnë fjalët që autori i thotë për vetveten si krijues i ri në një ambient me traditë të gjatë dhe të begatshme krijuese, i cili është edhe ambient në të cilin lindi dhe bëri pjesën më të madhe të të jetës edhe personazhi për të cilin shkruan. Dhe, cili na qenka ai që ia mësyen të shkruaj për poetin e tij të dashur, të veçantë në gjithë poezinë shqipe dhe çfarë do ta ketë nxitur të bëjë këtë? Ai është shkrimtari shkodran, Xhahid Bushati, i cili që në moshën 13 vjeçare, pas një goditjeje të rëndë që përjeton me humbjen e vëllait më të madh dhe babait brenda një viti (1966), u jepet leximeve, librave, duke "biseduar me mençurinë e tyre" dhe nis të shkruajë vjersha për fëmijë "sipas mendjes (së tij) 13 vjeçare". Me fare pak të dhëna për vetvetën, autori i këtij libri jep afrinë që ka me jetën e persoanzhit për të cilin shkruan. I mbetur jetim, ai gëzon ndihmën dhe kujdesin e pakursyer të nënës e cila do të kontribuojë që ai dhe të tjerët në shtëpi, shkruan, "ta mbanim trupin drejt e vështirimin larg". Ndaj gjithë këtë kohë, këtë moshë të nënës së tij ai e quan "mosplakje nënës", sado që çdo ditë e tij, në pjesën e saj dërrmuese, "ishte e trishtuar, me yje lotësh e hënë pikëllimesh, pse jo edhe me buzëqeshje ëndrrash..." Në këtë përshkrim të gjendjes së tij ekzistenciale dhe emocionale ai përmend edhe një përkujdesje të mësuesit të tij për të, i cili, fshehtazi tij, ua tërheq vërjetjen nxënësve, shokëve të tij, ta kenë kujdes për shkak të situatës shumë të rëndë që i kishte ndodhur në familje. Duke i dhënë këto detaje, vazhdon: "vetmia nga një shok i përditshëm, më bëhej më e largët, më e huaj". Dhe, me kohë, atë do ta bëjnë për vete gjithnjë e më shumë librat dhe krijimtaria. Bisedat me librat i bëhen gjithnjë e më të shpeshta në bibliotekën e tij, e cila ruan librat e gjyshit, të babait e të vëllait, ndaj aty ai sikur shuan mallin për ta, i cili, siç e thekson, po i shdërrohej në faqe libri. Ndërkaq hyrja aty i bëhet ritual i përditshëm, i cili i vazhdon edhe sot. Nga ky ritual bisedimesh me librat dhe i përkushtimit krijimtarisë letrare, ai nis të botojë vjersha në revistat "Fatosi" dhe "Pionieri", ku gjen përkrahjen dhe ngrohtësinë e shkrimtarëve Adelina R. Mamaqi dhe Xhevat Beqaraj si redaktorë të tyre.

Me këtë të dhënë për fillimet e tij letrare, ai shpjegon hyrjen e tij në mjediset letrare të qytetit, në të cilat, siç shkruan, "përmendej si gur i çmuar poetik Frederik Rreshpja, për poezinë tij të veçantë jo edhe aq të pranueshme, siç do ta tregojë më vonë koha". Por që në fillim autori i librit konstaton se "Fred Rreshpja po krijonte kohën e vet... kohë që, "sikur nuk kuptohej ose kuptohej, por nuk i jepnin zë."

5.

Është mbresëlënëse takimi i parë i autorit Bushati me Fredin, i cili i ndodh në moshën e tij të hershme, si 15 vjeçar, dhe ngel një shoqërim i përhershëm. Në shtëpinë e Fredit autori Bushati gjen një ambient të rëndomë, ku ai bën jetë të rëndomtë. Nuk gjen studio të punës siç do të ketë mundur të ëndërronte dhe idealizonte djaloshi krijues, por siç e kujton me dashuri e ngazëllim zbulesën: "përballë kisha një libër të vlefshëm plot dije". Ai libër është poeti Frederik Rreshpja, i cili në kujtesën e Bushatit thotë: "Kudo shkruaj.

Edhe te kjo tavolinë e vjetër, edhe tek ai raft i vogël ngjyrë arre, në shtrat...” Nga kujtesa e djaloshit shpalosen edhe fjalë të tjera të poetit nëpërmjet të cilave shpërfaqet shpirti i tij, mënyra e punës krijuese, koha më e përshtatshme për të. *“Vërtet më pëlqen të shkruaj kudo e kurdo, por nata është perandoria ime”...* *“Qetësinë që më fal ajo, nuk ma fal askush... Nata dhe Nëna ma falin paqen që më mungon. Unë e dua vetminë, o miku im! Ajo më fal siguri, frymëzim...”* Këto janë fjalët që autori Bushati ndien sikur t’ia ketë shqiptuar Fredi që në fillimin e shoqërimit me të, të njohjes më të përfarët të atij që mahnitte jo vetëm për shprehjen e veçantë poetike, por edhe për sjelljen e veçantë, për kuptimin më të veçantë të jetës dhe të realitetit që e jetonte. Ndër të tjera, Fredi, në një intervistë të cilën e citon autori Bushati, për kohën të cilën e jeton, shkruan: *“ E para herë në histori që një popull pret të bëhet i lumtur, pa të shkruaj libra. Gjithmonë librat janë shkruar për t’i prirë lumturisë.”* E thotë këtë duke e vlerësuar kohën e vet *“një lloj mesjete që do të na kushtojë shumë”,* por duke përmendur edhe shekujt në të cilët *“na kanë munguar shumë gjëra, por kemi patur Bogdanin, Seremben, Mjedën dhe dhjetëra të tjerë”.* Duke theksuar se krijimtaria e Fredit u përcoll edhe me shkrime të përcipta, të pathelluara e me hamendësime të paqena, Bushati përfundon: *“Është detyrë, kulturë dhe borxh të vazhdojmë thellimin për të nxjerrë në dritë vlerat e njëmendta të kësaj poezie.”*

6.

Libri i Xhahid Bushatit për Fredin mbështet në kujtimet e ngulitura në mendjen dhe në shpirtin e tij nga shoqërimi me të, nga kënaqësia dhe privilegji që pati ta njohë atë nga afër, t’ia njohë jetën, botëkuptimet, sjelljet, dashuritë e dhimbjet. Shpërfaq dehjen me artin e tij letrar, të cilin do ta përfutojë në një mënyrë të veçantë, madje edhe si një ndjenjë të veten por të shqiptuar aq bukur nga ai. Bushati e ndjen si një rastësi fatlume apo si një dhurtaë nga hyji se është i një qyteti dhe i një rrugice me Fredin, i asaj rrugice *“ku personalitete të fuqishme jetuan e lanë gjurmë të thella”,* i asaj rrugice-muze e cila *“ka fiksuar në kujtesë ecjen e shpejtë e pa zhurmë të Fredit”,* rrugice e cila bashkë me fëmijërinë e Fredit brenda mureve të gurtas *“do të linin gjurmë të pashlyeshme në kujtesën dhe shpirtin e tij, të cilat do të përbënin pastaj kodet e poezisë së Fredit”,* shprehet Bushati.

Poezia e Rreshpjes, para së gjithash, është e lidhur me jetën e tij, si *“një simbiozë e çuditshme por e vërtetë”.* Jetën e Rreshpjes do ta njohë mirë krijuesi i ri, i cili pati fatin edhe të shoqërohet me të, edhe ta kundrojë atë me kureshtjen e krijuesit dhe studiuesit. Për këtë Xhahid Bushati shkruan: *“Ato vite me Fredin jetojnë brenda meje. Janë vite kur unë jam ulur te ajo sofa e drunjtë dhe kam ngrënë bukë nga duart e nën Drandes”,* e cila është nëna Fredit. Tek ajo, shton Bushati, ishte qëndisur çdo gjë fisnike. Ajo zotëronte artin e të qepurit të rrobave kombëtare, art ky të clin ia kishte trashëguar edhe birit të saj poet.

Kujtimet, vlerësimet dhe interpretime për artin poetik të Fredit, Bushatit jo rrallë i vijnë si refleksione nga leximi dhe rileximi i vargjeve të tij, sidomos i atyre vargjeve emblematike që i vijnë në kujtesë dhe mund t’i thotë përmendsh apo, në raste valësh malli, edhe t’i shqiptojë më vete, si *“Kurt të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det / Për varkat e lotëve / ... Unë kam qenë trishtimi i botës”* e të ngjashme.

Bushati mban mend mirë, që nga mosha e tij e hershme, edhe si janë pranuar vargjet e Frederik Rreshpjes nga lexuesit dhe nga ata që merreshin me publikimin e tyre. Nga këta të dytët pati edhe kritika, diku më të lehta e diku më të ashpra, të cilat *“nisën që me librin e parë “Rapsodi shqiptare”, që e bafasoi pozinë shqipe.”* Madje, Bushati kishte pasur rastin t’i shohë edhe recensionet për një dorëshkrim me poezi të Fredit, të cilat e kishin habitur dhe në të cilat kishte parë shumë *“frikë nga ata të cilët kishin marrë librin për të dhënë mendimin.”* Por Fredi ishte stoik në artin e tij letrar, nuk bënte kompromise sado që kishte ndodhur edhe t’i hiqeshin poezi nga përmbledhjet, e pas dënimeve me burg edhe t’i ndalohej botimi dhe qarkullimi i lirë i librave, apo t’i ndalohej

edhe shfaqja e dramës së tij “Ëndrra e Tokës” e tj.

E gjithë krijimtaria letrare e Frederik Rreshpjes ishte nën llupën e kritikës letrare të realizmit socialist, ndaj jo vetëm për poezinë, por edhe për përrallat e Fredit pati vërejtje nga “kujdestarët” e zbatimin të normave të kësaj metode. Pasi jep disa shembuj të kritikave e vërejtjeve të këtilla të autorëve të ndryshëm për përrallat e Frederik Rreshpjes, Xhahid Bushati shkruan: *“Injohur me përrallat e Fredit, lexuar e rilexuar, studiuar e ristudiuar, mund të them pa hezitim se, në themel të arkitekturës përrallore qëndron poetika e tij.”* I njohur po ashtu me gjithçka ishte thënë e shkruar për përrallat e Fredit, Xhahid Bushati veçon mendimin e Moikom Zeqos, shkrimtarit erudit dhe mikut të ngushtë të Fredit: *“Ai që zbërtheu kodet e vërteta të përrallave të Fredit, ishte poeti Moikom Zeqo... Askush më mirë nuk i studioi përrallat e Fredit”* Dhe e ilustron këtë edhe me një konstatim të Moikomtit: *“Çdo shkrimtar i mirëfilltë, është përralltar. Shkrimtari i vërtetë është veteviti përralltar i madh”.*

7.

Syrit të mikut të Fredit, Bushatit, nuk i ka shpëtuar i pavërejtur edhe sistemi i tij punës, puna me vargjet, me figurat, me ndërtimin e imazheve fantastike. *“Kam patur fatin të shoh edhe fletët e bardha të shkruara me stilograf, me një shkrim jo të rregullt që dukej sikur mbarnte trishtimin apo vuajtjen e tij. Nuk e harroj edhe zamin (ngjitësin) me furçë në atë shishen e vogël me të cilën bënte korrigjimet dhe vendoste herë pas here shirita letrash të shkruara. Kjo tregonte për natyrën e tij krijuese, procesin në laboratorin krijues, të cilit shkrimtari i kthehej dhe i rikthehej shumë herë në kërkim të përsosmërisë.”* Duke bërë fjalë për natyrën krijuese të Fredit, Bushati shton edhe: *“Në poezinë e tij çdo fjalë është e shenjtë, se di t’i shenjtërojë fjalët!”*

Për shkrimin e librit për Fredin, Xhahid Bushati ka vjelë dhe ka prezantuar edhe vlerësimet e më shumë shkrimtarëve dhe të studiuesve të veprës së tij, të cilat i përfshin në kontekste të caktuara të çështjeve të cilat i trajton, përkatësisht në pjesët apo kaptinat të cilat e përbëjnë këtë vepër të shkruar me dashuri. Do të gjejmë këtu si një begati të veçantë edhe mendime për Fredin dhe poezinë e tij të autorëve, si Kadare, Moikom Zeqo, Hans Joachim Lanksch, Astrit Bishqemi, Petrit Palushi, Hasan Hasani, Tonin Kaçaj, Sadetin Mezuraj, Dashnor Kaloçi, Përparim Hysi, Gazmend Krasniqi, Isak Eshrefi, Arben Bllaci, Shpëtim Kelmendi, Nikollaq Xhaxhari, Bedri Islami, si dhe mahnitjen e autorit me këndvështrimet interesante të profesor doktor Përparim Kabos e të tjerëve.

8.

Libri i Xhahid Bushatit për Fredin, i ëndërruar dhe i realizuar me dashuri, me siguri do ta ketë liru autorin nga një barrë që do ta ketë bartur gjatë, por njëherësh ai i ka gëzuar edhe dashamirësit e letërsisë. Një çlirim i autorit vërehet edhe në tekstin përmbyllës të librit, në të cilin shkruan: *“Në çdo poezi që e lexova disa herë, që më sillnin kujtime pafund, më ngjan sikur Fredin e shoh, sikur Fredi më vjen... herë si një melodi tingujsh, herë si metaforë vetmitare, herë si një pëlhurë Penelope, herë si në tempull lutjeje, me paqen që njomet me shi. Po, po, i bëhet se i vjen poeti i shquar, liriku i paarrirë Frederik Rreshpja në shumë aspekte të tipologjisë jetësore e artistike, që në rrugëtimin e tij e përfaqëson VETMINË, të cilën e dashuroi edhe kur foli, edhe kur heshti, përfundon Bushati.*

Xhahid Bushati ka shkruar edhe për figura të tjera të shquara të letërsisë dhe të fushave të tjera të artit të trevës së vet dhe më gjerë, siç është shkrimi për Bepin e për shumë të tjerë, mirëpo shkrimi për Fredin, në një libër të veçantë kujtimesh e këndvështrimesh kritike, na vjen si një nga portretizimet më të bukura, i cili do të lexohet me ëndje ashtu siç lexohet edhe vetë poezia e Fredit. Kjo paraqitje e gjallë e kësaj figure të veçantë në poezinë tonë plotëson kureshtjen e lexuesve të shumtë për të mësuar më shumë për jetën, fatin e Fredit dhe për veprën e tij letrare.



MUNGESË

Poezi nga Jonida Hitoveizi

MË GËNJEJNË DHE UNË DUHET TË JEM GËNYESHTËR (BORGES)

Janë zinxhirë,
zinxhirë që ruajnë gjithë ndryshkun e krijimit
oksidimin e prej kur koha nisi,
Zinxhirë mbi rrëzë të të gjitha gjurmëve, dëshmi prej udhëtimit tonë
Zinxhirë me të cilët tentojmë të mbërthejmë vetveten parreshtur,
të kemi një hije bashkëudhëtare në karvanin tonë të mundimshëm
Nuk do ta mësoj kurrë prej ç’kohe vij
ç’krijesë mutante, ç’yll është shuar në mua?
Pesha e zinxhirëve që s’i shoh kurrë, përsërit vetveten,
si një vegim prej të cilit nuk e shpëton dot kurrë ëndrrën tënde
Nata e padijes bëhet shtjellë yjore,
aty ku të vërtetën askush nuk e nxjerr dot
Askush nuk e gënjen dot një gënjeshtër
Krishti ishte rruga ku të gjithë kryqëzuam vetveten
Do të na vrasë e paditura mik, zinxhirët e kohës do të na vrasin
Si të gjitha gjurmët para nesh!

NJË VJESHTË

Një vjeshtë e beftë do të na gjej
krejt të zhveshur prej malli a dashurie
do të më mblidhesh i gjithi si një hënë dhjetori
që pret dimrin në kraharor
fryma ime,
një piskamë krejt e kotë për t’u dëgjuar kund,
veçse për t’u mbytur thellë, në hapësirën mes barkut tim!

MUNGESË

Teh drite në ag shprese
Më duaj edhe pak
nëpër dritë s'na gjen dot muzgu i jetës!

(Version i ripunuar)

...dhe qytete të mëdha që rrojtën mijëra vjet
dhe pastaj u katandisën në kullota për buajt,
në ara të mbjella me panxhar e me misër.
JORGOS SEFERIS, POEMA, 137

1

Një ditë shtatori
Kur në vreshta vileshin bistakë të pruar e
të zinj
Kur retë e hirta lajmëronin afrimin e vjeshtës
Mbërrita në qytetin e lashtë të Apolonisë¹

Unë u çudita dhe u pikëllova
Ngaqë nuk e pashë gjëkundi perëndinë
Apolon
Të më priste në hyrje të qytetit të tij të lashtë
Të më hapte derën
Dhe të më uronte mirëseardhjen

E kuptova se koha nuk kishte qenë
përdëllimtare
As ndaj perëndisë së dritës
I detyruar të endej në qytetin e tij si hije
I detyruar t'i nënshtrohej ligjit të
pamëshirshëm të kohës
Të mungonte në qytetin që mbante emrin
e tij

Në vend të një sportelisti a të një ciceroni
Unë takova një polic me një uniformë të dalë
boje
Që më lejoi të hyja në këtë qendër
arkeologjike
Në shkëmbim të një kartëmonedhe
pesëdhjetëlekëshe

Ky polic gjysmë analfabet
Nuk mund të merrte me mend sesa qesharak
ishte
Ai bakshish prej pesëdhjetëlekësh
-Një kartëmonedhë e zhubrosur dhe e
lerosur-
Për të fituar të drejtën për të vizituar
Perëndi dhe perandorë
Për të kapërcyer pragun e një kohe
Të humbur në labirintin e Përjetësisë

Për t'i bërë ballë mërzisë
Që e rrethonte si një sarkofag i gurtë
Ose në shenjë mirënjohje ndaj blatimit tim
Polic i me uniformë emblematike
Që ngjante sikur kishte zbritur nga një afresk
i vjetër
Mori përsipër rolin e ciceronit
Në këtë *magna urbs e gravis*²
Me sheshe dhe rrugë
Ku kishin shkelur sandale lëkure dhe ari
Ku kishte kaluar studenti që do të bëhej
Oktavian Augusti

2

Kudo që vështroja
Kishte kolona të përmbysura të gjymtuara të
cunguara
Gurë ciklopikë të rrokullisur të shkukur nga
ledhet
Të thyer të thërmuar
Nga dhëmballët mizore të Kohës
Këto mokra diamanti që bluajnë edhe gurët

I stepur para rrënojave të qytetit
Unë mendova se gurët ishin gruri i Kohës
I mullisit të pavdekshëm që bluan miell
Për dasmën e kobshme të Hiçit...

Pashë perëndi dhe perandorë kokëprerë

Kokat e tyre qenë shkëputur nga
ikonoklastët
Ose qenë përdorur si gjyle guri
Nga topçinjtë osmanë
Ose qenë djegur në furrat e gëlqeres
Për të ndërtuar saraje
Ose qenë shitur në tregje të huaja
Nga trafikantët

Statujat kokëprera të qytetit të Apolonisë
Nuk kishin gojë për të nxjerrë klithma të
llahtarshme

Unë përfytyroja sikur nga qafat e prera të
këtyre statujave
Befas do të gulfonin currila gjaku !

Statujat pa kokë të Apolonisë



Të prera nga gijotina e shekujve
Ishin një mijë herë më të lemerishme
Sesa trupi pa kokë i Luigjit XVI
Kokëprerja e të cilit nuk kishte zgjatur më
shumë
Sesa një rrahje qepallash

Duke vështuar këto statuja kokëprera
Instinktivisht e çova dorën
Te qafa ime prej të gjalli
Ku papritmas mund të binte tehu i
padukshëm
I Kostares shprirkazmë

3

Si ca pleq kujtesëhumbur
Dhe memecë
Që nuk e dinë në ç'vend
Dhe në ç'epokë ndodhen
Statujat e Apolonisë
Rrinin të nemitura përballë kohës sonë

Ato nuk e dinin
Se dielli që përshkonte qiellin
Dhe ua prekte konturet
Me gishtat e ngrohtë të rrezeve të tij
Ishte i njëjti yll i zjarhtë
Që i kishte parë kur kishin lindur

Vështrimi im i dhembshur
Që i prekte ato statuja
Të çmësuara prej kohësh
Nga prania
Dhe nga vëmendja e njerëzve
Ndoshta i bezdiste
U shkaktonte të ngjethura

Më tepër sesa cepat e mprehtë
Të trupave të tyre të gjymtuar
E ndjeja veten të plagosur nga shtiza e
padukshme
E vështrimit të syve të gurtë
Të statujave të paprishura
Që ishin mbushur herë pas here
Nga lot të rremë shirash

4

Në mes të asaj heshtjeje varri që rëndonte
mbi qytet
Para meje u shfaqën disa drurë oshënarë
Të kurorëzuar me degë të mbushura me
gjethe

Ato ishin të vetmet krijesa të tij të gjalla

Gjethnajat frushullitëse të atyre lisave
Dridheshin si kordat e lirës së Apolonit
Të prekur nga gishtat e një sitaredi të verbër
Tingujt e tyre ngjallnin jehonat e brirëve e të
boblave
Që dikur kishin njoftuar afrimin e ushtrive
armike
Sulmet e piratëve të detit
Përse murmuritnin me aq ankth
Lisat e Apolonisë ?

A mos ishin një kor pleqsh
I dalë nga një tragjedi e Eskilit ?
A mos ishin profetë pa ithtarë e pa
besimtarë?
A mos ishin poetë të vdekur apo poetë
gjuhëprerë?
A mos ishin vajtojca
Të mbledhur në një cermoni funebre
Të metamorfozuar në drurë nga ndonjë
mallkim hyjnor
Për të recituar elegjinë e këtij qyteti memec
Të katandisur në rrënoja?

Lisa të Apolonisë
Duke dëgjuar frushullimat tuaja
Më erdhi ndër mend
Poema „Zhurma e drurëve „
E poetit Robert Frost-i që ka shkruar:
Ata flasin për nisje
Dhe kurrë nuk nisen për udhë...

Nëse një ditë prej ditësh
Rrënjët tuaja do të shndërroheshin në këmbë
Për të udhëtuar drejt tropikëve ose drejt
poleve
Ju do t'ju merrte malli për këto rrënoja të
trishta
Do t'ju mungonte
Qyteti që mban emrin e të ndritshmit
Apolon

Lisa të Apolonisë
Murmurima juaj drithëruese
Më ngjallte dëshirën për të pasur rrënjë
Për të parë degë të më rriteshin në trup
Për të murmuritur bashkë me ju midis erërave!

5

Në afërsi të ledheve të qytetit
Një bari plak i përkulur mbi kërrabën e tij
Ruante një tufë dhensh
Që nuk kishte asnjë lidhje me Kopenë e
shenjtë të Diellit
Të përmendur nga Herodoti
Në librin IX të Anketës së tij...

Çfarë i kishte ndodhur Kopesë së shenjtë të
Diellit?

A mos e kishte sulmuar ujkonja e Romës
A mos e kishte plaçkitur ushtria e
Kantakuzenit
Apo më në fund e kishin shfarosur
Ujqit mongolë që kishin kapërcyer Bosforin?

Pyetjet e mia mbetën pa përgjigje
Sepse shortari Deifon dhe babai i tij Even³
heshtën
Heshti edhe Apoloni i ndritshëm

Duke vështuar dhentë
Të shpërndara në livadh
Më dukej
Sikur në vend të fijeve të barit të fishkur
Ato kullotnin fragmente orakujsh

Bariu plak
Me vështrim të humbur në largësi
I mbështetur në kërrabën e zbukuruar me
motive mitike
Më kujtoi Evenin fatzi
Të verbuar me urdhër të pushtetarëve të
qytetit

Unë pata dëshirë ta takoja dhe t'i
përgjërrohesha Apolonit
Duke u përkulur para tij :
*Apolon muzazhet, mbroji të pafajshmit e të
pafuqishmit*
Mos i lërë të jenë përherë
Viktima të pushtetarëve të padrejtë e mizorë!

6

Mbi ledhet e qytetit
Kishte rënë një shtresë bloze dhe hiri :
Ajo i shtrëngonte me një shirit të zi gurët e
moçëm
Si në kohën e Pal Emilit⁴
Dhe të pashallarëve që kishin ardhur me
pishë në dorë

Një pronar i sotëm
I babëzitur të zgjeronte kullotat e kopeve të tij
U kishte vënë zjarrin ferrave dhe shkurreve
të thata
Rreth qytetit që mbante emrin e Apolonit
Pa menduar se mund të digjte lisat dhe
ullinjtë
Të vriste banorët e tij të vetëm të gjallë
Hyjnitë e tij të gjelbra

Gurët e ledheve i kishin shtrënguar nofullat
Ishin ngjethur nga dhimbja e lemerishme
Dhe buzët e tyre të përvëluara kishin
pëshpëritur
Emrin e konsullit Pal Emili

7

Në zgavrën e një ulliri
Të nxirë nga bloza
Një breshkë e vogël e shpëtuar nga zjarri
Sfidonte pronarin që kishte imituar
perandorin Neron

Me rrashtën e saj të ashpër
-Mburoja e parë e shfaqur në rruzull-
Ajo u kishte bërë ballë
Shigjetave të flakëve vdekjeprurëse

Ajo ishte simbol i jetës së butë e të brishtë
I jetës së paepur
Që ka sajuar guaska ledhe strehime
antiatomike
Për t'u mbrojtur nga kërcënimet e vdekjes

Luftëra dhe zjarre të panumërta
Kanë lënë pas tyre shtresa bloze dhe hiri
Por jeta e brishta e buta
U ka bërë ballë të gjitha fatkeqësive

Pas Trojës Kartagjenës Guernica-s
Pas Auschwitz-it Hiroshimas Nagasakit
Pas Çernobilit e Fukushima
Jeta e ka yshtur hirin me gjelbërim lastarësh

Mbahu fort breshkë e vogël
Nën zhguallin me të cilin të ka mbështjellë
natyra
Ti je shëmbëlltyra e planetit tonë
Ku jeta është më ngulmuese sesa të gjitha
mynxyrat

8

Manastiri i Shën Mërisë në këtë qytet
I ngjante një tumori të stërmadh
Që kishte gllabëruar gjymtyrë statujash
Kolona dhe friza tempujsh të lashtë

Me urdhër të priftërinjve ikonoklastë të fesë
së re
Ndërtuesit e kishës
Kishin shkatërruar veprën e pakthyeshme të
Kohës
Por e përshpirtshmja Shën Mëri
Nuk mund të kërkonte
Zhdukjen e Afroditës së hirshme
Sepse bota jonë
Nuk do të ishte as më e dëlirë as më e bukur
Pa hiret e perëndeshës së lindur nga
shkuma...

9

Në këtë qytet
Dikur njerëzit kishin shtyrë shoku-shokun
Para tezgave me mallra
Të ardhura nga Apolonia nga Bylisi nga
Dimali nga Amantia
Ng Korinti nga Korfuzi
Para amforave të mbushura me verë Rodosi
Kioje dhe Kampanie...

Në këtë qytet kishin kaluar pranë e pranë
ushtarë e detarë
Artistë matrona konkubina skllëvër
Kishin jehuar pyetjet e blerësve
Përgjigjet e tregtarëve
Por mbi të gjitha këto jehona
Kishte kumbuar zhurma metalike e
monedhave
Në të cilat ishin gdhendur figurat e Apolonit
Të Dionisit të Augustit të Hadrianit të Mark
Aurelit...

Edhe në ditët tona është zhurma e
monedhave
Ajo që marros bursën e Nju-Jorkut
Bursat e Frankfurtit të Londrës të Parisit
Të Shangait të Tokios

Nëse figurat e gdhendura në monedha kanë
ndryshuar
Nuk kanë ndryshuar metalet
Me të cilat janë prerë monedhat
Dhe sigurisht nuk është pakësuar asnjë grimë
Roli i monedhave në fatet e njerëzve

Bashkëkohës naivë
Të dalldisur pas horoskopëve
Që jua servirin në tabaka masmediat
Jeta juaj nuk varet nga yjtë dhe nga yjësitë :
Ai varet nga metali dhe nga figurat
E gdhendura në të dy anët e monedhave

10

I ndalur para pjesëve të mbetura nga Odeoni
Thashë me vete :
Ku janë poetët e qëmotshëm ?
Ku janë poemat e tye kozmogonike
Heroike lirike jambike
Të ruajtura vetëm në kujtesën e erës?
Ku janë tragjeditë komeditë
Dhe aktorët me kothurna druri?
Ku janë korezhët
Ku janë spektatorët e dhënë pas shfaqjeve
Të ulur në shkallinat e gurta?

Ai Odeon i rroposur
Ku sundonin zbrazëtia dhe heshtja
U ngjante korridoreve të Hadit
Ku buçitnin lehjet shurdhuese
Të Cerberit trikrerësh

Nën qiellin e vrenjtur të asaj dite shtatori
I shtangur para një shkretimi të tillë
Pata dëshirë të lutesha:
Febus Apolon shpëtoje botën tonë
Mos lejo që ajo të mbulohet nga heshtja
Si gërmadhat e këtij Odeoni!

Atëherë një zë i brendshëm më tha
Të mos e shqetësoja më kot të gjorin Apolon:
Ai që nuk kishte mundur të shpëtonte
qytetin e tij
Si mund
Të shpëtonte
Botën tonë?

11

Apoloniatët e adhuronin si hyjni
Lumin e tyre të shenjtë Aaos⁵
Ata i kishin kushtuar një statujë mermeri
Me një mjekër prej ujërash që gurgullonin
Ata e kishin zgjedhur kryekomandant të
ushtsisë së tyre
Në betejën kundër Thronionit⁶

Ata nuk dyshonin se pas një mijë vjetësh
Qyteti i tyre i lindur nga porti
Që ndodhej buzë lumit të thellë
Do të kishte fatin e fëmijëve të Kronosit
Të vrarë nga babai që i kishte sjellë në jetë

I goditur nga një mallkim qiellor
Ose viktimë e një zemërimi të dheut
Lumi i shenjtë dhe i lundrueshëm Aaos
E kishte braktisur portin e Apolonisë

Duke prerë kështu
Kërthizën e këtij *Civitas libera e immunis*⁷
Duke pushuar së qeni aorta
Që e lidhte me detin jetëdhënës
Dhe me ardhmërinë...

12

Të shkreta - rrugët
Sheshet – të zbrazëta si zero të stërmëdha

Në këtë qytet të gurtë
Nuk banonte më populli i fjalëve

Në vend të zërit të pritanit⁸
Në vend të zërit të kryepriftit
Në vend të zhurmës së zërave të kalimtarëve
Murmurima elegjiake e erës që përcikte
rrenojat
Jehonte nën kubenë e hirtë të asaj dite shtatori

I pyeste lisat
Pitia e lashtë e erës
Dhe gjethet frushullitëse
I përgjigjeshin në gjuhën e tyre të gjelbër

Murmurima e lisave të Apolonisë
E mbytur e trishtë monotone
Ndoshta kishte në vetvete
Diçka ngë ligjërimi orakullor
I lisave mitikë të Dodonës

Kjo murmurimë ngjethëse
Më ndoqi pas si zëri i një fantazme
I shoqëruar nga vajtimi i erës...

13

Në një cep të këtij qyteti
Ku vazhdonin gërmimet
Pashë një arkeolog dhe ndihmësit e tij
Të përkulur mbi një statujë të sapozbuluar
Sikur zhvarrosnin një njeri të sapovdekur
Duke e nxjerrë nga dheu
Për ta kthyer në jetë
Duke e shkukur nga nofullat e hapura të Vdekjes

Ata që gërmonin
Të fundosur deri në brez në gropat e hapura
Ngjanin nga larg
Sikur po i përpinte të gjallë
Goja e zezë e errësirës së nëndheshme
E babëzitur të zhdukë gjithçka në angrrat e saj
Ashtu si kufomën e gurtë
Të këtij qyteti të lashtë...

14

Në mëkresat funerare të Apolonisë
Vdekja simbolizohej
Nga dy vetë që ndaheshin
Dhe poshtë tyre kishin
Fjalën *Haire* (lamtumirë)

A mos vallë nga gjithçka që kemi dëgjuar
Nga gjithçka që kemi thënë apo kemi
shkruar në libra
Do të mbetet fjalë *Haire*
E gdhendur në mëkresat funerare të
Apolonisë?

Në fund të fundit jeta e çdo njeriu
Çfarëdo që të ketë qenë dhe çfarëdo që të
ketë bërë
Do të ketë si epilog
Fjalën e thjesht: *Haire*
Me të cilën i lashë lamtumirën
Këtij qyteti të vdekur

Në çastin e ndarjes
Edhe lisat e Aolonisë
Që murmuritnin në erë
Më përshëndetën me fjalën lapidare:
Haire!...

Apoloni, 2011

¹ Apolonia: qytet i Ilirisë së Jugut (Shqipëria e sotme), i themeluar në shekullin VI para J. K.

² *Magna urbs e gravis*: qytet i madh e i rëndësishëm, shprehje e Ciceronit për Apoloninë e Ilirisë

³ Even: Herodoti e përmend si bariun që ruante Kopenë e shenjtë të Diellit në Apoloni

⁴ Pal Emili: sipas disa burimeve, ky konsull romak shkatërroi shtatëdhjetë qytete në Ilirinë e Jugut

⁵ Aaos: sot ky lumë quhet Vjosë

⁶ Thronion: qytet grek, rival i Apolonisë

⁷ *Civitas libera e immunis*: statusi që perandori August i dha Apolonisë

⁸ Pritan: autoriteti civil më i lartë i qytetit

ARNA

tregime nga Uran Butka

Kur binin në shtrat, asaj i pëlqente që ai t’ia lëmonte shpinën, shpatullat, qafën...

- Më fërko paksa, të lutem! - belbëzonte ajo.

Ai i vinte dorën mbi këmishën e mëndafshhtë të natës.

Dora rrëshqiste lehtazi mbi sipërfaqen e shkarrëzuar dhe të shndritshme të cohës.

Ajo kishte një sqimë e kënaqësi të veçantë për veshjen. Vdiste për veshje të bukura dhe elegante, madje edhe të gjitha të bredshmet i mbante të rrëshqitshme, të bardha, gati të tejdukshme. Ndoshta e kishte të lindur ndjeshmërinë ndaj luksite komoditetit. Ndoshta edhe të kultivuar herët, se vinte nga një familje qytetare. E kishte gjakim të natyrshëm, të vetvetishëm.

Nuk donte të dukej, sesa të ndihej. Por edhe atij i pëlqente bukuria e brendshme. Mirëpo, kur ishte i lodhur dhe i mërzhitur, e harronte apo e shmangte ritin e përnatshëm. Ajo i afrohej, e puthte lehtë në cep të buzëve dhe i vinte kokën mbi gjoks. Priste që ai t’ia ledhatonte pak flokët

e kurmin. E kishte të nevojshme. Vetëm kaq i mjaftonte për t’u ndier femër, për t’u çlodhur shpirtërisht, për të komunikuar nëpërmjet dorës së tij, sepse dora për atë ishte pjesa më e ndjeshme e kumtimit njerëzor. Dora ndien dhe përçon ndjesi. Dhe kur dora e tij nuk bëhej e gjallë, ajo merrte pranë gjoksit dorën e zemrës, bashkonte pëllëmbën e tij me të sajën dhe puqte dridhshëm gishtat që flisnin me gjuhën e shpirtit. Atëherë, në amshim, mbyllte qepallat dhe regëtinte:

- Fli, shpirt, fli!

Ai përmendej, zgjaste dorën tjetër me përtesë dhe i fërkonte shpatullat më fort se zakonisht. “Gruaja është si kotelja”- thoshte me vete dhe e lëvizte mekanikisht dorën mbi cohën e lëmuar. E dinte që ajo kësisoj nuk ndjente ndonjë kënaqësi, sepse dora ishte e rëndë, e tendosur dhe nuk prekte në mish, por mbi këmishën e hollë. Megjithatë, ajo nuk thoshte “mjaft”. Ai ia shpërblente me një humor të hidhur: ”Kur të lodhesh, më thuaj”. Ajo kukuriste mbytur dhe ia kthente: “Më ngadalë, m’i theve kockat”.

Mandej, e këqyrte me sytë vezullues ngjyrëkafe të çelët me ato ninëzat e zeza të vagëlluara, ku ishte fokusuar gjithë shpirti

i saj i qashtër. Afronte fytyrën e hajthme, përçiknin flokët, ballët, buzët fërgëlluese. Ashtu i zinte gjumi i përshpirtshëm.

Një natë, tek e ledhatonte, dora nuk rrëshqiti lëmueshëm si zakonisht, por u fërkua mbi një cohë fanellate, gjithsesi e butë dhe e ngrohtë, por joferëllitëse. “I mungoka këmishëza e mëndafshhtë sonte, mendoi. Ndoshta, ngaqë lahet dhe ndërrohet përnatë...”

Ai zakonisht nuk futej në shijet e intimitetet e saj, megjithatë diçka ndjeu turbull brenda tij. Diç i mungonte femërores së saj dhe natës së tyre të magjishme.

Ia hoqi këmishën e pambuktë, sikur i hoqi diçka të huaj dhe trupi i saj i bardhë, i derdhur dhe i njomësht u zbulua i brydhtë në terrin e natës. Sqeptoi butësisht me mollëzat e gishtërinjve në gjithë kurmin e saj, që fërgëllonte nga kënaqësia e trallisur. Sytë iu pulitën dhe qepallat i dridheshin nga afshi. Mandej trupat cullakë u bënë një, buzët u përthithën dhe llagëmet e gjakut e të epshit u bashkuan.

Nata ishte plotësisht e tyre. S’donim të fusnim brenda mureve të saj asnjë shqetësim të ditës. U mjaftonte nata që të ndienin e të harronim gjithçka. Ajo i këndellte dhe i përtërinte.

Mirëpo një natë... Ajo vuri kokën mbi gjoksin e tij si zakonisht. Atë e dehu aroma e luleve të egra të malit që përhapnin flokët e saj. Ia ledhatoi butësisht me pëllëmbë flokët ngjyrëmjalti të përhapura si kurorë gështenje, mandej me mollëzat e gishtërinjve i nduku lehtë

qafën e gjatë dhe rrzën e supeve. Ajo u shkrydh. Dora rrëshqitilirisht mbi këmishën e natës me një fërffëllimë epshndjellëse, por përnjëherësh u ndal e dridhur nga një pengesë e papritur. Nuk i besoi asaj prekjeje. I kaloi sërish gishtat mbi të, por i tërhoqi

me vrull, sikur të kishte prekur një dregëz kanceri. Ishte një arnë e qepur mbi këmishën e saj prej bezeje. Atij iu duk sikur ajo kishte veshur një arnishtë. Ndjeu një rrënim të brendshëm. I iku pa kthim gjithë dëshira e kënaqësia, i ngriu pathosi i shpirtit.

Pëllëmba iu këput dhe i mbeti si një gjethe e thatë mbi trupin e saj të dridhshëm.

magji

një letër e bardhë
dhe një penë mbi tavolinë,
si memece ngjajnë.
një lule në vazo,
sa pak shpirt ka ajo
thuajse është pa frymë.

kjo ditë
është gri
dielli rri larg , si një plagë,
si një mungesë.

vjen Ti...
fleta e bardhë gëzohet me një poezi,
lulja merr frymë me prekjen tënde,
ndërsa dita
e merr diellin,
nga sytë tuaj të qeshur
dhe unë jam një gjeth
në pemën e çuditshme të jetës!

këngë e përzishme për jetën
dhe një mi

asnjë nuk e pranon se ti je.
ne çdo ditë hedhim plehrat,
ushqimin tënd të preferuar,
pastaj shkojmë në farmacitë bujqësore
e bjemë ilaçe,
për të të helmuar ty,
duke bërë kësisoj një lojë të dyfishtë.(!)

asnjë nuk të pranon ty si qenie,
por ti je mes nesh në jetën të përditshme.
dhëmbët e tua brisk
na hanë pa u ndjerë,
derisa ne shembemi brenda vetes
duke rënë në gropën tënde!
o miu i...legjendës!

gropa

e madhe, e stërmadhe
gropa ku të përfshin
dëshpërimi!
nuk ia përmendim emrin

me idenë,
se kështu arrijmë t'i fshihemi.(!?)
rreshqasim drejt kësaj grope
pa nxjerrë zë,
dhe biem brenda saj
antiheroikisht
një e nga një!

Liria

dikur mendoja se zogjtë ishin të lire.
sa herë i shihja doja të isha zog,
pastaj mësova se edhe zogjtë
ishin të rrezikuar nga të tjera qenie
aq më shumë nga...njerëzit,
të cilët janë të prirur t'i ngjajnë
paraardhësit të tyre ... Kainit(!)

i shqetsuar nga liria e rrezikuar prej gjithkujt
vrapova dhe e gjeta Lirinë ,
tek ...mendimi!

e pabamja

nuk mundesh ta bash dot të pabame
rri e mendoj... ndërkaq ndjehem i
përhumbur,
dikur e kisha si në dorë zemrën tande,
kur na gjuante tinëz koha e na ishim të
lumtur.

a ka se si kështu me qenë vërtetë fundi?
gjithçka që shkoi ishte, si qielli me vetëtima
ai mot i çuditshëm na lagu e kur na doli
gjumi
kishim shkuar aq larg, duke i humbur të
gjitha!

anësi në Trojë

zulma e betejës më gjëmon në vesh akoma
vringëllimë armësh, djersë, gjak edhe
pluhur,
Hektori që bie përgjakur nën goditje të forta
të Akilit, që ta vrasësh është krejt e
pamundur.

SHPËTIMI I ZOGJVE

Poezi nga Preng Maca



e përmendin shumë njerëz, si hero Akilin
me thembrën e fshehtë,
i rafinuar përsosmërisht dhe një vrasës i
madh
falë hiles që mbart, në shpatë i rri vdekja.

po mua vdekja prej tij ma dridh kraharorin,
luftëtarët hileqarë kurrë s'mi do zemra,
kam qenë gjithnjë dhe jam me Hektorin!

shpëtimi i zogjve

i vogël isha aso kohe...
nuk më bie ndërmend saktë mosha,
por ajo që mbaj mend është,
se ai zog i vogël, i vogël dridhej,
krejt pupla thuajse ishte,
(saqë mendoja një kohë të gjatë,
se si mund të fluturonte
e nuk i merrte era zogjtë,
kur ngriheshin në qiell!?)

e mora në dorë atë zog,
bashkë me dridhjen
ia ndjeja zemrën në dorë,
rrihte më tërbim e bashkë më të rrihte
...zemra ime!

duhet shpëtuar, thashë!
e vura në një pemë e ai cicëroi,
për çudi i dolën fletët,
e ndihmova,
u ndjeva i shpëtuar vetë,
duke ia shpëtuar jetën!

tani i rritur
akoma e kam në mendje atë ditë, strukur në
kujtësën e kthjellët.
kurrë në jetën time nuk kam vrarë zogj,
e sa herë i shoh zogjtë në qiell, duke fluturuar
gjithnjë më duket që atëherë,
kur isha i vogël dhe e shpëtova atë zog,
gjithë zogjtë e botës unë i kam shpëtuar!

shtëpi

mendimet e mia janë trarët,
çastet e fiksuara janë çatia,
fjalët e shkruara janë muret,
raportet me jetën dhe vdekjen janë themelet,
ndërsa dashuria ime janë dritaret.

Ju gjithnjë mund të shihni
çfarë ndodh në këtë shtëpi
brenda së cilës gjendem mbyllur,
nga mungesa e dyerve,
shkaktuar prej pavetëdijes!

gjysëm shaka

kur vijmë në këtë botë. gjithnjë kam dyshuar,
se kam qenë dikur, diku
dhe Ai në një kioskë
na jep nga një biletë llotarie falas ,
me një vlerë prej 100 vitesh,
pastaj sejcili e harxhon sipas gjërave që
dëshiron

dhe i fituar është ai njeri,
që nuk do me shumë pasion.

vërtet ajo biletë
ka vlerën e 100 viteve,
por Zoti shpesh bën kursime
dhe nuk na lejon t'i bëjmë
deri ne fund ...shpenzimet.

ditë

njëzet e katër gjymtyrët e tua
këmbë, duar, buzë, veshë
herë më shohin butë e herë egër...
(të tmerrshmet gjymtyrët e tua!)
herë më përkëdhelin e herë më qëllojnë
e unë mundohem të të vë poshtë,
ndërsa më ngjan më ngjan krejt, si një femër
taksa më lodh e nuk më jepesh.

më sheh me bisht të syrit
fjalë ngacmuese duke më thënë,
duke mos pranuar
kënaqësi për të dy.
e unë përpiqem të të zhvesh
tek zbuloj tek ti, si tek një miss
kufirin e magjisë.

ndërkaq në këtë mundim
më mbërthen gjumi njerëzor
në një paqe ... pa kuptim!

fëmijëria ime

(gjithnjë ajo më rri në sy!)
e vështroj atë djalë të ri e zemërmadh
udhëtar i palodhur, përherë i gatshëm
për të zbuluar botën e madhe,
herë me këpucë të reja, herë të vjetëruara
shkatërruar nga rruga.

më dhimbset!
sa e dua atë djalë!
ndonjëherë e kam përzënë prej vetes,
duke u ndjerë me turp për atë qenie
fëmijën e vogël
pa të cilin, si mund të isha?

ai vjen e më gëzon,
duke më pushtuar,
kur futet brenda meje,
më merr për dore dhe më tregon
disa të fshehta të harruara,
për të zbuluar zemrën!

puls

prej shkaqesh të padituna,
mbramja u thye,
si një ...xham!

mes copave të shpërndara,
(zemërthyer nga e papritura),
këmbëngul në gjetjen e copës,
në të cilën shndërruar...jam!

fije

mbahemi vetëm në një fije
e hollë është , e pabesueshme
të mbaresh në këtë fije të hollë .

pastaj vjen një ditë, e besojmë ,
se ajo nuk e di ç'është lodhja, këputja .
tamam atë çast ndodh gjëma ,
këputet fija
ne biem...jashtë,
duke dyshuar,
se po biem... brenda!

flijimi

ajo që të fala ty
ndodh veç një herë
nuk kthehet më.

lotët për ty
janë bërë gri
janë kthyer në re.

kushedi ku je, kush e di?
veç një herë të hasa
rrugës, kur nuk e dinim
se kohën po na e vidhte mëria.

(o Zot,si ndodhi kështu?)
je aq larg,
ndërsa fshehtas hyn e del pa prekur,
duke më pushtuar,
siç të pushton... pamundësia!

ngjarje e parashikuar

kur të vdes,
jam i sigurt,
se do të vijnë të gjithë
ata që më deshën dhe ata që nuk më deshën,
do të ma lavdërojnë poezinë
(të dytët),
do të thonë,
se kisha një brendi të thjeshtë , të një shpirti
të madh
se kisha një gjendje, si të shiut në verë
dhe një dashuri, që nuk prante asnjëherë,
shumë trëndafila, margarita e ca zogj, si në
pranverë
pyje dhe det e fusha , lumenj që ecin paprerë...
profilin e një vajze, që e ka dashuruar përherë.

do të thonë gjëra, që nuk i kanë thënë kurrë
më parë
pastaj do të afrohen,
duke ma vënë dorën, lehtë, mbi ballë,
për të qenë të sigurtë në vdekjen time të
pabujshme,
nga frika e ringjalljes së mundshme.

unë nga inati do të bëj ç` është e mundur
ta hap pak syrin, e t'i tremb për vdekje,
gjoja,...se jam akoma gjallë!

lojra në ujë

jam ajo çfarë vizaton guri
hedhur nga dikush, prej diku,
në sipërfaqen e një uji të qetë e të thellë,
ato rrathët që hapen thuajse pa fund...

pastaj veten çast pas çasti e tkurrin,
e së fundmi ,
në rrethin më të vogël,
shkojnë ta gjejnë sërish... gurin.

vezë

e pa sigurtë është jeta sot
si një qelq,
nga çasti në cast
mund të bjerë në tokë
e të thyhet.

në njëqint vezë që shiten
njera është ...bombë.

koha e çoroditur
ka vënë një kosh mes këmbëve
dhe thërret : “hej! blini vezë!”

ne,
çdo ditë mbyllim sytë
e blejmë vezë.(!)

rrëfim dashurie

ah si ndjehesha aso kohe,
isha marrëzisht i dashuruar,
ajo kish nëpër gjinj një aromë,
sikur flinte mbi mollë e ftua!

dita më bëhej sa një orë
“ah – më thosh - në më do sado pak
më merr o shpirt përdore
më mbaj në shtëpi, veç një natë!”

e mora, e doja aq shumë
at’vazjë me sy gështenje
gjithë natën nuk fjetëm gjumë,
dhe kështu që ndërrova mendje.

nuk u mendova dot gjatë
ndaj ndërrova mendje shpejt
e ftova për më shumë se një natë,
së paku për... njëqint vjet.

por vitet ikën si lumi
çfarë ndodhi ish një çudi,
s’mbaj mend se si më zuri gjumi,
kur u zgjova ajo s’ish më aty!

një plak i mençur ç’më thosh
prej kohësh dhe tani më kujtohet ;
“gjithnjë ndodh në këtë botë
kush do më shumë, lëndohet!”

nuk është me mua sygështenja
kujtimi i saj thellë më djeg,
vështirë ta heq nga mendja,
së paku... për njëqint vjet!

vizatime... pa dashje

as unë vetë nuk e di si ndodh kështu,e
pashpjegueshme
është akti ,se si mbi një letër shpejt e shpejt,
si e nxjerr prej vezës së ngrohur nuk e di
prej sa kohësh
majë lapsit më karbon të butë
merr formë një zog i trishtë,i hajthshëm,i
vogël.

pastaj tek e sodis natyrën shterpë
trishtohem,
ka aq pak pemë gjithandej,
të “fshihet” në një çerdhe është thujse e
pamundur
foletë e mundshme janë trembur e nga
zhurmat e mëdha janë shkundur
(ku do të jetojë ky zog i shkretë?)
është puplor e krahët nuk i shkund dot për
zhvendosje,
ndërsa përkundrejt tij sa shumë genie
presin të jetë preja e tyre e ardhshme,
duke ju gëzuar asaj që unë padashje e
vizatova,
thujse krejt pa dashje!

trishtimi më mbulon e më pas i pendohem
asaj lirisë së krijimit absurd
të këtij zogu që ngjan me ëndrrën time
shpikur brenda vetes intime,
për të prekur aq gjëra, që së fundmi u gëzoj
vetëm dëshirën.

befas pendohem,
mendoj se ndoshta do të më duhet ta fshij
për ta shpëtuar nga një e ardhme,
me rrisqe të mëdha e nga kjo botë gojë –hata!

por sa e kthej kokën sërish tek fleta
krijesa ime... ka dalë nga letra e bardhë
për shkak se,... sapo i dolën flatrat
dhe unë tashmë e kam mendjen tek vendet
ku fluturon
rreziqet e mëdha të kësaj bote të madhe
që i ha gjërat, pasi i lind krejt rastësisht
kjo Botë që nuk di ta gjej kurrë paqen!

burgu

gjithnjë ne gjendemi
në burgun e pamundësisë,
për ta prekur ëndrrën!

endemi në këtë qeli të përbotshme
duke jetuar,
vuajtjen e përkohshme

SHPIRT I PANJOHUR

Tregim nga

QAZIM SHEHU

Arseni po rrinte me dy shokë në cepin e
një rruge dhe po bisedonin për punët
e tyre, kur befas tyre u shfaq një grua e
bukur dhe qëndroi e ngrirë si qiri. Shtati i
saj i drejtë, hunda nazike dhe flokët korb të
zeza e impononin hijeshinë e saj menjëherë.
Në heshtjen e saj kishte një rrezëllimë
të brendshme që shprehte pengesë. As e
nijnhin, as e kishin parë ndonjëherë dhe ajo
kishte ardhur aty enkas sikur po i ndiqte.
Goni bëri një hap drejt saj por shpejt u
tërhoq duke gjykuar se nuk e gjente fjalën
e përshtatshme për t’i folur dhe se ajo grua
që u afrua aty, duhej të fliste vetë e para, por
mos kishte gabuar, si mund të fliste para tre
burrave?Goni sa herë mend kishte rënë në
grackë të gjahtarëve të tilla bukuroshe, të
cilat të afronin trupin e tyre për një shumë
të caktuar, por s’dinte pse ishte tërhequr, se
nuk ia kishte mbajtur duke sjell ndërmend
provokimet, filmimet, vidiot që qarkullonin
nëpër internet e gjobat që viheshin në
garanci të mosreklamimit të atyre vidiove.
Por jo, një femër të tillë nuk e kishte hasur,
kaq të bukur dhe me një heshtje që tregonte
sikur ajo zbriste në një pus.

Arseni në çast deshi të fliste edhe ai,
po ndërsa u mat të nxirrte zërin, gruaja e
ndërpreu duke iu dridhur buza;
- Zotërinj a më falni diçka se kam djalin
të sëmurë e ka nevojë për kurim.

Pas këtyre fjalëve Gaqos iu kujtua
mashttrimi që bënin këto femra që hiqeshin
si lypsare.Jo, kjo grua s’duhej të ishte lypsare.
Bluza e saj nuk e tregonte këtë, as fustani
elegant dhe këpucët e shndritshme, flokët
e krehura me kujdes, por me siguri dikush
e kishte nxjerrë aty si provokim, mos vallë
burri, ndonjë pinjanec ordiner ose mbase
kishte harxhuar paratë me të dashurin dhe
tani s’kishte sesi t’i justifikonte para burrit.

Një grua e tillë dhe të jetë pa para,
mendoi Goni. Nuk ka mundësi ose ajo
ka një ves që nuk i shqitet. Sa herë kishte
ndeshur lypësa të veshur shik, burra, por
gra të veshura bukur që lypnin ishte hera
e parë që shikonte. Ndërsa Arseni nuk po
mendonte gjë, vetëm se nxori portofolin dhe
shkëputi prej tij një pesëdhjetë mijë lekëshe
dhe ia zgjati gruas.

-Merri, - i tha, - dhe zoti ta shpëtoftë djalin!

Në çastin që gruaja i mori lekët me
përtesë por duke mos e bërë veten që të
tregonte ngutje, ajo vijëzoi në buzët e saj një
ngazëllim të lehtë, që i erdh nga brendësia
e qenies e sakaq iu tërhoq po në brendësi të
zemrës së saj.

-Faleminderit, - tha, - dhe zoti ta ktheftë
këtë mirësi!

Gaqo me Gonin panë njëri-tjetrin dhe
nuk e vunë re sesi gruaja ishte zhdukur sakaq.
Bukuria e saj që zgjati pak minuta i drodhi,
si nuk e rrëmuan atë grua ta pyesnin se nga
ishte, ku punonte, çfarë sëmundje kishte
djali i saj? Po fundja çfarë u duhej, se mos
ajo do t’u tregonte të drejtën. Nganjëherë
bukuria e jashtme nuk e justifikon atë të
brendshmen, që është e mistertë. Ndërkaq
s’kish sesi të mos pendohej Gaqo që u iku një
zogëz e tillë nga dora, një mënjollë qafëgjatë
me bel të këputur dhe këmbëdrejtë, e freskët
dhe e palodhur sikur të mos kishte lindur
fëmijë. E pra, Gaqo e kishte portofolin plot



dhe mund ta merrte atë grua ta qeraste, ta
çonte diku me dyfishin apo më shumë të
parave të Arsenit... Sa i ngathët ishte treguar
dhe këtë nuk do t’ia falte vetes edhe pse
duke harruar se gjithnjë me femrat kishte
qenë një belbak dhe fjalët i vinin kur nuk i
duheshin më... Mbetën për disa sekonda të
ngrirë, por Goni foli.

- Po ty Arsen, nuk t’u dhimbsën ato para?

- Patjetër që m’u dhimbsën por ajo tha
se kishte hall...

- Dhe nuk i dhe pak por pesëdhjetë mijë
lekë të vjetra, aq sa të duhen dy ditë punë,
- foli Gaqo... - Me ato para mund ta hanim
një drekë...

-Mos flisni broçkulla se paratë e mia i
dhashë dhe fundja s’ka gjë-foli Arseni...

- Sido që të vijë e ngado që të shkojë fjala,
- foli Gaqo, - burrat janë naivë gjithmonë, jo
të gjithë, kuptohet, dhe bëhen të dobët para
bukurive të tilla...

- As nuk e vëreja me neps, - foli Arseni, -
ajo grua mund të kishte të drejtë... Një grua
me një pamje të tillë të bukur dhe fisnike,
nuk mund të lypë...

- E, - bëri Gaqo, - hajde merr vesh njeriun
sot... E merr për engjëll e të del djall. Unë
për vete nuk i besoj as xhakatës që kam në
trup...

- Jo, nuk ka marrë fund njeriu, - tha
Arseni.

-Pasanik ti Arsen dorxhiar, -foli Goni...

-Mos kujtoni ju se unë fal përditë, por sot
sesi m’u shkrep. Mos kujtoni se ngaqë nuk i
dhatë gjë, kjo më bën mua më të mirë se ju.

Ata u ndanë. Arseni mori rrugën drejt
një pallati në ndërtim ku shtronte pllaka
dhe bënte suva...Pasdite vonë kur shkoi te
shtëpia, e shoqja i tha se kishte blerë një
tapet të bukur...Ajo gjithmonë blinte gjëra
pa lejen e tij dhe Arseni nuk ia prishte. Ajo i
tha se i duheshin disa lekë, por Arseni ende
nuk e kishte marrë rrogën dhe megjithatë i
dha disa para që kishte në kuletë.

- Po të shtoje edhe pesëdhjetë mijë lekë,
do të plotësohej fiks shuma e duhur, - i tha
ajo...

- Për tre-katër ditë, - foli si në faj Arseni,
- sa të marr rrogën...

- Para kemi po nuk dua t’i prek ato, - foli
gruaja e tij...

- Preki, - e nxiti Arseni, - se t’i zëvëndësoj
unë dyfish...

Arsenin nuk e zuri gjumi dhe u përpëlit
një copë herë në shtrat edhe pse ishte i
lodhur...I dhimbnin gjunjët nga të ndenjurit
galiç në shtrimin e pllakave...I rrinte
mendja tek ajo grua dhe kur dremiti me
qepallat e rënduara iu shfaq në ëndërr ajo
zonjë që rendte para një turme të madhe
me burra duke zgjatur dorën e saj ndërsa
ata e largonin...Furia e saj vinte në formën
e rrezeve të diellit që vinin përmes një
rrebeshi...Dhe ata e refuzonin...I doli gjumi
dhe pa se donte edhe një orë natë dhe vinte
mëngjesi. Doli në ballkon, zjeu në xhezve
kafenë dhe piu një cigare...Rruga ndriçohej
e shkretë ndërsa pak më tutje vinte Unaza
e Madhe e qytetit ku ndiheshin herë pas
herë ka gërvima të gomave të makinave, që
lëviznin të rralla e me kalimin e kohës vinin
duke u shpeshtuar...

E shoqja flinte e qetë dhe sapo erdhi ora

e caktuar ai mori çantën me disa vegla pune
dhe doli në rrugë...Po binte një vesë shi dhe u
kujtua për çadrën, por nuk u kthye...Ndërsa
po kapërcente rrugën, kaloi një betonierë e
madhe me zhurmë tërsëlluese, gomat e së
cilës ngritën disa cërka që i spërkatën atij
pantallonat...Një vesë shi dhe të ishte krijuar
një pellg i tillë, e çuditshme, mendoi ai dhe u
afrua për të parë, po ndërkaq në sipërfaqen
e pellgut që ishte krijuar nga një gropë e
hapur nga puna e mirë në rrugën e para dy
muajve shtruar, vuri re një kartmonedhë.
U përkul dhe e mori. Ishte një pesëdhjetë
mijë lekëshe e laguar dhe e zhubrosur nga
zhytja që i kishin bërë gomat e makinës...
Kartmonedhën e lagur e mbështolli me
një letër dhe e futi në portofol, që të mos
njolloste e lagte lekët e tjerë...

Në klub nuk ishte as Gaqo, as Goni. Ata
vinin më vonë dhe ai nuk do t’i priste. Madje
atë ditë nuk donte të takonte asnjë të njohur,
sepse nuk mund të rrinte pa ua treguar se
çfarë i ndodhi...Ata do ta merrnin si tallje,
si një përpjekje e tij për t’u vetëshenjtëruar
si dallim për mburravecëri në këtë botë
të zhytur në ves e në zhvatje...Dhe ai nuk
donte të mburrej sido që të ishte përpjekja e
të tjerëve për ta kuptuar dhe për të besuar në
sinqeritetin e tij...Këtë do t’i thoshte në darkë
vetëm gruas së tij duke ia treguar historinë
të plotë, por edhe asaj pse duhej t’ia thoshte.
A nuk do të dyshonte ajo se ai, duke i falur
kaq para një gruaje të bukur, jepte në mënyrë
të panevojshme një provë sinqeriteti dhe
besnikërie...Sidoqoftë, ai i tregoi se gjeti një
kartmonedhë dhe ajo i tha se me ato para
plotësoheshin lekët për të paguar tapetin...
Por ai i tha se ishte e laguar...

Paraja edhe të jetë zhytur në të pëgëra,
të zgjidh punë... Ajo është sendi më i
pafytyrë dhe të gjithë e duan pse ka fytyrë
të shëmtuar, mendoi Arseni ndërsa gruaja
po i thoshte t’ia jepte...Ai nuk ia dha, asaj do
t’ia jepte, por më parë do ta thante...

E shoqja shkoi në dhomën tjetër ndërsa
Arseni nxori nga sirtari një qiri, e ndezi dhe
po rrotullonte rreth flakëve kartmonedhën
e lagur...Një avull i lehtë dilte nga ajo dhe
ai po mendonte për frymën e saj gruaje
që përpëlitej në dhimbje shpirtërore...
Kur mendoi se u tha, ai vuri dorën mbi të,
por kartmonedha ishte e lagur...Ku nuk i
shkonin mendimet. Mos vallë kartmonedha
vuante për vaktin e ndonjë fukarai që
ishte pa bukë dhe ajo tradhtisht kishte
dalë nga xhepi i tij duke u bërë pre e një
rasti tjetër për të plotësuar një mëkat apo
nevojë më pak të ngutshme? Kushedi. Po
shkonte vonë dhe ra të flejë. Për disa ditë
do ta thante atë kartmonedhë, se nuk kishte
sesi, letër ishte...Ditën tjetër e ditët më pas
kartmonedha erdh duke u tharë ngadalë
dhe ai po brengosej se në këtë ngadalësim
mos vallë ai po zgjaste vuajtjet e atij shpirti
të panjohur të asaj gruaje të mjerë?

I dukej se gruaja ngadalë po dilte nga
qerthulli i dhimbjes dhe erdhi koha që
kartmonedha u tha... Po tani çdo të bënte
me të? Pasi u mendua pak, vendosi të mos ia
jepte gruas edhe pse ajo nuk po ia kërkonte
më. Do t’ia falte lypësit të parë që do t’ia
kërkonte...Sa shpirta të panjohur ka dhe a
futesh dot brenda tyre, mendoi. Gjithsesi!...

Kush është Homeri? Kush është Shekspiri? Po Krishti? S'janë kurrkund. Po Mona Liza, piktura më bizare, që ruhet në Luvër me xham antiplumb? Ç'është Mona Liza? Mashkull, shpend... çfarë nuk thuhet. Më vonë do të dalin përsëri versione që do të errësojnë kinse personalitetet e fuqishëm. Sepse ata, pas shenjë së hyut, kishin dhe një shenjë të dytë, ate të vulgaritetit popullor. Se, bie fjala, Ali Senjefi, me mendim të madh për veten nuk mund të jetojë nën të mëdhenjtë se e mban veten mbi të tjerët, prandaj kjo skotë e përçudnuar, që s'është e pakët, ka portofolin e vet që bën punë, atëherë shpikën antipersonalitetet: hidhet baltë e errësohen figurat. Ç'pallë e qejf o qejf për Ali Senjefin që përfiton nga ky banalitet i shpikur enkas për të dhe bota mbushet me një ushtri me Ali Senjefë! Kështu krijohen dhe antipersonalitetet. Unë jam dhe botues, këtu e lëshoj dorën, se dua dhe të rroj, më fort nuhas e mashtroj vulgun, i botoj bie fjala Kron Darkës tetralogjinë me 2600 faqe, se ai tahmaqar i famës do t'ia kalojë me të shkruar, numër fjalësh, dhe vetë Tolstoit. I ka hipur në kokë. Po ç'ndodh? Për të heshtet. Sepse personalitetet e kanë djallin më egërshan: ata të hanë me gjithë lecka. Ku të lë TF t'i marresh fronin? Ç'bën ai që mbretëron mbi fron si padishah? Krijon modën. Imitohet. Kjo është moda. Dhe këtu shpërthen konflikti. Madhështia matet me pronësinë e modës. TF ndiqet nga shpura entuziaste që marramendthi e kryengulthi në histeri patologjike i sajón apogje hyut të vet, duke e shtypur pa e ndërë mirëfilli dhe urrejtjen që ushqen për të, sepse në këtë sulm për fitore të tjetrit ndjen zvetënimin dhe humbjen e tij. Ali Senjefët dhe Kron Darkat shtohen marrëzishëm në atë turmë fanatikësh të modës që krijoi TF. Dhe papritur, nuk e di përse, ndoshta prej rikthimit të rrejshmëria e vetvetes që u braktis pa mend për hir të TF, kthehet faqja e monedhës nga ana e urrejtjes. Kjo është kriza e modës dhe paralajmërimi i daljes së një mode të re. Shfaqet LK me pasues të shumtë fanatikësh që të vrasin për të. Ai duhet të përdorë të gjitha metodat jashtëletrare që të vendosi pushtetin e vet. Në këtë luftë për pushtet, harrohet arti dhe sendërtohet njeriu biologjik. LK zbulohet me manierat e tij që s'i duhen askujt, po që kënaqin pa masë djerraditët që, ato s'duan mendim, po qyfyre dhe kështu, më fort prej aksidentit të sensacionit, si, bie fjala, LK është njëlloj Edipi se ka shtyrë në vetëvrasje babanë dhe ka shkruar me nënën e vet, letërsia e tij shndërrohet në një stadium popullor. Kaq duhet që ai të kthehet në modë dhe romanet e tij për dashurinë, si një sëmundje vdekjeprurëse, më e keqe se kanceri, imitohen e shumohen në mijëra libra të aradhsë së pafundme të fanatikëve të fjalës. Secili, brenda kësaj kotullore gjarpërinjsh që nxijnë prej ambicies rrënuese, e ka shndërruar me kohë modelin e modës me emrin e vet, po këtë s'e shpall se pret rastin. Ashtu në rendje frenetike duke ngritur në qiell rrejshëm idolin përgatiten ethshem për pritjen e vet. Sepse prej tyre do të dalë nesër krijuesi i modës së re. Aq fërkuese pas arit të emrave të mëdhenj, aq ferruese e grimëhumbëse është kjo shtrëngesë me të shpallurin dy hapa më larg, sa ata një ditë duan ta vrasin. Prandaj ndodh aq shpesh që të dyshohet mbi vërtetësinë e Shekspirit, bie fjala, sepse kjo kthehet në një ngushëllim për dukupakët e prekpacakët. Dhe ata kanë portofole, që hapen gojë, pikërisht prej kësaj trillanie të përçudnuar...

Bukinisti i vjetër, zoti Kin Kurti, qëroi zërin dhe në atë gëzim prej rrëmuesi të bibliotekave të braktisura, bëri një grimasë, lëmoi një pikë lot nën gjyslyket që i ngriti sapak lart dhe me atë lëng në mollëzë të gishtit tregues shfletoi një libër të Pesoas në italisht.

Ky portugezi u bë modë pas vdekjes. Tërhoqi një libër tjetër, Në vetemi, e Frederik Rreshpjes. Edhe ky pas vdekjes. Po këto fjalë tha për Migjenin, Mjedën, Seremben, Palin, Kutelin, e një dromcëri shkruesish me shenjë. Pastaj mori ndër duar Breznninë e Hankonatëve të Kadaresë. Ky ishte modë. Tani po përpiqen ta vrasin. Janë mërzitur me të. Ka qenë moda më e gjatë dhe Kron Darkat jane bërë për të vrarë veten. Talentet e mëdhenj, o zoteri, të marrin më qafë, sepse shkëlqimi lëbyres i modës së tyre lë në hije një rebelues të një mode të re. Ai shtyp e fashit çdo përpjekje,



sepse kokëfortësisht s'do të bjerë. Kjo është çështja: rënia. A është ambicie? A është pangopësi? A është e thënë? Po ai s'e ka kaluar provën. Me vdekjen e vet dhe me asgjësimin apo mosasgjësimin e veprës. Të presim. Po ama moda e tij është tronditur me kohë, po nuk është koha e letërsisë dhe s'e ka mendjen njeri në një fakt të vogël si ky. Poradecin e dinin të vdekur, sepse ai nuk shkroi më pas botimit të dy librave në vitet 30-të të shekullit të kaluar. Ai, sa nisi të bëhej modë, po nuk mundi prej arsyes jashtëletrare. Pas 90-tës u ngrit sërish kulti i tij, ngulshëm e verbueshëm, sikur u zbulua së pari. Aradha që e ndjek është e madhe, po aq i përsosur është ne punimin e fjalës së tij, sa nuk imitohet dot. Kurrresi nuk imitohet. Ai nuk futet në xhep, po në zemër. Është poet i brendshëm. Migjeni të trondit me freskinë e bojës që ende s'është tharë. Sekretet e tij është depërtimi genuin në nevojat sociale, që gjithmonë do t'i vuaje 99 për qind e njerëzimit. Regjistri i tij është i gjerë, pentagram Betovenian. Aty fshihet protestuesi, një hero i kohës sonë. Protestues do të ketë gjithmonë dhe kur bota të shuhet, i fundit do t'i mbyllë sytë protestuesi. Ky dhe të tjerë janë aq të medhenj sa e kanë të përkorë masën e modës, prandaj nuk të mërkiten e s't'i ngrënë nervat. Po me këta të vdekur është më e lehtë puna. Kujdes nga të gjallët, që e duan lavdinë për vete. Ata s'të falin. Atë një cikë që i ka shpëtuar zotit mbi ta, si njollë, dinë ta shesin shtrenjtë dhe aq shumë është mbushur bota jonë e vockël me këta mburraveçë krenarë e vepradanguill, sa shija e modës është vdirë e shkimë. Të vdekurit falen, sepse nuk kanë më punë me të mirat tona, paratë, çmimet, femrat, po ata luftohen nën rrogos, sepse karakteret moralzhuur, i kanë klasifikuar veprat e tyre te autorët vdekatarë, pra dhe harresa është perdja e teatrit që mbyll skenën për dy orë. Kaq është mjaftueshëm për modën që s'duhet ndjekur të të mëdhenjëve ex mortum. Pra cila është moda sot, miku im? Jo thjeshtë letrare, se kjo shujtë s'të ngop më, ajo me kohë s'del as për zogjtë. Dy janë flatrat që të ngrej në lart: nuhatja për t'u kapur pas bishtit të ndonjë politikani me të ardhme, ose prirja prej batakuçi të tregut të parasë, pra të zuzarit të pazarit. I pari krijon modën politike, i dyti atë të parasë. Këto të dyja fshihen pas fushqetave qorre të librave bibël dhe shënohet me shumë përsëritje andej-këndej nga Kron Darkat e Ali Senjefët se fill prej këtu nis letërsia e re. Mjerë ai që s'ecën kësaj rruge!

Moda shqyen njëra-tjetrën derisa një mëngjes, prej tribunave të blera, djersin prej peshës së famës një djalosh me krehër në kokë që i lë vragë gjaku jaka e këmishës të mbërthyer keqas në qafë. Moda e tij zgjat sa një fill tymi letrash në fushën e marsit të partive, aq sa në zgjedhjet e reja fiton partia tjetër. Perëndon dhe ylli i jakës e ngrihet ai i veshjes sportive, që të merr më qafë me tekat bohemiane të një Bajroni të ri.

Kështu mik, në qoftë se ma vë veshin, Migjeni vdiq pa e parë librin në vitrinë. Rëndon ndodh që një e keqe të pasohet prej një të mire, po atij djaloshi të ri, si prej një mallkimi hyjnor, i erdhi veç ndëshkimi. Prej hidhërimit e dënimit kapital që ai e ndjeu t'i shqiptohet ndërsa mjekët flisnin latinisht e ai i kuptonte, andej matanë peshorja merrte përpjetë, pra, krejt jashtë vëmendjes së tij, ajo ngrihej lart e arrinte sferat ku ai prej kullës së babilonit kërkonte zotin. Dhe ky iu përgjigj me një gjest mirësie: i dha vuajtjen njeriut dhe gëzimin veprës së tij, atij filli të hollë libri që është bestselleri i të gjitha kohërave dhe besomë, i tillë ka për të qenë. Pse, ç'është poezia? Më e bukura, kreu i arteve, maja më e vështirë. Por ajo ka një zakon vulgar: lë çdo njeri t'i puthë dorën dhe t'i bëjë korte, aq sa trutharëve ju duket se e kanë kollaj për ta shtënë në dorë. Pse është neveritur poezia? Sepse atë e shkruan dhe Kron Darka. Lehtësisht e shtëna në dorë, dashnorja e gabuar e kujtdo. Dhe ç'të mbetet prej saj? Një mbresë fantazme. Hija të është dhënë, hija, por mendjefejtë s'e besojnë dhe korin grunajën e poezisë për bukën e famës. Të gjithë hanë prej saj dhe janë të pangopur, se ajo të mëshiron, po vetëm kaq. S'të jep talentin. Më thuaj, a shkruhet më Rezignata e Migjenit? Mos shpreha një definicion? Me mua do të qeshnin, se këta sojlitë e sotëm as që pyesin për Rezignatën, ngaqë ju është mbushur qypi se janë ndjekësit e modës. Cila është sot moda? Ja, ku erdhëm te fillimi. Shkojmë.

Mbylli derën e asaj kthine në cep të urës dhe më ndolli ta ndiqja. Më çoi te një njeri me peshore, që nxirrte bukën e gojës me të cofurit, që kërkonin pak shëndet dhe më të dhjamosurit, që donin të binin në peshë, pra peshonte vulgaritetin më të krupshëm të varavingës populllore.

E shikon këtë sagesë njeriu: i rëgjuar pothuajse, gati i verbër, pa gojë, torollak kur shqipton ndonje fjalë, njeri pa njeri, fle i mbuluar me gazeta, ja pra ky duhet të ishte moda. Më degjon? Moda. Po ai s'ka pasues, megjithëse ka botuar gjer tani tre vëllime me poezi që do t'ia kishte zili dhe Pesoa. Është mbuluar me heshtje. Krejt i papërfillur. Moda është dikush tjetër që luan me kartën e disidentit. Ç'bën ky për të tërhequr vëmendjen? Asgjë. Është makut pas qindarkës se do shtyjë ditën njëfarësoj si njeri i vdekshëm dhe të ketë një fije fuqi që të shkruajë kur i vjen. Ka gjë më dëshpëruese? U përpoqa njëherë që të merrte një çmim që kishte dhe një shpërblim të kripur, po çmimi ishte dhënë me kohë, shumë më herët se të çejej konkursi. Çmimet, mik, janë biznes. Fama gjithashtu. S'ka më famë për famë. A nxjerr para fama, dashnore, udhëtime, atëherë është famë. Kjo është murtaja. Dhe pasuesit si ajo hordhia e minjve kur marrin arratinë do ta ndjekë famëmbajtësin verbtazi krejt besnike në bindjen e vet sa, edhe nëse ai mbytet, të gjithë do të mbyten pas tij. Kjo është marrëzia

më e madhe. Po s'e kam dhe aq fjalën këtu, dëgjo ç'do ta pyes e si do të më përgjigjet.

Ku i ke librat?

I shita.

T'i blenë?

Të gjitha.

Pastaj?

Pastaj? I dogjën.

Ku e di ti?

Më sollën hirin.

Dhe ai plak me kapele feltri të ngrënë e të rrjepur, na tregoi një qese me hi.

O mik, m'u drejtua mua, ke dëgjuar një gjëmë të tillë? Ia kanë djegur librat që të mos krijohet moda e tij. Ndonëse, siç e thotë profeti, njeriut të letrave i jepet të drejtë vetëm pas vdekjes. Ja, po të them, ç'u bë me Frederikun, kur botoi librat e fundit me poezi, dy librat. Pothuajse asgjë. Atij s'i dhanë as pension që të rronte, të paktën. E flakën rrugëve ku zvarritej si një homles. Nuk e mbanin spitalet. Nuk e mbanin hotelet. Pothuajse të gjithë e harruan, ndonëse poezia e tij e rrallë, e kalibrit më sipëran europian, klithte nga libraritë. Po kush ia vinte veshin. Ai s'kishte fuqi të bëhej mode. Se që të bëhesh modë s'mjafton vetëm poezia. Ja, ky që sheh në trotuar, gati si një lypës, shkruan poezi si Pesoa, po aq i mahnitshëm është, po duhet të vdesë që dikush të kujtohet e të flasë për të. Ndoshta do t'i ngrënë dhe një monument diku dhe do të përpiqen të harrojnë njeriun, pikërisht këtë që shikon ti.

Ma jep mua atë qese me hi, i tha njeriut me peshore bukinisti i vjetër.

E ç'të duhet?

Unë jam bukinist dhe mbledh libra të rallë, ti e di. Ndoshta nesër shpiket një makinë që deshifron hirin dhe ti rizbulohesh. Prej hirit. Dhe të quajne poeti i hirit.

Merre, e ç'më duhet?

Faleminderit, poet!

S'ka përse! Po ndonjë lekë s'do të më japësh?

Bukinisti i dha një dhjetëshe dhe ai e mori dhe e mbylli në dorën e rreshkur, që s'të besohej se mund të shkruante poezi aq të bukura. I dhashë dhe unë ca para. I mbledhi dhe ato në grusht.

Faleminderit, zotërinj, sonte do të pi verë.

Erdhi dikush për t'u peshuar dhe ne bëmë tutje.

Poeti ka vdekur. U shkruan dy-tre artikujt e parë për të. Pastaj u bë bujë. Paskish jetuar një poet i madh, po askujt s'i kishte rënë në sy. Pas dy vjetësh u kthye në modë. Po ishte i paimitueshëm, siç jane poetët e vërtetë. Ata që ia dogjën librat, ia blenë qesen me hi dhe me këtë zbulim sensasioni i dhanë pak zulmë emrit të tyre të vdekur. Aradhat e djerrakohëve të shkrimit rrojnë njëfarësoj prej famës së idhullit të tyre, kur kanë ç'të tregojnë për të. U ngritën podiume të marrë hua nga partitë dhe u fol për poetin prej xhelatëve sikur të mos ishte ai viktimë e tyre. Ja, kështu rroj dhe unë, tha bukinisti, mbledha librat e tij, që i botova dikur prej mëshirës dhe tani i shes me një çmim të kripur. Dhe për fat kam të drejtën ekskluzive të botimit të librave të tij. Po a e dini që kam dhe peshoren? Këtë ma kërkojnë me një çmim fantastik, po s'e jap. Jo, nuk dua që ta lënë përsëri atje te trotuari si një lypës. Se këta ta bëjnë. Le ta hiperbolizojnë, ta mbulojnë me trëndafilë, ta lajnë me sapun Dove e ta veshin me kostum Calvin Klein, t'i rrëmojnë rrënjët gjenealogjike dhe ta gjejnë pinjoll në gjak me Bogdanin, më mirë kështu, sesa me lecka. Jo, nuk dua t'ua jap këtë mundësi ngushëllimi Kron Darkave, që ju sillen si dishepuj të përlulur kufomave të lavdishme, rrotullan si korba. Dhe prej zhurmës që krijojnë vetë e prej luftës mes vetit, më mirë i bëjnë qejfin një të vdekuri, që s'pi si ata, s'shkon me femra, s'mbush xhepat me para, pra nuk është gjallë, që t'u ngjallë zili, po aty poshtë nën dhe, i shkimë e i grimë prej krimbave e për pasojë fare pa drojë e pa zori nxitojnë ta shpallin si modë. Po, sot është moda e tij. Të gjithë i mahnit vetvetja duke folur për të. Kaq shumë janë kapur pas rastit të tij, sa e kanë kaluar masën. Dhe duke e kaluar masën po humbasin kohën për të shpikur një modë të re. Dhe kjo kohë është koha e tyre. Për këtë s'të falin. Unë rri dhe pres me zemër të ngrirë kur të dalë një Xhingiz Khan i ri që, bashkë me hordhinë e tij, do ta bëjë trokë e bokë emrin e poetit tonë që, tek e fundit, peshoren s'ia morën dot.

Shiu
I kushtohet Papa Gjon Palit II

- Shiu bie,
e na thonë, se Zot s'ka! –
tha një plakë e viseve tona,
teto Vara.
Ata që thanë se Zot nuk ka,
ndezin tash qirinj,
porosisin lutësorë,
u shmangen të pafeve.
Teto Vara rri shtrirë në varrezë,
e shiu bie,
i madh, pjellor, pajadâ,
bie e bie,
kujt në derë s'i troket.

Nga libri “Këngë të vjetra”

1. Fyerja

Ç'është me ty, moj fyerje e ligë?
Unë dremis e ti s'mbyll sy,
Unë hap sytë - ti zgjuar qëkur.
Dhe sytë m'i kall si një fallxhore.

Mos rreh t'më thuash kush më ka fyer?
S'ka të tillë, mbi ne të gjithë - veç Zoti
një.
Kujt i duhet - Ai ia jep vullnetin,
Kujt s'i duhet - ia merr.

Mos jeta nuk më deshi?
Ah, s'është e vërtetë: më do e i
dhimbsem,
më ruan në një vend të fshehtë
dhe më nxjerr, sapo të dojë
të më shohë, sikundër askush nuk di.

Ç'është me ty, fyerje e ligë
që para meje qëndron si një fallxhore?

Mos do të më thuash se kot po frymoj,
që fyej të sëmuret dhe fatkeqët?

2. Kali

Ecën udhëtari nëpër rrugën e errët,
ecën e ecën pa nguti.
- Pyetmë, gjogu im, çka do,
pyetmë çka të duash e unë të
përgjigjem.
Njerëzit kurrë nuk do të më dëgjojnë,
Edhe pa rrëfime Zoti di gjithçka.

Shumë, po shumë e çuditshme kjo
punë:
Përse vallë zjarri digjet në dritë,
përse mesnatës i trembemi
dhe ndodh ndokush i lumtur të jetë?

Avitu ti, o kohë përdëlllyese,
dehjen time rinore ktheje me fund,
hiqma thumbin e djalërisë
prej plagës së freskët përvëlimentare -
aherë më i mençur se të tjerët do të
jem!

Kali nuk flet, por përgjigjet;
zgjatet e zgjatet udhë e pamatë.
Dhe i lumtur askush s'do të jetë.
Por të palumtur, gjithashtu, mbeten
pak.

KËNGË TË VJETRA

Poezi nga Olga SJEDAKOVA (1949 -)

I përktheu nga origjinali: Agron TUFA



3. Fati

Kush vallë e diti ç'fat i ra për pjesë?
Ai ia qëllon - nuk e vëren.

Ndoshta dhe ti do të më kujtosh
kur për ty harruar do kem.

Dhe atëherë do të hyj pa ndjerë,
ashtu si të vdekurit vijnë tek të gjallët,
dhe do të të them se unë di diçka
që ti kurrë nuk ke për ta ditur.

Dhe mandej dorën ta puth
ashtu si skllavi zotnisë.

4. Fëmijëria

E kujtoj fëmijërinë e hershme
dhe gjumin ndër çarçafët e artë.

Shajni a e vërtetë të ketë qenë?
dikush më pikasi,
prej kopshti vrikthi mësyu
dhe u ndal buzagaz para meje.

- Bota, - më thotë, - është shkretëtirë.
Zemra e njeriut - është gur.
Njerëzit dashurojnë atë që s'e njohin

Por ti, mos më harro, Olga,
dhe unë kurrë s'të harroj.

5. Mëkati

Mund ta mashtrosh qiellin e lartë -
qielli i lartë nuk i sheh të gjitha.
Mund ta mashtrosh tokën e thellë -
toka e thellë fle dhe s'dëgjon.
Orakujt, fallxhorët dhe fallxhoret -
por vetveten dot s'e mashtrojnë.

O, nuk e duan njeriun mëkatar
pasqyrat, dhe qelqet, dhe ujët e malit:
Aty gjaku i huaj herë vrapon si era,
herë spërdridhet si gjarpën i sëmure:
- Nesër do të ngrihem i më herët,
do të shkojmë te fallxhorja me nam,
do t'i japim për mundin para,
që të na thotë
se asgjë nuk dallon.

7. Ngushëllimi

Mos qit fall për vetë vdekjen tënde,
as mos u gëzo që humbi gjithçka,
mos ço ndërmend si do të të qajnë,
si do t'i grijë ata keqardhja e vonë.

Ky është një ngushëllim i keq,
Një argëtim fyes për tokën.

Më mirë thuaj e mendo:
çfarë po lëbardh në atë mal të blertë?

Në malin e blertë kopshtijet lodrojnë
dhe gjer buzë ujërash mbërrijnë,
mu si qengjat me dajre të arta.
Qengjat e bardhë në malin e blertë.

E vdekja do vijë, pa pyetur askënd.

8. Grindja

A mos pak po gjalloj në këtë botë?
e tmerrshme ta thuash se sa.
E prapë kjo zemër nuk ma deshi veten.
Përpëlitet si një rob në qeli, -
e në prezore çfarë s'të shohin sytë!

Pati folë njëherë një plakë:
- Mirë e ngrohtë është në këtë botë të
Zotit.

Mu si bizelet brenda bishtajave
frymojmë ne në dorë të Perëndisë.
Dhe gjithkujt t'i lutesh - nuk kthehet.
Dhe çfarë të shestosh - s'e përmbush.
E t'i gëzohesh kësaj zemre,
mu sikur zogut në kafazin e shkruar
farëra t'ëmbra t'i kenë hedhur -
nuk është, aspak, dhuratë e kotë!

Tunda kokën, po me vete thashë:
- qepe ti, moj plakë e rrjedhur.
Gjithçka bën vaki, e vakia s'ka të sosur.

10. Fjala

Dhe ai që do të dojë, atë do ta duan,
ai që do shërbejë, atij do t'i shërbejnë -
jo tani, herëdokur, më vonë.

Po më i lumë ka me qenë i
falenderuari,
ai që pasi ka shërbyer, do të shkojë pa
Rakelën
zemërdlirë nëpër kodrat e blerta.

fjalë, o ti petk mbretëror,
fustan i shkurtër i durimit të gjatë -
më e lartë se qielli do të jesh,
më gaztare se dielli.

Sytë tanë nuk do t'i shohin
ngjyrat e të shtrenjtit tënd,
fëshfërimat e palave të tua të gjera
nuk do t'i ndjejë veshi i njeriut,

Vetëm zemra vetë vetes do t'i flasë:
- je e lirë dhe e lirë do të jesh,
para skllevërve s'ke asnjë borxh.

3. Gruaja e pabesë

Ç'prej asaj dite kur ktheve në shtëpi
dhe në sy nuk më sheh
brenda meje gjithçka u përmbys.

Mu si ai qeni i sëmurë
që ka tre ditë shtrirë, heq shpirt -
ashtu dhe shpirti im rënkton.

Mëkatarit gjithë bota i del krah,
e të pamëkatit - veçse mrekullia.
Mrekullinë paça dëshmitar!

Kallzoja, Zot, atij të vërtetën,
Kallzoma pafjninë time!

Atëherë qenushi, kjo kreatyrë e ngratë,
vrikthi shkundi kokën,
hareshëm asaj iu avit,
dorën ia lëpiu gjithë dhele
dhe ra përtokë i vdekur.

Di Zoti për njeriun
Çka mendja e robit s'e di.

Kishte gjithçka: nuk mundesh, nuk e pranon, nuk e duron, por hesht, përpinë – se je i turpëruar, i nxehur nga inati!
Por kur erdhi puna tek gjëja kryesore që ti je,
Ai që nuk doje të ishte – ti nuk ishte më.
(RADOVAN ZOGOVIQ: *GALILEANI NË SHTRATIN E VDEKJES*)

Kur vdes një poet i madh, poezitë e tij jehojnë nëpër univers. Ata e zëvendësojnë atë, i garantojnë jetëgjatësi. Poezia, nuk është e vdekshme!

Vdiq poeti i madh malazezo-boshnjak Marko Veshoviq. Një poet me dhunti të patejkalueshme, një njeri - shkëmb morali, një poet i Sarajevës së rrethuar, qytetit që për tre vjet e gjysmë e mbajtën të rrethuar formacionet e tërbuara të Karaxhiqit, duke mbjellë vdekjen në të gjitha anët, duke vlarë gra, fëmijë dhe pleq. Miliona predha mbi qytetin e pambrojtur. Enver Kazaz ka thënë: “Marko Veshoviq dikur ishte një ikonë e mbrojtjes së qytetit gjatë rrethimit të Sarajevës”. Nuk është e lehtë, por është një nder të jesh ikonë, veçanërisht në një qytet të rrethuar. Vetëm një njeri me moral të lartë, dhe një poet i madh, mund të ishte i tillë.


Veshoviq kishte mundësi për t’u larguar nga qyteti - por nuk dëshoi, qëndroi me bashkëqytetarët e tij, miqtë, studentët dhe nxënësit profesor i të cilët ishte. Ishte ky një akt tejet moral, i cili do të lartësonte *Shembujt e burrërisë dhe trimërisë* të Mark Milanit, një njeriu në të cilin kulmonte etika malazeze, nga koha kur epërsia e njerëzores arriti majat më të larta. Veshoviqi ishte një derdhje nga ai kallëp, një hero në një kohë joheroike.

Të jesh poet në një qytet të rrethuar do thoshte të ishte në ferr, si Dante (ndryshimi është se Dante i shihte imazhet e ferrit në imagjinatën e tij ndërsa Veshoviqi në realitetin e zhveshur!) për të kaluar nëpër të gjitha tmerret dhe tundimet, për të mbetur njeri. Vetëm një njeri i tillë dhe një poet i tillë mund të shkruante librin *Kalorësia e fushës*, një kronikë unike poetike për qytetin e rrethuar. I krijuar në një situatë pa rrugëdalje, ky libër u ngrit në lartësitë më të mëdha poetike dhe qiellore. Vuajtjet tokësore u pasqyruan në qiell dhe në këngë, kështu u krijua dorëshkrimi më autentik dhe më poetik njerëzor, i shkruar nga një dorë që nuk dridhej para vdekjes. Duke përshkruar vuajtjet njerëzore dhe vuajtjet e qytetit, Veshoviqi shkroi një libër që do të jetojë sa të jetë njeriu. Që do të mbrojë edhe Qytetin edhe Njeriun

Ferri i jetës lindi poezinë më të qëndrueshme se jeta. “Armiqtë tanë nuk i lidhë asgjë tjetër përveç dëshirës për të na shkatërruar,” shkruante poeti polak Zbignjev Herbert, duke përshkruar Varshavën e rrethuar. Marko Veshoviq e mbrojti Sarajevën me vargje, shembull që nuk është i njohur, duke besuar se ai dhe Sarajeva do të fitojnë.

Dhe ata fituan. Dashuria ishte e fortë! Ndërsa Kënga e pathyeshme!

Sa të jetojë ai qytet, do të jetojë



edhe poeti që me fjalë u ngrit kundër granatave. Fjala fitoi, dhe bashkë me të edhe poezia, fuqia më e madhe morale. Brodsky e vendosi etikën mbi estetikën. Varri i tij është tani në qytet. Ndërsa varri i poetit - fjalim, është rojtari më i besueshëm.

Qetësohu njeri krenar!

Tani në vend tëndin jeton poezia. Ndërkaq nuk ka dëshmitar më të besueshëm se poezia, e dije. Prandaj jetove për të, ishe i sigurt. Poezia është plaga jote më e madhe dhe mbrojtja jote.

Rozhdestvenski ka thënë: Poetët shpeshherë i vrasin për t’i cituar më pas! Shumë i cituar je këto ditë. Historia do të japë ty të drejtë, dhe jo atyre, që e rrënuan qytetin duke besuar se do ta fshinin nga faqja e dheut. Sarajeva ka një frymë, ka atë që nuk mund të vritet. Ti e ke identifikuar veten me Qytetin - *Kalorësia e fushës* frymon me shpirtin e tij. Prandaj është një libër i madh!

Ilustrimi më i mirë i jetës së Marko Veshoviqit do ishin vargjet e Radovan Zogoviqit, të cilat i mora për fillimin e tekstit. Veshoviqi shkroi një libër (disertacion doktorate!) *Gjuha në poezinë e Radovan Zogoviqit*. Një

libër i pavdekshëm - për një poet të pavdekshëm.

Që të dy malazezë, mbrojtën njëllor, Zogoviqi shqiptarët në *Ali Binaku*, Veshoviqi boshnjakët në *Kalorësia e fushës*. Historia u tha atyre: PO! Ndërsa njerëzit i admirojnë dhe do t’i admirojnë! Të gjithë njerëzit qëllimshëm. Manifestet e përgjeshme dhe të pathyeshme poetike e njerëzore të të gjithë të kërcënuarve dhe të sulmuarve.

Dhe tani, ajo e domosdoshmja - që duhet ta shkruaj.

Një herë Mihaillo Llalliq më pat thënë në shtëpinë e tij në Herceg Novi, në shëtitoren Pet Danica: *Sot ka shumë poetë, Marko Veshoviqi është më i talentuari*. E kam mbajtur mend atë fjali, e cila nuk arriti kurrë tek Marko (Markon nuk e kam takuar kurrë, nuk kam pasur mundësi t’ia përcillja!) dhe e ndjej detyrimin ta shkruaj. Sepse e tha Llalliqi. Ishte kjo diku në fillim të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar. Fjalët e Llalliqit Veshoviq i konfirmoi me veprën e tij. Çfarë do ishte letërsia malazeze pa Llalliqin, Zogoviqin dhe Veshoviqin?

Si do dukej ajo!?

Herceg Novi, gusht 2023

Agimi

Qëndroj në roje. Në agim. Pranë është shtëpia.
Në fakt, një barakë e verdhë. Pranë saj një plep
Përmbi pus. Plepi është i gjatë, për një arsyë
Më duket, po aq sa është pusi i thellë. Mbi shtëpi, si mbi Itakë, mbështillet Tym i bardhë, ngjashëm me ndrizë fëmije.

Në shtëpi qan fëmija. Gjatë. Prej vitesh. Duket: kasollja do shembej nëse fëmija do heshte.
Në roje, njeriu mund t’mendojë gjithçka.

Papritur, nga shtëpia del një vajzë kokëartë,
Dhjetë, më së shumti dymbëdhjetë vjeç. Pa këmbë.
Një invalid mahnitës. Engjëllushë me paterica.
E në fytyrën e saj një skuqje. Si nga agimi. E mua
Më rrodhën lotët. Nga skuqja në fytyrën e saj.
Nga ai agim me paterica! Në roje, njeriun
Mund ta kaplojë çdo gjë.

Dhe e qara e fëmijës nuk ndalet.
Thuajse ka Elektromotor të veçantë. Klithmë që, më duket,
Nuk ka ndërmend të ndalet sa të jetë jeta. Gjersa të ketë
Shpirtra të gjallë nën këto qiej. Vaji që do kumbojë
Nëpër të gjitha amshimet.

Sepse koha, në roje, është e ngadaltë si një akullnajë.
Në roje shpirti, ndonjëherë, dëgjon trokëllimën e tatarëve
Që sjellin lajmin se, nën këtë qiell, Nuk ka asgjë. Madje as ti s’je. Në roje.

Ka vetëm tym. Jo nga ai mbi Itakën. Por ai nga fjalja, e shkruar në etruskisht -
E para që shkenca arriti ta deshifrojë: “Njeriu është vetëm tym”.

Nënshkrimi

Vrapoj në shtëpi me vogëlushen time - Granatat, përsëri, na befasuan në rrugë. Granatat, me shekuj, bien për çdo ditë, Dhe çdo herë befasishëm.
E nxitoj me një zhurmë të zemëruar: Tërbimin nga gjuajtësit serbë
Po e përcjell te fëmija prej dhjetë vitesh pritur.
Të firmos, më thotë, ndërsa kalojmë Pranë shtresës së borës, të paprekur, në park.
Në vend që ta qortoj,
E lejova - kush e di pse - që gishti i saj tregues
Atë bardhësi delikate të prekë
Dhe pastaj rreth IVANA VESHOVIQ cirilike
Gishti im tregues përshkroi rrethin E padepërtueshme

Si në përralla.

Këto krisma

Këto të shtëna në gjak na kanë hyrë. Pa të shtëna (si pa kafe në mëngjes) nuk mund të

esëllohem.
Por a të kujtohet, nga fillimi i luftës, si pas shpërthimit të granatës, krijohet mes nesh një heshtje ngjashëm me atë heshtjen e varrit që do krijohet kur dikush, në tavernë, diçka kundër Titos apo Partisë?

Tani predhat në kocka na hynë. Kur është heshtje, je i shtrënguar si telat. Gjithmonë ke në mendje: Zot, çfarë po na përgatisin tani? Me atë heshtje edhe më shumë na fusin frikën në kocka. Dhe sapo të dëgjohet mitralozi, unë menjëherë lirohem, gruaja fillon të shlirohet, fëmijët të kakarisin nëpër shtëpi. Përsëri të shtëna, do thotë, përsëri gjithçka është në rregull. Dje, u ktheva nga puna dhe pyes: a ka pasur të shtëna kur unë nuk isha? Vajza më e vogël më thotë: oh, ta dish, babi, *sa bukur fërshëllyen dy sosh.*

Në mbrëmje shtrihesh në shtrat

dhe ti e di që kot shtrihesh: nesër do ngrihesh më i rraskapitur sesa kur u shtrive. Në mëngjes ngrihesh nga shtrati dhe e di se kot ngrihesh: dita e djeshme të pret, me streset e djeshme. Me poshtërimet e pardjeshme. Me dëshpërimin e tejpardjeshme. Ky rrethim nuk zgjat dy vjet, por një javë, e cila nuk ka fund.

Nga kjo, më duket, vetëm deti mund të më pushojë. Por kush e di nëse do e shohim më ndonjëherë? A do qëndroj përsëri mbi shkëmbinjtë ku rrymat e ajrit janë aq të forta sa që kësula e hedhur të kthehet pas?

Por nuk kam mall, këtë herë, për detin me gjethet e trasha të agavave ku janë të gdhendur emra dashurie. Për ullinjtë e përdredhur me ngërç si laokonë të gjelbër. Për kapelat e Meduzave që duken si një ombrellë mëndafshi nga përrallat lindore. Nuk kam mall për bukurinë monotone të dallgëve që poeti krahason me metrikën e Homerit. Nuk kam mall për atë bojën me të cilat mund të shkruhen miliarda dhe miliarda *Iliada* dhe *Odise*.

Unë kam mall për atë trishtim që të pushton duke ngulur sytë në blunë e përjetshme dëgjuar në murmuritjen e asaj përjetësie. Për trishtimin që të thotë se sërish ke shpirt. Jo mbase as për trishtimin. Por kam mall për të bukurën zbrazëtiirë të melhemtë.

Të zhytësh shpirtin në boshllëkun që preh. Shëron. Përtërinë. Të shikosh me orë, as në det të hapur, as mbi det të hapur, por - ashtu!

Boshnjakisht. Derisa të harrosh se çfarë je dhe ku je dhe nga je dhe si e ke emrin. Vetëm e di se brenda teje janë - milje e milje zbrazëti. Dhe se pafundësia e detit ka thith nga ti të gjitha shekujt, gjer te Adami. Boshllëku përhimë shpërtheu gjer në fund të botës dhe, anasjelltas, gjer në fillin e saj. Dhe sheh. Po çfarë - sheh? E ndjen në qiellzë: çfarë gëzimi do mbizotërojë pas Ditës së Gjykimit! Gjithçka do fshihet, si nga dërrasë e zezë shkollore shkarravitjet fëmijërore, e ëmbëlsia e pastër do mbetet! Dhe e shijoni që më parë, të paktën me një lugë kafeje, lumturinë në të cilën bota do shpërthejë!

Bluzë femre

Errësohet. E në perëndim, këmbë e diku shlyu qypin me verë që u derdh horizontit. Një hënë e re si brirë nga një përkrenare në të cilën, në filma, paraqesin Moisiun. Mban erë pishe në një përzierje limoni dhe temjani.

Në roje një luftëtar, i gjatë, dhe i brishtë si një kashtë thekre. I brishtë nga rinia dhe dashuria. Nxjerr nga gjiri

një bluzë të bardhë femre. Dhe fytyrën zhytë në të. Gjatë, gjatë, thith aromën e saj. Ato pesë-gjashtë gram tekstil mund t'i tërheqë nëpër unazën e martesës.

Një pamje, e pashprehur në mënyrë hyjnore. Të thuhej me fjalë do ishte sikur pesha e rrezeve të diellit në peshore të matej.

Papritur, nga e gjitha, nga perëndimi i verët, nga hëna e re me brirë, nga bluzë e femrës nëpër aromën e së cilës, si nëpërfije, del nga ferri - përnjëherë, nga e gjithë kjo, e pata më lehtë në shpirt. Dhe më lehtë në këtë botë.

Gjithnjë e di në tokë që ekziston lufta si lëmsh i zi. Por me të shpirti do luante si një kotele. Se vdekja vazhdon të shikohet përmes gjithçkaje. Jo si një kafkë e ngritur përmes lëkurës së fytyrës. Por si fara përmes një kokrrë rrushi: e bën më magjik.

Kur snajperisti serb

qëlloi fëmijën e mikes sime në krah - pushova të besoj në zot. Ti nuk ekziston, o zot thashë, je i shlyer përgjithmonë

dhe pikë. Sepse Zoti që lejon që fëmijët nënave në kraharor t’iu vrasin ashtu, kot, thjeshtë për qejf një zot i tillë mua s’më duhet E të tjerët - si të duan. Përndryshe, para luftës mendoja se qiejt do binin mbi mua po të hiqja dorë nga besimi në zot. Por ja, nuk ndodhi asgjë. Asnjë tjegull nuk u thye në çatinë e shtëpisë sime Unë jam ende unë. Sarajeva ende Sarajevë Qielli ende qiell. Dhe ja qëndron aty ku ishte edhe më parë Edhe pse zot nuk ka. Po them, nuk ekziston për mua E të tjerët - si të duan. Gjithçka rrokulliset sipas adetit të moçëm. Madje më duket se më lehtë e kam Kështu, pa zot. Nuk mundem, kam frikë, ta shpjegoj këtë siç duhet. E di, ecet më lehtë pa asgjë në duar, se kur tërheq një shportë Po, Mirë e thash. Pa zot, disi është më e lehtë të ecësh nëpër këtë jetë gungaçe. Vetëm, në çdo çast e ndjej se duart i kam bosh. Bosh, dhe për këtë të rënda.

(Nga libri KALORËSIA E FUSHËS)



BIOGRAFIA

Vdiq në Sarajevë në moshën 78-vjeçare shkrimtari, kritiku letrar, eseisti dhe përkthyesi i shquar malazez dhe boshnjak Marko Veshoviq. Veshoviq ka lindur në vitin 1945 në fshatin Pape afër Bijelo Poles. Gjimnazin e kreu në Bijelo Pole, ndërsa Fakultetin Filozofik në Sarajevë. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Filologjik në Beograd, ndërsa punoi si mësimsdhënës në Shkollën e Mesme të Komunikacionit në Sarajevë dhe në gjimnazin “Pero Kosoriq”. Për rreth dhjetë vjet Veshoviq ishte profesor në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, dhe për disa vite edhe redaktor në shtëpinë botuese “Veselin Maslesha”. Në Fakultetin Filozofik u kthye në vitin 1992. Një dekadë më vonë, mbrojti disertacionin e doktoratës

“Gjuha në poezinë e Radovan Zogoviqit” në fakultetin amë në kryeqytetin e Bosnjë e Hercegovinës. Ishte një kritik konsekuent i turbulencave shoqërore-politike në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Pikërisht tre dekada më parë ai ngriti zërin kundër luftës në ish-Jugosllavi, duke u bërë thirrje njerëzve që të vijnë në vete. Mirëpo, thaujse askush nuk i dëgjo i thirrjet e shkrimtarit Marko Veshoviq. Ai do mbahet mend edhe si një kronist i guximshëm i rrethimit të Sarajevës në vitet 1992/95. Veshoviq botoi më shumë se 30 libra me poezi dhe prozë, përkthime me poezi, ese dhe polemika. Disa nga veprat e Veshoviqit me të cilat do të mbahet mend janë “Kalorësia e fushës”, “E diela”, “Observatori”, “Paraardhësi”, “Gjeniu i katërt”, “Vdekja është një mjeshtër nga Serbia”, “Mbreti dhe rrënoja”. “Veçanërisht domethënëse është

vepra e tij e prozës së luftës “Vdekja është një mjeshtër nga Serbia”(1994), në të cilën ai përshkruan edhe përvojat e tij të paraluftës me Radovan Karaxhiqin, dikur një kolegë i tij, poet. Marko Veshoviq ka doktoruar për poezinë e Radovan Zogoviqit. Fitoi çmimin “Ratkoviq” në vitin 2008, për koleksionin “Ndarja nga Arencana”, por nuk pranoi ta merrte, duke theksuar se ky çmim, duke iu dorëzua Radovan Karaxhiqit në fillim të viteve 1990, ishte “njollosur” përgjithmonë. Ishte kolumnist në disa gazeta malazeze dhe boshnjake. Në një periudhë ai ishte edhe anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Federatës së Bosnjë e Hercegovinës, ku u zgjodh si kandidat i Partisë për Bosnjë e Hercegovinë. Marko Veshoviq u varros në Sarajevë, më 21 gusht.

I

Jam i sigurt se që në verën e 1957-ës kur Gaston Springeri u shndërrua në të pabesueshmin Sringer.

Asokohe Punta del Este ishte një vend shumë i ndryshëm nga ç'është tani. Unë isha dymbëdhjetë vjeç, dhe atë verë kisha dalë nga shkolla dhe ndihesha si pronari i padiskutueshëm i gjithçkaje që më rrethonte. Hapësira ku dallgët thyheshin dhe zhbëheshin në breg, cektinat, pyjet me pisha, rrugët e vjetra me zhur të pushtuara nga degët dhe me fole të stërmëdha dhe të vjetra milingonash në të dyja anët; të gjitha këto ishin të miat. Dhe askush rreth e rrotull. Nuk kishte asnjë që të ndalonte dhe ta drejtonte gishtin nga njëra anë dhe pastaj nga tjetra dhe të më thoshte se të gjitha këto i përkisnin atij. Jo. Unë ecja dhe ecja dhe në asnjë çast askush nuk vinte drejt meje për të më detyruar të ikja. Një herë, për shembull, isha futur në klubin e golfit në mes të natës. Do të rrija për të gjuajtur ndonjë nuselale, apo ndoshta duke bërë një shëtitje, vetëm për të qëndruar natën larg shtëpisë dhe asgjë më tepër. Bënte pak vapë; unë isha zbathur dhe ndieja në shputat e këmbëve freskinë e kullotës. Nuk dukej pothuajse asgjë, por në njëfarë çasti, nga siluetat e disa pemëve në mes të një *fairway-i*, doli një siluetë tjetër që m'u afrua si të kishte tashmë një copë herë që po ecte me mua.

- Mirë... - më tha.

Do të ishte një përshëndetje normale, nëse do të ishte ditë dhe do të ishim në rrugë. Unë iu përgjigja dhe atëherë vazhdoi të fliste:

- A mund ta dimë se ç'po bën këtej në këtë orë? Kjo është pronë private, e dinit?

Mendova se burri do të më jepte një dru të mirë aty në vend. Megjithatë nuk ndodhi shumë më tepër se kaq. Ndezi një puro dhe ma ofroi pastaj që ta tymosja. I thashë se jo, se nuk tymosja, dhe më pyeti se nga isha dhe se kush ishte babai im. Iu përgjigja se isha i lagjes, prej aty pranë, dhe i thashë se si quhej im atë. Tim atë e njihnin të gjithë.

- Ai është babai yt?...

- Po...

Vazhduam të ecnim, dhe kur mbërritëm rrëzë një pjerrësire ku fillonte një *tee*, burri u nda dhe më paralajmëroi që të mos bëja ndonjë dëm. Pastaj u zhduk nga ndonjë anë e natës.

Tani nuk është kështu. Dëgjova se rojat e natës, nëse shohin që lëviz diçka, në fillim shtien lart dhe pastaj hyjnë të të marrin në shenjë. Por kjo është diçka e kuptueshme, sepse gjërat tashmë kanë pronar, dhe për të gjithë është e rëndësishme që të kenë pronar. Kjo është çështja.

Tim atë, siç thashë, e njihnin pothuajse të gjithë në Punta del Este dhe, nëse e njihnin atë, me siguri më njihnin edhe mua, sepse kur ai dilte për të shpërndarë peshk nëpër gadishull, dhe sidomos nëse bënte kohë e mirë, hipja në pjesën e pasme të biçikletës. Unë kapesha fort pas belit të tij dhe i hapja mirë këmbët sepse e kisha tmerr që këmbët të më futeshin midis telave të rrotës. Një herë, kur dola nga shkolla, pak blloqe ndërtesash më larg, pashë një grumbull njerëzish rreth një biçiklete. Një vajze të vogël i kishte ngecur këmba në rrotën e pasme dhe askush nuk guxonte ta prekte. Po prisnin që një fqinj të vinte me një pincë për të prerë telat. Ndërkohë vajza qante, e ëma qante; pothuajse të gjithë ata që ndodheshin aty bërtisnin të dëshpëruar. Sakaq fqinji nuk po vinte me pincën. Një tjetër afrohej dhe përpiquej t'i këpuste telat me duar, por vajza e vogël ndiente tryshninë dhe bërtiste më shumë. Kishte gjak në këmbën e vogël dhe pak në rrugë. Ishte gjëja e fundit që arrita të shihja, sepse nëna ime më tërhoqi për krahu dhe më detyroi të vazhdoja rrugën. Ndaj më pas, kur im atë më merrte të ulur në skarën mbrapa, unë

Fragment nga romani, Ombra GVG 2023

I PABESUESHMI SPRINGER

Damian Gonzalez Bertolino

Përktheu Adrian Beshaj

i hapja këmbët sa më shumë të mundesha dhe nuk më interesonte nëse më pas kisha dhimbje në rrëzë të kofshëve. Kur im atë e vinte re, ndalonte së pedaluari dhe kthente kokën një sekondë për të më bërtitur:

- Mos e ekzagjero!...

Ose:

- Rri ulur si njeri sepse do të ngecim pas ndonjë gjëje për fajin tënd!...

Im atë ishte një burrë që mund ta merrje për çfarëdolloj gjëje, përveçse për të pashqetësuar. Lëvizte midis njerëzve pothuajse me mospërfillje të plotë, e megjithatë ishte i sigurt për çdo gjë që ndodhte rreth tij. Ishte i hollë dhe i gjatë, dhe ecte kaq drejt sa gjithnjë ishte dikush që ndalonte për ta parë të kalonte. Ishte tip i veçantë. Siç thashë, kishte një pamje të patrazuar që vihej re në secilin prej gjesteve të tij. Ky ishte natyrisht qëndrimi i tij kur më fliste në biçikletë, por thjesht sepse atij i dukej se kishte gjëra që nuk

mund të ndodhnin kurrë. Si fakti që unë të fusja këmbët në rrotën e pasme. Që nga vendi im në biçikletë vëzhgoja figurën e tij të dobët dhe të drejtë që priste ajrin e mëngjesit, duke çuar para njërën sup dhe menjëherë tjetrin në përpjekjen që bënte për të pedeluar në një të përpjetë. Herë pas here unë rrija i përqendruar duke parë se si rritej në shpinën e tij njolla e djersës që e errësonte pak këmbët. Pa parë anash, unë ndonjëherë e dija se ku ndodheshim: vetëm nga madhësia e njollës. Si atëherë kur mbërrinim në shtëpinë e Springerëve. Njolla ishte e madhe, por i mbetej edhe pak që të arrinte te supet. Ishte pothuajse fundi i rrugës, sepse nëse babai duhej t'u çonte peshkun Springerëve, e linte pothuajse të fundit.

Springeri ishte një burrë trupmadh. Herën e parë që e pashë po rrinte në tremenë prej druri, me këmbët të kryqëzuara dhe të mbështetura mbi parmak dhe duke



lexuar gazetën. E kishte këmbishën të hapur përgjysmë, dhe gjëja e parë që më tërhoqi vëmendjen ishte një sasi e madhe qimesh të verdha në gjoks. Dukej si diçka e bërë me qëllim. Asaj here, Springeri u ngrit, hoqi syzet dhe i bëri një shenjë të shpejtë tim eti duke e mbajtur dorën lart. Pastaj u fut brenda në shtëpi dhe tha diçka me zë të lartë. Atëherë doli një grua e bukur. Ishte e rrumbullakët ngado që ta shikoje, dhe mbi gjithçka kishte flokët e mbledhur si në një kon të vogël. Kaçurrelat e zeza dhe të gjata i binin mbi faqet e mbushura me preka. Vështroi tim atë dhe qeshi duke hapur sytë e mëdhenj të gjelbër dhe të tejdukshëm.

- Peshk, zotëria!... - bërtiti, dhe hyri në shtëpi për të kërkuar paratë.

Menjëherë zbritën nga shkallët dy fëmijë flokëverdhtë të veshur vetëm me pantallona të shkurtra. Njëri duhej të ishte dhjetë ose njëmbëdhjetë vjeç; tjetri kishte moshën time, gjashtë vjeç. Ai ishte Gastoni.

Springerët ishin francezë dhe kishin ardhur në Punta del Este disa muaj para se nazistët të hynin në Paris. Besoj se kurrë nuk e mora vesh mirë se çfarë ishte apo ç'gjëje i kushtohej Springeri. E dija që kishte para, sa madje kishte mundësi të shkonte në klubin e golfit fundjavave dhe të lexonte qetësisht gazetën para se të hante drekë dhe më pas të merrte një sy gjumë. Herë pas here mësoja nga im atë se kishte blerë disa prona dhe se ia kishte shitur për shumë më tepër para një të huaji tjetër. Por nuk munda dot kurrë të mësoja diçka më shumë se kaq.

Po vazhdoj. Gruaja bënte rrëmujë në koshin e biçikletës në përpjekje për të zgjedhur një peshk të mirë, duke ndarë letrën që mbetej e ngjitur pas luspave nga shkrija e kallëpeve të akullit. Springeri ndize një cigare të gjatë dhe të zezë, i ofronte tim eti një tjetër dhe zinin të flisnin për ndryshimin e erës apo të baticës. Fëmija më i madh shikonte nga gjiri dhe hynte përsëri në shtëpi. Ndërsa ndodhnin të gjitha këto, fëmija tjetër zbriti shkallët e tremesë, m'u afrua dhe më bëri një shenjë me dorë që ta ndiqja pas. Aty, në kopshtin që mbetej midis tremesë dhe trotuarit, ishte një gropë sa një top futbollit. Në fillim e pata të vështirë të arrija të shihja diçka brenda saj, por një çast më pas po nëpërsihja format e një kafshe që dukej sikur ishte bërë me karton.

- Breshkë... - tha fëmija.

Nuk kisha parë kurrë më parë një breshkë toke, të vetmet që njihja deri në atë ditë ishin të gjitha breshka uji të ëmbël, ca breshka me qafë të gjatë dhe lëkurë të shndritshme të gjelbër që im atë nxirrte me një kallam peshkimi ndërsa fillonte të shante. Breshka e Springerëve më la pa fjalë. Kur u afrua kishte zgjatur pak kokën si të priste diçka për të ngrënë dhe drita e diellit e goditi drejt e mbi kokë. Hapi dhe mbylli sytë



nja dy herë me ngadalësi dhe pastaj qëndroi e qetë, pa bërë asgjë. Koka kishte mbetur pezull mbi errësirën e gropës dhe unë nuk ia ndava sytë derisa im atë më thirri dhe më detyroi të hipja në biçikletë. Por kjo nuk ishte e gjitha. Kur po ktheheshim në rrugë, breshka doli nga strofulli i saj. Aty vura re se ishte një kafshë e stërmadhe. Madje edhe im atë u habit pak. Atëherë fëmija u spraps drejt shkallëve të hyrjes dhe Springeri filloi të qeshte në një mënyrë të pazakontë, njësoj sikur gjithçka të kishte qenë një shpikje e tija. Kishte marrë gazetën dhe po i afrohej kolltukut të tij kur na tha:

- Ajo ishte e tim eti kur isha djalë. Do të jetë një breshkë gjigante... dhe kur unë të vdes ajo do të jetë gjallë...

E thoshte këtë dhe vazhdonte të qeshte. Derisa arriti ta bënte edhe tim atë të vinte pak buzën në gaz. Këto ishin gjëra njerëzish të rritur. Mua më mbeti mendja vetëm te fjala gjigant. Nuk e di nëse e kisha dëgjuar më parë, por asaj here fjala mbeti duke punuar vetë në një vend të mendjes sime. Të gjithë kemi një çast në jetë kur dëgjojmë një fjalë për herë të parë, dhe ajo fjalë ka gjithnjë, nga ana tjetër, një histori. Përgjithësisht ajo histori rrjedh në fëmijëri. Në rastin tim ishte fillimi i fjalës gjigant. Donte të thoshte të kujtoja atë fjalë dhe të shihja menjëherë breshkën duke braktisur strofullin e saj për të përshkuar kopshtin nën diellin e asaj vere, si të kishte qenë gjithë ajo kohë pjesë e diçkaje tjetër më të madhe dhe papritur të shkëputej për të jetuar një jetë të pavarur. Diçka e tillë.

Dhe ajo ishte në vetvete çka ndodhi herën që njoha Gastonin, të cilin të gjithë do ta thërrisnim “i pabesueshmi Springer”. Ndonëse për këtë do të duheshin edhe disa ditë.

Kur erdhi nata i kërkova tim eti që të nesërmen të më çonte një copë herë në shtëpinë e Springerëve. Nuk dinte ç’të më përgjigjej. Im atë nuk kishte aq afritet me Springerët sa t’u kërkonte diçka të tillë. Ai ishte njëri prej klientëve të tij, por ishte gjithashtu i sigurt se unë isha një barrë një verë. Nëna ime nuk mund të merrej me mua. Ishte kuzhinieri në një *bungalow*¹ dhe ishte gjithë ditën duke shkuar e duke ardhur. Im atë kishte punën e peshkimit në mëngjes dhe klubin e golfit pasdite, kështu që ai mund të merrej me mua gjatë fillimit të ditës, por në orët e para të pasdites duhej të më çonte në shtëpinë e nënës së tij. Për mua nuk ishte zbatimëse të rrija me gjyshen. Duhej të qëndroja me të duke duruar gjatë gjithë kohës nxehësinë që zbriste nga tavani dhe duke e vështruar të ulur në një kolltuk të vjetër me një mace në prehër. Sapo dilnim në trotuar kur vinte ora e muzgut dhe ajo nxirrte një karrige për të pirë *mate-n*. Por në atë çast mërzhitesha edhe më shumë, sepse vinin gra të tjera të ngjashme. Atëherë, në çastet e para të natës, shihja një hije që zbriste nëpër të tatëpjetë dhe kuptoja se ishte im atë me biçikletën e tij. Nuk e di nëse ishte dëshpërimi apo thjesht rastësi, por unë nuk gaboja kurrë. Im atë shfaqej në çastin më të keq, kur gratë fillonin të flisnin me zë më të lartë sepse nuk kishte më dritë. Njëra gjë nuk kishte të bënte fare me tjetrën; megjithatë, kështu ishte.

Të nesërmen shkuan deri te ajo shtëpi edhe një herë tjetër dhe im atë më la në trotuar që të shkoja të trokisja në derë. E hapì gruaja e Springerit. Që nga vendi ku ndodhesha mund të shihja gjestet që bënin ata të dy për t’u marrë vesh. Në fillim më shikonte njëri, pastaj më shikonte tjetrit, dhe do të vazhdonin kështu gjithë mëngjesin nëse nuk do të dilte vetë Springeri për të ndihmuar në përmbledhjen e të gjithë çështjes. Një çast më pas gruaja më buzëqeshte dhe im atë më bënte shenja që të afrohesha.

DEBATI PËR PËRKTHIMIN E POEZISË

ARTI I PËRKTHIMIT TË POEZISË

nga Thea Voutiritsas



Në poezi, ritmi, stili, zgjedhja e fjalës nu frymojnë jetë ndjenjave dhe ideve të shkrimtarit. Atëherë, pra, a mund të përkthehen poezitë? Çfarë ndodh kur një poezi i nënshtrohet një grupi të ri tingujsh, një alfabeti të ri, apo një ndryshimi të lehtë në zgjedhjen e fjalës? Çfarë, nëse diçka, humbet në përkthim?

Linguistika dhe letërsia krahasuese prej kohësh përpiqen t’u përgjigjen këtyre pyetjeve. Përkthimi fjalë për fjalë i një tekst mund të të shpjerë te një gjuhë e panatyrshme apo e zbrazët, apo, madje, mund ta lërë lexuesin në padijen e idiomave apo thjeshtligjërimit që nuk përkthehen mirë.

Ndërkohë, të provosh të përkthesh thelbin apo kuptimin e një poezie, pa marrë parasysh metrin, ritmin, dhe zgjedhjen e fjalëve, mund t’i përafroresh përkthimit të një poezie krejtësisht të re, me pak bazë te origjinali. Megjithëse kjo nuk është kundër asnjë ligji, disa argumentojnë se ky nuk quhet një përkthim i vërtetë.

Në përpjekje për të kapur edhe kuptimin edhe formën e poezisë, përkthyesit duhet të ruajnë ekuilibrin mes të qenurit besnik ndaj tekstit dhe transformimit të tij. Është një art i kujdesshëm që ka nevojë për shumë kërkime, praktikë dhe ndërgjegje. Ky akt balancues demonstron mirë në një episod të RadioLab të titulluar “100 Flowers” (“100 Lulet”). RadioLab fton në një intervistë Douglas Hofstadter, profesor i shkencave konjitive dhe letërsisë krahasuese, teksa diskuton përpjekjet e tij për të përkthyer poezinë “A Une Damoiselle Malade” (Për një zonjushë të sëmurë) nga Clement Marot. Me fjalë të thjeshta, poezia shpreh

dëshirën që të shërohet sa më shpejt një vajze të re e sëmurë. Hofstadter u mundua të kapte tonin e dashamirës e gazmor të poezisë, duke i ruajtur formën – të cilën ai besonte se ishte thelbësore. Donte të ruante poezinë me varg trirroksh, gjithsejt 28 vargje, dhe skemën e rimës AABCCDD, e cila mbahet mend.

Sidoqoftë, iu desh që për të respektuar këto kufizime, të bënte disa lëshime me tekstin. Diku, Hofstadter zëvendëson shprehjen franceze “confitures” (reçel) me termin “bukë me gjalpë”. Ai thotë, “reçeli dhe peltja, janë fjalë, por fjalët përfaqësojnë koncepte dhe këto koncepte kanë në vetvete një lloj aureole rreth tyre”. I pakënaqur me përkthimin e tij, profesori ua dërgoi këtë poezi dhe kufizimet e saj, rreth 60 njerëzve të tjerë për ta përkthyer, mes tyre kolegë, studentë doktrature, miq dhe pjesëtarë familjeje. Projekti u bë një libër 700-faqësh mbi përkthimin e një poezie të vetme franceze!

Një prej interpretimeve më të parapëlqyera i erdhi nga mamaja e tij, e cila i hodhi tutje kufizimet. “Më duhet të them se kjo poezi i ka qëndruar testit të kohës; ka një lloj shkëlqimi që nuk gjendet tek asnjëra”. Por vetëm me gjysmat e vargjeve të poezisë origjinale, a mund të quhej përkthim interpretimi i saj?

“Teksa u përshiva gjithnjë e më thellë te kjo poezi, filozofia ime u bë si deklarata e Maos, “Le të lulëzojnë njëqind lule”. Me fjalë të tjera, mund ta shikosh nga kaq shumë kënde, dhe secili kënd i ri e pasuron dhe e bën më argëtuese”, tha Hofstadter.

“Megjithëse përkthimet që kemi dëgjuar ishin të gjitha të ndryshme, të

gjitha tregojnë diçka për Clement Marot”, tha ai. “Janë miliona gjëra të ndryshme që unifikohen nga një analogji, në diçka që i referohemi sikur të ishte e vetja gjë”.

Përkthyesi letrar Aaron Coleman është shprehur: “I qasem përkthimit edhe duke e ditur se nuk mund të jetë tamam siç është në origjinal... Mendoj se të gjithë duam që përkthimi të funksionojë si një proces riprodhimi, por në të vërtetë është një proces transformimi”.

Poeti fitues i shumë çmimeve dhe përkthyes nga italishtja në anglisht, Geoffrey Brock, e ka kapur në mënyrë elokuate filozofinë e përkthimit kur thotë:

“Një përkthim i mirë duhet të marrë frymë vetë dhe të mos ketë nevojë për tekstin origjinal sikur ky të jetë një makineri zemre e mushkërie. Dhe sërisht duhet të gjejë mënyra që t’u japë shprehi tipareve më të rëndësishme (si formale edhe semantike) të tekstit origjinal. E gjitha kjo është pjesë e asaj që mund të quhet besnikëri, e cila shpesh ngatërrohet me saktësinë letrare. Pedantët duan të tregojnë se përkthimi i përsosur është i pamundur. Sigurisht, kështu është – sikundër është dhe çdo gjë tjetër që ia vlen të bëhet”.

Në një intervistë me “The Creative Independent”, përkthyesja letrare nga frëngjishtja në anglisht, Emma Ramadan, ndan filozofinë e saj: “Përkthimi, për mua, u duk si një mënyrë e shkëlqyer për t’u marrë me letërsinë, një mënyrë që të jep kënaqësi dhe që nuk duket sikur po të vret magjinë e letërsisë, por përkundrazi po i jep më shumë jetë asaj”.

Emma Ramadan gjithashtu prek debatin për ndërveprimin midis huazimeve vs gjuhës amtare? A duhet që konteksti dhe referencat kulturore të poezisë të ndryshohen që të jenë më të lehta për audiencën e re? “Nuk mendoj se njerëzit po e bëjnë më këtë, ose të paktën kjo po ndodh më pak,” tha ajo. “Dhe tani kemi fusnota, kemi fjalorthë, kemi këtë, kemi atë. Por është edhe çështja se si të jemi bujarë me lexuesin dhe gjithashtu bujarë edhe me kulturën nga e cila po përkthejmë, dhe jo të fshijmë çdogjë vetëm për hir të rehatisë së lexuesit”.

Kapërcimi i këtij hendeku midis lexuesit dhe autorit kërkon kujdesin e duhur dhe shumë studime. Shpesh, përkthej gjëra të cilat janë për një nënkulturë apo kulturë të caktuar te të cilat nuk bëj pjesë, dhe ndoshta nuk kam leje të hyj”, thotë Emma Ramadan. “Por në të njëjtën mënyrë se si funksionojnë përkthimet pavarësisht përmbajtjes, është studimi. Detyra jote është të njihesh me atë kulturë, të mësosh për atë kulturë apo nënkulturë, dhe pastaj ta japësh me saktësi”.

Ka një arsye pse përkthyesit e poezive zakonisht janë edhe vetë poetë – po kapin diçka të nënkuptuar në poezi. Kërkojnë për një zeitgeist (frymën e kohës), një ndjesi, dhe gjejnë kuptime të barabarta apo të kundërta për të kapërcyer hendekët lingistikë dhe kulturorë. Por kjo nuk është një punë e lehtë. “Kam mësuar si të jem e vetëdijshme se çfarë është të përkthesh nga njëra kulturë në tjetrën, dhe dallimet mes kulturave”, tha Ramadan.

Poezitë e mëdha janë të hapura ndaj interpretimeve, që do të thotë se kështu do të jenë edhe përkthyesit e tyre. Shumë vepra janë përkthyer nga njerëz të ndryshëm nga që u përkasin kulturave të ndryshme, epokave dhe shkollave të mendimit, duke iu dhënë kuptime të reja me secilin përkthim. Ndërkohë që nuk ka një mënyrë për të përkthyer një poezi, ka njëmijë mënyra për t’i frymuar jetë një poezie duke e përkthyer për një audiencë të re.

¹ Shtëpi njëkatëshe

Karikaturë nga Arben Mexsi

